



RAPORT PËRFUNDIMTAR

AUDITIMI

**“Mbi Auditim financiar dhe
përputhshmërie në Bashkinë
Malësi e Madhe”**

Tiranë, Qershor 2020



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

<u>Nr.</u>	<u>PËRMBAJTJE</u>	<u>Faqe</u>
I	PËRMbledhje Ekzekutive.....	3-5
II	HYRJA.....	5-10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	10-14
IV	DREJTIMET E AUDITIMIT.....	14-
	A/1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm.....	14-15
	A/2. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.....	15-18
	B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....	18-28
	B/1.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nëligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.....	28-46
	C. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2017, 2018 dhe 2019.....	46-60
	C/1. Ekzekutimi i testeve thelbësore të veprimeve të kryera me bankë	60-69
	D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për prokurimet publike.....	69-101
	D/1.4. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit të kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.....	101-110
	E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.....	110-114
V	OPINIONI AUDITIMIT.....	114-116
VI	GJETJET DHE REKOMANDIMIT.....	116-134
VII	ANEKSE.....	134-165




KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkinë Malësi e Madhe”

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.



KONTROLI I LARTË I SHPETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkinë Malësi e Madhe”

I/a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” dhe në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 259/1, datë 3.3.2020, ndryshuar me nr. 259/2, datë 24.04.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 3.3.2020 deri në datë 22.5.2020, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 30.3.2020 në subjektin Bashkia Malësi e Madhe u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë.

Auditimi u krye mbi bazën e dokumentacionit ligjor të skanuar të dërguar në mënyrë elektronike nga subjekti “Bashkia Malësia e Madhe”, si dhe përgjigjeve të pyetësorëve të përgatitur nga audituesit e KLSH-së, në zbatim të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 16.04.2020 me nr. 322/2 prot.. datë 16.04.2020 “Mbi zhvillimin e veprimtarisë audituese gjatë kohës së fatkeqësisë natyrore (COVID-19)”.

Nga auditimi kanë rezultuar këto gjetje:

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (bilance) të viteve 2018 - 2019, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin se përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Malësia e Madhe, të standardeve mbi raportimin financiar, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sigurtë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare, kjo referuar UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, duke përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e *një opinionit të kualifikuar*¹..

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2019, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Malësi e Madhe bazuar në analizën e riskut², janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kritere jo të plotësuar, materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e *një opinionit të kualifikuar*, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë **118,638 mijë lekë**.

Gjithashtu në auditimin e fushave të tjera është konstatuar se:


- Në zbatimin e kontratave të punëve publike dhe shërbimeve janë konstatuar parregullsi për vlerën e dëmit ekonomik **988 mijë lekë**.

¹ Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

² Sipas *ISSAI 1315 (ISA 315)*, objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Në zbatimin e ligjshmërisë për kryerjen e pagesave të punonjësve (llog. 601), është konstatuar të jenë kryer pagesa në kundërshtim me aktet ligjore në shumën 563,952 lekë;

- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, nuk është ndjekur e plotë procedura në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 28.5.2008 "Për Procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshime dhe Vendimeve respektive të Këshillit Bashkiak, për arkëtimin e vlerës **148,179 mijë lekë**, nga e cila: dem ekonomik në vlerën 13,020 mijë lekë, mungesë të ardhurash në shumën 21,416 mijë lekë dhe borxh tatimor në vlerën 113,743 mijë lekë.

- Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e kaluara, kryesisht për vlerën e shpërblimit të dëmit prej **10,671 mijë lekë**.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, aktrakordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-*paga*; 202- *Studime dhe kërkime*; 401-408-*Furnitorë e llogari te lidhura me to*; 467-*Kreditorë te ndryshëm*; 602-*shpenzime operative*; 215-*Mjete transporti*; 218-*Inventar ekonomik*; 32-*Objekte inventari* dhe 230- 231-*investime*, si dhe 31 procedura prokurimi me vlerë kontrate 805,055 mijë lekë ose 99 % e kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 – 31.12.2019.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH" dhe në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 259/1, datë 03.03.2020, ndryshuar me nr. 259/2, datë 24.04.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.03.2020 deri në datë 22.05.2020, në subjektin Bashkia Malësi e Madhe, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 30.03.2020, u krye auditimi "Auditim financiar dhe përputhshmërie" nga Grupi i Auditimit me përbërje:


1. K. GJ *Auditues i Lartë (Përgjegjës Grupi)*
2. A. Z. *(Auditues)*
3. J. L. *(Auditues)*
4. R. XH. *(Auditues)*
5. I. H. *(Auditues)*

a- Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Malësi e Madhe.

b- Marrësi: Bashkia Malësi e Madhe

c- Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2018 - 2019, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkinë Malësi e Madhe”

- **Objektivat e auditimit synojnë:**

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Ndërsa për auditimin e **përputhshmërisë**, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;


- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Procedura e ndjekur: Ky Raport Përfundimtar Auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Malësi e Madhe, pasi nga grupi i auditimit të KLSH-së me shkresën nr. 259/3prot, datë 29.05.2020 i është dërguar Projekt Raport Auditimi me gjetjet e konstatua.

Subjekti “Bashkia Malësi e Madhe” me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), ka përcjellë në KLSH kundërshtitë e Projekt Raport Auditimit, të cilat pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim, u morën në konsideratë ato që kishin argumentin e duhur lidhorë dhe të shoqëruar me dokumentacion. Ndërsa mangësitë (shkeljet) e tjera të cilat nuk kishin argumentin e duhur lidhorë dhe të shoqëruar me dokumentacion, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit Bashkia Malësi e Madhe për shqyrtimin dhe marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen sipas rekomandimeve të dhëna.

d- Identifikimi i çështjes:

Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

përmisimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaje komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).


Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Malësi e Madhe janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të bashkisë, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

f- Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Malësi e Madhe dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit në lidhje me aktet ligjore/ nënligjore për procedurat e prokurimit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit. Auditimi është kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAL, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

g- Kriteret e vlerësimit.

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- ✓ Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi "Auditimin e përputhshmërisë", Manualët e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore";
- ✓ Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- "Për buxhetin e vitit 2019" dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor";
 - ✓ Udhëzimin plotësues i MF nr. 02, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetin të vitit 2018";
 - ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore";
 - ✓ Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si,.."; Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006;
 - ✓ Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
 - ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël"; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë;

h- Standardet e auditimit"

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik" që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë" që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

i- Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

j- Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), operative (602) dhe investime (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza*), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit



e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

k- Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*urdhër shpenzimeve*), konsistoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm



III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Auditimi në subjektin "Bashkia Malësi e Madhe", u krye në kuadër të planifikimit fillestar vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime sipas 3-E në fushën e prokurimeve.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Malësi e Madhe është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe.

1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Malësia e Madhe përmban bukuri të shumta natyrore, por zhvillimi i turizmit malor ka hasur në pengesa të shumta për shkak të mungesës së infrastrukturës.



-Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia Malësi e Madhe kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Bashkinë Shkodër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Koplikut.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia e Bashkisë Malësia e Madhe është 30823 banorë, ndërsa që sipas Regjistrit Civil kjo bashki ka 54156 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 951.01 km² me një densitet prej 56.69 banorë/km² sipas Regjistrit Civil dhe 32.41 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia përbëhet nga 6 njësi administrative, si: Kopliku, Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Qendra dhe Shkreli dhe ka nënadministrimin dy qytete (Koplik, Bajzë) dhe 56 fshatra.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkinë Malësi e Madhe”

Bashkia Malësi e Madhe

Qarku	Qendra e bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Censit 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja Km ²
Shkodër	Qyteti Koplík	Koplík	Qyteti Koplík	30,823	53,918	951.01
		Guemirë	Fshatrat: Guemirë, Boric i vogël, Grudë-Fushë, Grillë, Kurtë, Linaj-egc-Iepurosh, Omaraj, Rrash, Vorfë, Demiraj, Ktosh, Gjormë, Mshqerrë, Vajush, Boric i Madh, Kerraj			
		Kastrat	Qyteti Bajzë, Fshatrat: Ivanaj, Ailaj, Gradec, Hot, Jeran, Pietroshtan, Rapshtë, Vuçpapaj, Premat, Goraj-Budishtë, Kastrat, Bratosh			
		Kelmend	Fshatrat: Tamarë, Brojë, Kozhnje, Selcë, Vukël, Lëpushë, Vermosh, Nikç			
		Qendër	Fshatrat: Bogë-Palvar, Dobër, Jubicë, Kamicë-Flakë, Kalldrën, Koplík i sipërm, Stërbes, Lohe e Poshtme			
Shkret	Fshatrat: Dedaj, Bogë, Bzetë, Bzetë-Markaj, Lohe e sipërme, Vrith, Vuç-Kurtaj, Zagorë, Qaf-Gradë, Reç, Rrepisht, Kokpapaj					

Profili i Bashkisë

Bashkia Malësi e Madhe përmban bukuri të shumta natyrore, siç janë Liqeni i Shkodrës dhe pikat turistike malore të Vermoshit, Razmës dhe Bogës. Turizmi, blegtoria dhe bujqësia janë burimet kryesore ekonomike për banorët e kësaj zone.

Zhvillimi i turizmit ka hasur në pengesa të shumta për shkak të mungesës së infrastrukturës. Një nga akset më të rëndësishme, ai Hani i Hotit- Tamarë- Vermosh-Plavë Guci, e njohur ndryshe si rruga e Alpeve do të përmirësonte jetesën e banorëve të këtyre zonave dhe do të ndikonte në zhvillimin e turizmit malor.

Bashkia e Malësisë së Madhe zgjerohet me 5 zona rurale, të cilat merren kryesisht me bujqësi, kultivimin e bimëve medicinale dhe blegtori. Një pjesë e vogël e banorëve merren me peshkim.

Qyteti i Koplikut ka nivel të lartë papunësie, ndërsa pjesa më e madhe e të ardhurave në këtë zonë sigurohen nga emigracioni.

Bashkia e Malësisë së Madhe zotëron sipërfaqe të mëdha pyjore, ndërsa mirëmenaxhimi i pyjeve mund t’u sigurojë të ardhura të konsiderueshme banorëve të zonës në të ardhmen.

Sfidat me të cilat përballet Bashkia Malësi e Madhe pas ndarjes së re.

Krijimi i një zone industrialo-tregtare në Koplík është një premtim i hershëm, por i porealizuar për Malësinë e Madhe.

Shfrytëzimi i potencialeve natyrore ekzistuese për aktivitete ekonomike të qëndrueshme si: turizmi natyror përgjatë bregut të liqenit të Shkodrës, kultivimi i peshkut dhe peshkimi duhet të zhvillohen paralelisht me tregtinë e kulturave bujqësore të traditës si duhani dhe bimët medicinale në Malësinë e Madhe.


Sfidë për bashkinë e re, konsiderohet subvencionimi i fermerëve dhe krijimi i një qendre të posaçme për grumbullimin dhe shitjen e duhanit dhe bimëve medicinale, kjo e fundit e zhvilluar në këtë zonë.

Përmirësimi i rrugëve ndërlidhëse me zonat rurale, së bashku me pastrimin e zonës nga mbetjet e depozituara pranë shtratit të lumit Përroi i Thatë.

Brenda kësaj bashkie përfshihet edhe Stacioni Hekurudhor ndërkombëtar i Bajzës, i cili është i vetmi në Shqipëri që shërben për transportin ndërkombëtar të mallrave, ku realizohet rreth 60 % e trafikut të transportit shqiptar të mallrave, ndonëse në gjendje të mjerueshme.

Mungesa e ujit të pijshëm është një nga problemet kryesore që shtrohet për zgjidhje përballë drejtuesit të Bashkisë Malësisë së Madhe.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.


Plotësia: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

-Objekti i këtij auditimi, është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitet 2018 - 2019. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit.

-Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁴.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

- **Fushëveprimi i këtij auditimi**, përfshin të gjithë aktivitetin e aparatit të subjektit Bashkia Malësi e Madhe. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të subjektit Bashkia Malësi e Madhe.

- **Misioni**, për njësinë që auditohet është kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

- **Objektivat**, burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.


Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.

⁴Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.



KONTROLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

- **Metoda e Auditimit:** Auditim mbi bazë risku

IV. DREJTIMET E AUDITIMIT

IV/A. Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm.


A/3.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi, dhe në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se nuk është bërë një punë e mirë në drejtim të plotësimit dhe administrimit të dokumentacionit përkatës sipas kuadrit ligjor, përveç Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Njesisë, e cila ka të përfshirë brenda edhe Kodin Etik, nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim më të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm për të qenë në nivelin e kërkuar nga kuadri ligjor. Auditimi i Brendshëm ka funksionuar përgjithësisht, dhe ka performuar nivel të kënaqshëm profesional. Drejtuesit dhe punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si, gjurma e auditimit, plane strategjike afatgjata, strategjia e riskut, regjistër risku, matrica e riskut, plan veprimi, etj. Nuk ka sisteme kompjuterike të licensuar për njësinë. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, dhe të gjithë menaxherët kryesor të institucionit në nivel drejtorie e sektori.

Situata:

Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashkinë Malësi e Madhe, në përgjithësi nuk ka funksionuar sipas ligjit. Sistemet e Kontrollit të Brendshëm nuk janë kuptuar dhe zbatuar si duhet nga Njësia e Autorizuar, Njësia e Zbatues, dhe gjithë ekipi drejtues i bashkisë, dhe nuk është punuar për të shtrirë më gjerë në sistemet e tjera brenda njesisë. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin në përgjithësi nuk është kuptuar dhe si pasojë nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njesisë dhe në strukturat vartëse. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:

Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Është hartuar Rregullorja e Funksionimit të Njesisë brenda së cilës është përfshirë edhe Kodi i Etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Rregullorja e Funkcionimit të Brendshëm ka nevojë për përmirësim dhe përditësim, në përshtatje me ndryshimet e reja dhe dinamikën e zhvillimit, por edhe me plotësimin e kapitullit të trajtimit të shkeljeve disiplinore të punonjësve dhe të drejtave të tyre për ankimimi, gjë e cila në rregulloren aktuale pasqyrohet në mënyrë sipërfaqësore.

Në lidhje me menaxhimin e riskut: Njësia vendore nuk ka hartuar Plan Masash për minimizimin e riskut, nuk ka një strategji risku të shkruar e dokumentuar. Regjistri i riskut është hartuar vetëm për vitin 2018, por nuk shoqëruar me Matricën e riskut. Nga auditimi nuk rezulton të janë çelur dhe administruar regjistrat e risqeve për nejesin vendore, por edhe për çdo sektorë të vartësisë. - *Në lidhje me aktivitetet e kontrollit,* nga auditimi rezultojë se nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit" pika 40, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, dhe neni 16 pika 2. Njësia vendore nuk ka sisteme kompjuterike të licencuara.

-*Në lidhje me informacionin dhe komunikimin:* Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Njësia dhe strukturat vartëse, auditohet nga struktura e Auditit të Brendshëm dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Njësia mund të identifikohet edhe nëpërmjet adresës w.w.w.bashkia.malesiemadhe.gov.al e cila është funksionale, por ajo nuk është përditësuar në vazhdimësi, dhe të interesuarit nuk mund të marrin prej saj informacionin e plote në kohë reale. Njësia ka në strukturë shërbim të IT-së, ky shërbim kompetencat detyrat dhe te drejtat nuk i ka të parashikuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, dhe as në ndonjë rregullore të veçantë.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Impakti:

Trajnimi i pa mjaftueshëm për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për ofrimin e informacionit, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Risku i brendshëm është i nivelit të lartë.

Shkaku:

Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe mos konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohja dhe mos zbatimi nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, me nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: I lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, me atributet e Kryetarit të GMS dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, planit të veprimit, si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 13-15 të Projektraport Auditimit)

A/2. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.

-Organizimi dhe funksionimi i strukturës së sektorit të Auditit të brendshëm;

Struktura e auditimit të brendshëm është krijuar dhe funksionon nga muajit Tetor 2015 e në vazhdim, strukturë e cila është krijuar me vendim nr. 16, datë 20.10.2015 me 3 (tre) punonjës, ku për vitin 2018 me vendim nr. 17, datë 31.01.2018 dhe për vitin 2019 me vendim nr. 6, datë 21.01.2019. Kjo strukturë ka funksionuar në nivel sektori siç është përcaktuar në ligj dhe kuadrin rregullator për Auditimin e Brendshëm (AB) dhe ushtron veprimtarinë duke raportuar drejtpërdrejtë tek Titullari i Institucioni (Kryetari i Bashkisë) për rezultatet e misioneve të auditimit të kryer në këtë subjekt.

-Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm.

Stafi i Njësisë Auditit të Brendshëm (këtu e vijim NJAB) përbëhet nga 3 tre punonjës 1 (një) drejtues dhe 2 dy auditues, nga të cilët: 2 nga audituesit zotërojnë certifikatën "Audit të brendshëm në sektorin publik", ndërsa 1 (një) auditues është i paçertifikuar, në kundërshtim me pikën 2 e nenit 11, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën si vijon:

NR	EMËR MBIEMËR	TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM							
		Pozicioni	Arsimi Bazë	Eksperie nca e Punës Vitet e Punës në AB	Zhvillimi Profesional				
					Certifikimi			Trajtime në fushën e AB	
					I pa certif ikuar	Në proces certifi kimi	I certifi kuar në vitin	Nga Inst. Kombëtare ose Ndërkombëtare	Publiki me në fushën e AB
Për vitin 2018									
1	T. T.	P/Sektor	Financier	4			2018	Nga Aspa/ DRAB	po
2	SH. S.	Audituese	Financier	4			2017	Nga Aspa/ DRAB	po
3	A. H.	Audituese	Juriste	4			2018	Nga Aspa/ DRAB	po
Për vitin 2019									
1	T. T.	P/Sektor	Financier	5			2018	Nga Aspa/ DRAB	po
2	SH. S.	Audituese	Financier	5			2017	Nga Aspa/ DRAB	po
3	D. XH,	Audituese	Juriste	1	1		-	-	

- Dokumentacioni baze mbi të cilën ushtron aktivitetin Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Referuar rezultateve të veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114 datë 22.10.2015 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe kapitullit III të manualit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Brendshëm në sektorin publik", veprimtaria audituese është orientuar në vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit, duke u fokusuar kryesisht në:

- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike.
- Vlerësimi i veprimtarisë të njësisë administrative në përputhje legjislativ, analizimi i veprimtarisë të çdo specialisti mbi bazën e detyrave në rregulloren e brendshme të Bashkisë.
- Ruajtjen e aseteve .
- Kontroll financiar në njësit administrative dhe Bashki në kuadrin e realizimit të ardhurave si nga Taksat dhe Tarifat vendore.
- Kontroll në Bashki dhe Njësit administrative si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm , komunikimi në mes sektorëve, roli i hiarkisë në dhënien e llogarie.
- Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetit sipas natyrave dhe specifikave për çdo rast.

Sektori i Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika (ç) të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", është hartuar "Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësorin e vetëvlerësimit", për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, përkatësisht:

Për vitin 2018, me shkresën nr. 992 datë 06.02.2018, ndërsa për vitin 2019 është dërguar me shkresën nr. 368, datë 31.01.2020.

- Realizimi i planit periodik dhe vjetor, analiza sipas llojit të auditimeve, respektimi i frekuencës së auditimit të subjekteve sipas shkallës së riskut për vitet 2018 - 2019.

- **Për aktivitetin e vitit 2018:**

Në zbatim të planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 4188, datë 13.10.2017, janë planifikuar dhe realizuar gjithsej 7 misione auditimi, nga të cilat: 2 misione përputhshmërie, një mision financiar dhe 4 misione të kombinuara.


Në përfundim të procesit të auditimit, janë rekomanduar gjithsej 55 masa organizative dhe asnjë masë shpërbllim dëmi dhe disiplinore, ku nga 55 masa organizative janë zbatuar 45 masa dhe janë në proces 10 masa.

- **Për aktivitetin e vitit 2019:**

Në zbatim të planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 6488, datë 10.10.2018 dhe programeve, janë planifikuar gjithsej 7 misione të llojit të kombinuar. Nga 7 misione të planifikuara janë realizuar 5 misione dhe 2 misione janë në proces auditimi gjatë vitit 2020.

Në përfundim të procesit të auditimit, janë rekomanduar gjithsej 27 masa organizative dhe asnjë masë shpërbllim dëmi dhe administrative/ disiplinore, ku nga 27 masa organizative, nuk është zbatuar asnjë masë dhe janë në proces 27 masa.

Konstatohet se për asnjërin nga vitet objekt auditimi, nga Sektori i NJAB Bashkia Malësi e Madhe, nuk janë planifikuar angazhime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lënë nga misionet e kryera (Të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën Aneks A/2.1 - 10, bashkëlidhur Projektraport Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Situata:

- Në auditimet e kryera për periudhën e vitit 2018- 2019, konstatohet se Sektori i Auditit të Brendshëm (AB), nuk është këmbëngulës në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna, ku për vitin 2018 niveli i realizimit është 45%, ndërsa për vitin 2019 të gjitha rekomandimet janë në proces duke mos zbatuar asnjë; Nuk është bërë i mundur realizimi i kontroleve për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezulton të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe titullari i njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera;
- Nuk ka kryer auditim në zonat me risk të lartë, si: prokurimet me vlerë të vogël e vlerë të lartë, lejet zhvillimore të lëshuara nga Sektori i PLZHT (*taksën e ndikimit ne infrastrukturë*), shpenzimet operative (art. 602), për të gjitha llojet e blerjeve, administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë nuk janë zhvilluar auditime të thelluara, zbatimi i kontratave të punimeve dhe shërbimeve, menaxhimi i borxhit tatimore dhe rritja nga njëra periudhë në tjetrën, nuk është hartuar regjistri i riskut, etj;
- Stafi i Njësive të AB, Bashkia Malësi e Madhe, nuk i gjithi në përputhje me kërkesat ligjore, pasi njëri nga audituesit është i pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik;
- Në rekomandimet e dhëna, konstatohet se janë dhënë vetëm rekomandime për masa organizative dhe asnjë masë shpërblim dëmi, si dhe nuk rekomanduar asnjë masë disiplinore ndajë personave përgjegjës për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Mungesa e arshivimi të dosjeve të auditimit, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm.

Kriteri:


Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Per auditimin e brendshëm ne sektorin publik"; Manuali i auditimit miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" Kap. VII, pika 7; VKM nr. 83, datë 03.02.2016" Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"; neni 11 i VKM nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik"; Standartet e Auditimit; -Rregulloren e brendshme te Bashkisë Malësi e Madhe Miratuar nga kryetari i bashkisë dhe Riregjistruar nr.1739Prot , datë 04.07.2016.

Impakti:

Mos thellimi në problematikat e trajtuara sipas fushave, si dhe mos nxjerrja e përgjegjësive e mos marrja e masave për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, çon në mos realizuar e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera.

Rëndësia: I mesëm



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Për këtë rekomandojmë:

1. Sektori i Njesisë së Auditit të Brendshëm (NJAB), të kryhej monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.
3. Të marrë masa të menjëhershme për të arkivuar në arkivin e institucioni dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik
4. Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, të marrë masa të menjëhershme që punonjësit pa certifikatë të AB, të pajisjen me certifikata të auditit të brendshëm, si dhe kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme.
5. Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njesisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 15-19 të Projektraport Auditimit)

IV/B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017" dhe ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018", me ndryshime.

1. Titulli i gjetjes: *Shkelje të procedurave të programimit të buxheteve afat mesëm 2017-2019, 2018-2020 dhe 2019-2021.*

Situata:


Programimi i PBA 2018-2019.

Nga Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe është ngritur Grupi i Menaxhimit (GMS) me urdhër datë 13.04.2017 dhe miratuar në Këshillin Bashkiak (kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor), brenda datës 31 Dhjetor 2017.

-**Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë**, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të ardhurave dhe shpenzimeve.

-**Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë**, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 korrik të vitit paraardhës.

PBA 2018-2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Buxheti afatmesëm 2018-2020, është miratuar me VKB nr. 121, datë 25.08.2017 mbi "Miratimin e PBA-së me tavanet buxhetor afatmesëm të Bashkisë Malësi e Madhe për periudhën 2018-2020", konfirmuar në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër me shkresën nr. 930/1, datë 12.09.2017 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore.

Në projektbuxhetin afatmesëm 2018 - 2020, nuk është përfshirë plani strategjik i zhvillimit, nuk është përcaktuar misioni, matrica e qëllimeve strategjike, objektivat, fushat prioritare dhe projektet.

PBA 2019-2021

Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 është bërë në mbledhjen e Këshilli të Bashkisë me VKB nr. 136, datë 28.06.2018, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 898/1, datë 16/07/2018.

-Nga Këshilli i Bashkisë është miratuar, kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor me nr. 16 datë 31.01.2018, sipas kërkesave e ligjit nr. 68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33.

-Janë miratuar vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të ardhurave dhe shpenzimeve, ne zbatim me nenin 34, të ligjit nr. 68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

-**Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë**, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës) në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 37.

PBA 2020-2022

Miratimi i tavanëve përgatitore të programit buxhetor 2020-2022 është bërë me VKB nr.46, datë 17.05.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 608, datë 30.05.2019.

Në Këshillin Bashkiak është miratuar projekti i pare i PBA-se me VKB nr. 53, datë 18.06.2019, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr.747/1 prot, datë 04.07.2019, si dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm miratuar me shkresën nr. 57, datë 25.07.2019.

Programi buxhetor afatmesëm i rishikuar është miratuar me VKB nr.17, datë 27.09.2019 dhe shprehje ligjore nr. 1109/1 datë 18.10.2019 (vonesat vijnë nga Këshilli Bashkiak).

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me nenin 34⁵ dhe neni 37⁶, të ligjit nr. nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".

Impakti:

⁵ Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore.... ..

⁶ "... .. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik."



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Në programimin e tregueseve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet

Shkaku:

Mos njohja e legjislacionit në fuqi, si dhe mos organizimi dhe ndarja e detyrave sipas grupeve të punës. Mos funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

Rëndësia: I mesme

2. Titulli i gjetjes: Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2018, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

-Buxheti faktik për vitin 2018, është miratuar me VKB nr. 18 datë 31.01.2018, i konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkoder me shkresën nr. 186/1, datë 14.02.2018 (sipas të dhënave në pasqyrën si vijon), në kundërshtim me kërkesat e nenit 32⁷, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Zbatimi i buxhetit viti 2018. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse.

	Emërtimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Burimet e fondeve 000/lekë buxheti VKB nr.18 dt.31.01.2018	Viti 2018.		
			Plani evidence thesar	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat		191,971	179,286	93
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore		35,451	29,916	84
3	602 Shpenzime operative		96,512	63,780	66
4	604+609 Ndhimat ekonomike		245,546	238,802	97
5	606 Shpërblim lindje+ emergjencë civile		3,340	2,037	61
6	230 +231 Studime projektme		291,006	211,178	72
7	466 Mjete në ruajtje			19,393	
	Etj.				
	Të trashëg. Transf.pakushtez. v.2017	147,570			
	Të trashëg. te ardh. v.2017	32,773			
	Transferta të pa kushtëzuara vitit 18	272,293			
	Transferta specifike vitit 2018	103,826			
	Të ardhurat vendore të vitit 2018	98,375			
	FONDE nga FZHR		113,955	113,955	100
	Donatorë				
	Transf. e Kushtez.(nd.ek,gj.civ.QKB)				
	Transferta specifike trashg.v.2017	15,485			

⁷ Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre. Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Emërtimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Burimet e fondeve 000/lekë buxheti VKB nr.18 dt.31.01.2018	Viti 2018.		
		Plani evidence thesar	Fakti	%
TOTALI	670,322	977,781	858,347	87.7

Burimi: Nga Specialisti Buxhetit dhe përpunuar nga grupi i KLSH

Referuar të dhënave të pasqyrë, plani i miratuar në buxhet nuk përputhet me planin sipas thesarit, kjo për këto arsye:

1. Sipas planit të buxhetit të ardhurat vendore të vitit ushtrimorë paraqiten në shumën 98,375 mijë lekë, por që në planin e buxhetit sipas thesarit kemi rritje autorizimi për vlerën 24,242 mijë lekë (rritje autorizimi).
2. Në planin e buxhetit sipas thesarit janë shtuar financime gjatë vitit të cilat nuk janë pasur në konsideratë gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit faktik të vitit 2018, konkretisht: nga FZHR është shtuar vlera 113,955 mijë lekë, ndihma ekonomike në vlerën 237,744 mijë lekë, gjendja civile në shumën 4,730 mijë lekë, QKB në vlerën 526 mijë lekë dhe fonde të ministrive në vlerën 24,637 mijë lekë.
(1. Investime rikonstruksion i shkollës "Abdyl Bajraktari" dhe kopshtit Kopluk në vlerën 21,739 mije leke; 2. Plan per femije te lindur 665 mije lekë; 3. Plan per fatkeqësi natyrore 2,232 mije lekë).

Shtesa e këtyre fonde nuk janë miratuar në buxhetin faktin (shtesë buxheti), të vitit 2018.

Në total buxheti është programuar për 977,781 mijë lekë, duke u realizuar në masën 858,347 mijë lekë ose në masën 87.7%, ku sipas zërave paraqitet si vijon: Për pagat në masën 93 %; Për shpenzimet operative në masën 66 % dhe për investime (230 + 231) në masën 72 %.


Burimet e financimit të buxhetit të vitit 2018, paraqiten si vijon:

- Vlera 272,293 mijë lekë, transferta të pakushtëzuara viti 2018;
- Vlera 147,570 mijë lekë, transferta të trashëguara nga viti 2017;
- Vlera 32,773 mijë lekë, të ardhura të trashëguara nga viti 2017;
- Vlera 98,375 mijë lekë, të ardhura të vitit ushtrimorë 2018;
- Vlera 103,826 mijë lekë, transferta specifike të vitit 2018;
- Vlera 15,485 mijë lekë, transferta specifike të trashëguara viti 2017.

(Në mënyrë të detajuar paraqiten në pasqyrën **Aneks B/1**, bashkëlidhur projektraport).

Në zbatim të ligjit të buxhetin për vitin 2018, nga bashkia janë zbatuar kërkesa për investime, ku vlera e përdorur është prej 211,178 mijë lekë ose 21.6 % e buxhetit të miratuar në fillim të periudhës ushtrimore. Ndërsa në lidhje me të ardhurat, konstatohet se nga planifikimi prej 98,375 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 66,556 mijë lekë ose 67.6 % e plani, nga e cila: përdorur gjatë vitit ushtrimorë 2018 vlera prej 24,242 mijë lekë (rritje autorizimi) dhe diferencë prej 42,314 mijë lekë trashëgohet për llogari të vitit 2019.

-Nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

-Nuk janë paraqitur në Këshillin e Bashkisë jo më pak se 4 raporte vjetore mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor.

Kriteri:

Kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 65; UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar pika 101; ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", nenet 40 dhe 46; kërkesat e pika 5, Kap. I të UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëm"; nenin 54/dh dhe 55/3 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Impakti:

Performanca e treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Malësi e Madhe dhe performancën në përgjithësi.

Shkaku:

Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor.

Rëndësia: I mesëm

- *Mbi përdorimin e të ardhurave të veta në buxhetin faktik të vitit 2018.*

Niveli i arkëtimit dhe përdorimit të të ardhurave paraqitet në pasqyrat 1 dhe 2, si vijo:
Pasqyra e realizmit të ardhurave

Tabela nr. 1

EMERTIMI	Plan 2018/000lekë	Fakt 2018/000 lekë
Të ardhurave të trashëguara viti 2017	30,859	6,767
Të trashëguara nga transfertat specifike 2017	15,485	15,000
Të trashëguara nga trans. Pakushtëzuara 2017	149,484	112,972
Të ardhurat e veta të vitit 2018	24,242	5,553
Grande të pakushtëzuara viti 2018	272,293	227,411
Grandë të specifike të vitit 2018, nga të cilat:	485,417	471,251
- Nga FZHR	113,955	113,955
- Nga KZHR		
- Nga ministritë e linjë	267,636	265,655
Transfertat specifike 2018	103,826	91,641
Donatorët te ndryshem		
TOTALI	977,780	838,954

Burimi: Sektori i financës dhe përpunuar nga grupi i KLSH.

Shënim: Në kolonën e planit të ardhurave për vitin 2018, Bashkia Malësi e Madhe nuk paraqet planin sipas buxhetit të miratuar në fillim të periudhës për vlerën 98,375 mijë lekë, por ka paraqitur pjesë të të ardhura për të cilën bashkia ka bërë rritje autorizimi në Degën e Thesarit, vlera prej 24,242 mijë lekë. Ndërsa në kolonën e faktit është paraqitur vlera e shpenzuar realisht nga të ardhurat, por nuk është fakti i të ardhurave për vitin 2018, pasi të ardhurat sipas Sektorit të Taksave janë në shumën 66,556 mijë lekë, duke paraqitur vetëm pjesën e përdorur të të ardhurave të arkëtuara.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Në lidhje me mënyrën e shpenzimit të këtyre të ardhurave, treguesit paraqiten në Tabelën nr. 2, si vijon:

Pasqyra e shpërndarjes së të ardhura të vitit 2018

Tabela nr. 2

Emërtimi	Fakt 2018				
	Gjithsej	Tr.Pakusht ezuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar	% nga përdorimi I të ardhurave veta
230-Projekte					
231-Investime	325,132	183,620	5,818	135,694	2
600-Paga	179,287	169,972	5,283	4,032	3
601-Sigurime Shoqërore	29,916	29,243		673	0
602-Shpenzime Operative	63,780	62,810	950	20	1
604-Transferta Institucioneve	2,508		276	2,232	11
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	238,331	1,372		236,959	0
SHUMA.....	838,954	447,017	12,327	379,610	1.5

Burimi: Sektori i financës

Në total të ardhurat zënë 1.5 % të totalit të shpenzimeve, ku për investime zënë 2 %, për paga zënë 3 %, për shpenzimet operative zënë 1 % dhe transferta zënë 11 %.

3. Titulli i gjetjes: Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitet 2019, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

-Për vitin 2019, buxheti i Bashkisë Malësi e Madhe është miratuar VKB nr.17, datë 21.01.2019 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2019”, ku të ardhurat dhe shpenzimet janë miratuar në shumën 909,071 mijë lekë, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkoder me shkresën nr. 99/1 datë 30.01.2019 (të dhënave në pasqyrën si vijon), por në kundërshtim me kërkesat e nenit 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2019, buxhetit të miratuar në fillim të vitit, i janë bërë ndryshime, si vijon:

1. Me vendim nr. 16, datë 27.09.2019 është miratuar fondi për rritjen e pagave për funksionimin e arsimit parashkollor të transferuar në vlerën 1,020,829 lekë, të akorduara për paga për funksionin e transferuara, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 8618prot, datë 09.05.2019”, miratuar nga Prefekti I Qarkut Shkodër me shkresën nr. 1108/1, datë 14.10.2019 (nga llog. 604-Transferta korente të brendshme në llog. 600-Paga shpërblime e tjera);

2. Me vendim nr. 47, datë 11.06.2009 me objekt “Transferim fondi të kontigjencës” është miratuar fondi në vlerën 2,500,000 lekë, ndihmë financiare Bashkia Korçë për raste fatkeqësi natyrore. Miratuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 702/1, datë 13.06.2019.

Zbatimi i buxhetit viti 2019. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse është si në pasqyrën që vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Burimet e fondeve 000/lekë VKB nr.17 datë 21.01.2019	Viti 2019		
			Plani evidence thesar	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat		215,765	196,746	92
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore		36,239	34,162	98.8
3	602 Shpenzime operative		108,563	82,329	74.8
4	604+609 Ndihmat ekonomike		228,055	223,272	97.9
5	606 Shpërblim lindje+ emergjencë civile		6,548	6,431	73
6	230 +231 Studime projekte		379,207	352,524	92.9
7	231 Investime objekte				
8	466 Mjete në ruajtje			16,177	
9	Etj.				
	Te ardhura trashëg.viti 2017	42,782			
	Te ardhura trashëg.viti 2018	42,584			
	Të trashëg. Transf.pakushtez. v.2017	34,729			
	Të trashëg. Transf.pakushtez. v.2018	44,882			
	Të trashëg. Transf.pakushtez. v.2018	1,789			
	Transferta të pa kushtëzuara 2019	281,196			
	Transferta specifike vitit 2019	105,325			
	Të ardhurat vendore të vitit 2019	100,377			
	FONDE nga FZHR		105,828	105,825	100
	Donatorë Projekt Past4 future		3,672	3,672	100
	Transferta e Kushtëzuar v.2019	242,737			
	Transferts specifike trashg,v.2018	12,670			
	TOTALI	909,071	1,083,877	1,021,138	94

Shënim: Të dhënat janë nxjerrë nga Specialisti i Buxhetit dhe përpunuara nga grupi i KLSH

Referuar të dhënave të pasqyrë, plani i miratuar në buxhet nuk përputhet me planin sipas thesarit, pasi:

1. Sipas planit të buxhetit të ardhurat vendore të vitit ushtrimorë paraqiten në shumën 100,377 mijë lekë, por që në planin e buxhetit sipas thesarit kemi rritje autorizimi për vlerën 53,861 mijë lekë (rritje autorizimi).


2. Në planin e buxhetit sipas thesarit janë shtuar financime gjatë vitit të cilat nuk janë pasur në konsideratë gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit faktik të vitit 2019, konkretisht: nga FZHR është shtuar vlera 105,828 mijë lekë, ndihma ekonomike në vlerën 18,682 mijë lekë, gjendja civile në shumën 4,742 mijë lekë, QKB në vlerën 717 mijë lekë dhe fonde të ministrive në vlerën 128,717 mijë lekë (1.Investime 126,382 mije lekë, fonde per zgjedhjet lokale 2,289 mije leke dhe 46 mije shpërblim Gj. Civile).

Konstatohet se shtesa e këtyre fonde nuk janë miratuar në buxhetin faktin (shtesë buxheti), të vitit 2019.

Në total buxheti është programuar për vlerën 1,083 mijë lekë dhe realizuar në masën 1,021 mijë lekë ose në masën 94%, ku: Për pagat në masën 92 %; Për shpenzimet operative në masën 74.8 % dhe për investime (230 + 231) në masën 92.9 %.

Burimet e financimit të buxhetit të vitit 2019, paraqiten si vijon:

- Vlera 281,196 mijë lekë, transferta të pakushtëzuara viti 2019;
- Vlera 81,400 mijë lekë, transferta të trashëguara nga viti 2018;
- Vlera 85,366 mijë lekë, të ardhura të trashëguara nga viti 2018;
- Vlera 100,377 mijë lekë, të ardhura të vitit ushtrimorë 2019;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Vlera 105,325 mijë lekë, transferta specifike të vitit 2019;
- Vlera 12,670 mijë lekë, transferta specifike të trashëguara viti 2018.
- Vlera 242,737 mijë lekë, transferta kushtëzuara viti 2019

(Në mënyrë të detajuar paraqiten në pasqyrën **Aneks 2**, bashkëlidhur projektraport auditimit).

Për aktivitetin e vitit 2019, nga buxheti i bashkisë dhe investitor të tjerë (FZHR apo ministritë e linjës), është planifikuar për investime fondi prej 379,207 mijë lekë të cilat zënë 34.4 % e totalit të shpenzimeve të planifikuara, nga i cili janë shpenzuar vlera 352,524 mijë lekë ose 92.9 % e planifikimit.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor për asnjë nga periudhat objekt auditimi (2018 -2019).

Gjithashtu nuk janë paraqitur në Këshillin e Bashkisë, 3 raporte vjetore mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor për asnjërën nga periudhat objekt auditimi (2018 - 2019).

Kriteri:

Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 40 dhe 46; UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar pika 101, nenin 46 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; neni 54/dh dhe 55/3 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Impakti:

Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Malësi e Madhe dhe performancën në përgjithësi.

Shkaku:

Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor.

Rëndësia: I mesëm

- *Mbi përdorimin e të ardhurave të veta në buxhetin faktik të vitit 2019.*

Nga planifikimi prej 100,377 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 67,513 mijë lekë ose 67.2 % e plani. Nga kjo vlerë është përdorur gjatë vitit 2019 me rritje autorizimi vlera prej 53,861 mijë lekë dhe diferencë prej 13,652 mijë lekë trashëgohet për llogari të vitit 2020.

Referuar të dhënave nga sektori i financës, konstatohet se niveli i arkëtimit dhe përdorimit të ardhurave paraqitet në pasqyrat 3 dhe 4, si vijo:

Pasqyra e realizmit të ardhurave

Tabela nr. 3

EMERTIMI	Plan 2019/000 lekë	Fakt 2019/ 000 lekë
Të ardhurave të trashëguara viti 2018	85,106	69,159
Të trashëguara nga transfertat specifike 2018	12,670	12,670

**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

EMERTIMI	Plan 2019/000 lekë	Fakt 2019/ 000 lekë
Të trashëguara nga trans. Pakushtëzuara 2018	81,660	72,940
Të ardhurat e veta të vitit 2019	53,861	47,990
Grande të pakushtëzuara viti 2019	281,196	240,133
Grandë të specifike të vitit 2019, nga të cilat:	573,056	562,096
- Nga FZHR	105,828	105,825
- Nga KZHR	0	0
- Nga ministritë e linjë	360,882	359,544
- Transfertat specifike 2019	106,346	93,056
DONATORET TE NDRYSHEM		3,672
TOTALI	1,087,549	1,004,990

Burimi: Nga Sektori i Financës

Shënim: Në kolonën plani i të ardhurave për vitin 2019, Bashkia malësi e Madhe nuk paraqet planin sipas buxhetit të miratuar në fillim të periudhës për vlerën **100,377 mijë lekë**, por ka paraqitur atë pjesë të të ardhura për të cilën bashkia ka bërë rritje autorizimi në Degën e Thesarit për vlerën 53,861 mijë lekë. Ndërsa në kolonën fakti, është paraqitur vlera e shpenzuar realisht nga të ardhurat me rritje auditimi, por nuk është fakti i të ardhurave për vitin 2019, pasi sipas Sektorit të Taksave ato janë në shumën 67,513 mijë lekë, duke paraqitur vetëm vlerës e përdorur gjatë vitit 2019.

Në lidhje me mënyrën e shpenzimit të këtyre të ardhurave, treguesit paraqiten në Tabelën nr. 4, si vijon.


Pasqyra e shpërndarjes së të ardhura të vitit 2019

Tabela nr. 4

Emërtimi	Fakt 2019				
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transfer ta e Kushtëzuar	% nga përdorimi I të ardhurave veta
230-Projekte	4,000		4,000		100
231-Investime	458,021	143,978	79,346	234,697	17
600-Paga	197,018	160,033	32,534	4,451	17
601-Sigurime Shoqërore	32,893	32,152		741	0
602-Shpenzime Operative	83,351	81,546	1,270	535	2
604-Transferta Institucioneve	4,139	2,500		1,639	0
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	225,568	2,256		223,312	0
SHUMA.....	1,004,990	422,465	117,150	465,375	12

Burimi: Nga Sektori i Financës

Të ardhurat zënë 12 % të totalit të shpenzimeve, ku për projekte në masën 100 %, për investime zënë 17 %, për paga zënë 17 %, për shpenzimet operative zënë 12 %.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Ndarja e plan-buxheteve dhe detajimi e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli dhe respektimi i disiplinës buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2018 dhe 2019, u konstatua se është realizuar detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimet e financimit. Për vitet 2018 dhe vitin 2019 ka patur ndryshime në planet buxhetore të Bashkisë, të cilat janë miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë dhe të miratuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër.


Mbështetur në treguesit e programuar, nga zyra e financës janë ndjekur shpenzimet sipas artikujve duke mos tejkaluar kufijtë e shpenzimeve. Pasqyrimi i shpenzimeve është bërë në mënyrë të detajuar dhe sipas veprimtarisë përkatëse dhe klasifikimit buxhetor. Disponibilitete në thesar (krediti) shuma e xhiros kreditore të llogarisë, është e njëjtë me situacionin e shpenzimeve për çdo muaj dhe në fund të periudhave ushtrimore, çka tregon qartë për mbajtjen e saktë të treguesve të buxhetit në llogarinë e thesarit dhe pasqyrimin në mënyrë korrekte të veprimtarisë sipas klasifikimit buxhetor. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore sipas manualit të klasifikimit funksional dhe udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe e fondeve të krijuara nga burimet e veta për kryerjen e funksioneve të veta, të përbashkëta e të deleguara si dhe shpërndarja e fondeve të grandit konkurrues të alokuar nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve. Në hartimin e këtyre buxheteve është patur parasysh realizimi i viteve të fundit, rritja e të ardhurave nga taksat vendore dhe nevojat për shërbime publike e investime.

Në çdo rast janë ndjekur hapat për realizimin e pagesave të shpenzimeve, duke nxjerrë urdhrin e prokurimit për çdo rast dhe konfirmuar në Degën e Thesarit, është zhvilluar procedura e prokurimit, është lidhur kontrata, pune/ shërbime, janë marrë në dorëzim në çdo rast nga grupi i kolauditimit i ngritur për këtë qëllim. Në çdo procedure prokurimi janë dokumentet nga urdhri i prokurimit, kontrata, fatura tatimore, situacioni në rastet e punëve apo shërbimeve, fletë hyrja e magazinës etj. Urdhër prokurimi është regjistruar në kohë dhe kanë vulën/ datën e depozitimit në Degën e Thesarit. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën e Thesarit dhe të shtrira në kohë sipas financimit, ku në pjesën dërrmuese kanë kohë shtrirje pagesash deri në tre vite. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

- Ruajtja e destinacionit të përdorimit dhe limiti i planifikuar i fondeve të planifikuara.

Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve, duke gjetur zbatim UMF nr.1, datë 09.01.1996 "Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore" dhe UMF nr.2, datë 27.01.1999 "Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

▪ Mbi përdorimin e fondit të veçantë për vitet 2018 - 2019:

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës për periudhën objekt auditim është planifikuar në masën 6,000 mijë lekë fond rezervë dhe 6,000 mijë lekë fond kontigjenca, *respektivisht*: 3,000,000 lekë për çdonjërën nga vitet 2018 – 2019, sipas kërkesave të nenit 40/6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Për vitin 2018, nga fondi rezervë është përdorur vlera 700,000 lekë për fatkeqësi, ndërsa për vitin 2019, nga fondi rezervë është përdorur vlera 1,900,000 lekë për fatkeqësi dhe vlera 2,500,000 lekë nga fondi i kontigjencës për ndihmë financiare Bashkinë Korçë me rastin e tërmetit (fatkeqësi natyrore).

Duke vlerësuar riskun në auditim, u kryhen testet në 15 raste me vlerë mbi 100 mijë lekë ose në 40 % të raste dhe 57 % të vlerës së fondit të dhëna, nga ku u konstatua se shpenzimet janë kryer në përputhje me nenin 56 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; neni 29, 53/6 shkronja (dh) e nenit 54, pika 3 e nenit 55, shkronja (c) e nenit 64 të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", i ndryshuar; të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore", kreu III të Udhëzimit Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare dhe veprimtari njerëzore.

4. Titulli i gjetjes: *Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave;*

Situata:

Referuar të dhënave të pasqyrave financiare të vitit 2018 – 2019, konstatohet se:


Për aktivitetin e vitit 2018, gjendja e faturave të palikujduara (*detyrimeve kreditore*) paraqitet në shumën 185,765 mijë lekë dhe **për aktivitetin e vitit 2019**, gjendja e faturave të palikujduara (*detyrimeve kreditore*) paraqitet në shumën 114,509 mijë lekë.

Shlyerja e këtyre detyrimeve, nuk është programuar si zë më vehte në buxhetet respektive.

Gjithashtu, konstatohet se kjo gjendje nuk justifikon gjendjen e lartë të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore 2018 – 2019, nisur nga fakti se sipas të dhënave të pasqyrave financiare të viteve 2018 – 2019, llog. 520 "Disponibilitete në thesar" në fund **për vitin 2018** është në vlerën **179,436 mijë lekë** të trashëgueshme për vitin 2019 dhe për aktivitetin **e vitit 2019** është në vlerën **97,657 mijë lekë** të trashëgueshme për vitin 2020.

Kriteri:

Veprimeve kundërshtim me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 - *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" dhe pikën 101, të UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

Impakti:

Kritjen e paargumentuar të gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, duke rritur kështu borxhin që bashkia ka ndaje të tretëve.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave drejtues në mos ndjekjen e radhës së pagesave.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marë masa për:

- Zbatimin e procedurave ligjore në programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesëm, duke ngritur në kohën e duhur, grupet e punës sipas projekteve të financimit, si dhe të monitorohet zbatimi i kalendarit të programimit të buxhetit sipas afateve ligjore.

- Programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

- Të miratojë në Këshillin Bashkiak raportet e monitorimit të treguesve të buxhetit, si organi vetëm vendimmarrës, si dhe të gjitha fondet që akordohen kësaj bashkie nga burimet e veta, buxheti i shtetit apo donator të ndryshëm në fillim dhe gjatë vitit ushtrimorë, për të siguruar një transparencë të mirpërdormit të këtyre fondeve me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet në të mirë të komunitetit.

- Programimin dhe monitorimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura duke miratuar një kalendar mbi bazën e mundësive financiare dhe riskut nga penalitete të mundshme.

(Gjerësisht problemet janë trajtuar në faqen 19-29 të Projektraport Auditimit)

IV/B.4. Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe borxhi tatimor.

1. Të dhëna mbi numrin e punonjësve

Në Bashkinë Malësi e Madhe, për periudhën e objekt auditimi Sektori i Taksave dhe Tarifave ka funksionuar si më poshtë:

- Për vitin 2018, ka funksionuar me **11** punonjës, nga këta 1 përgjegjës sektori, 3 inspektor për taksat dhe tarifatat në NjA. Koplík, me 2 inspektor për taksat dhe tarifatat në NjA. Gruemirë me 1 (një) inspektor për Nj. A. Qendër me 2 inspektor për Nj. A. Kastrat, dhe 1 (një) inspektor për Nj. A. Shkrel. 1 inspektor për Nj. A. Kelmend.

Paketa fiskale është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 8, datë 22.01.2018, dhe shprehur, me disa vërejtje, ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 147/1, datë 08.02.2018



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Për vitin 2019, ka funksionuar me **10** punonjës, nga këta 1 përgjegjës sektori, 3 inspektor për taksat dhe tarifatat në NjA. Koplik, 2 inspektor për taksat dhe tarifatat në NjA. Gruemirë, 1 inspektor për NjA. Qendër, 2 inspektor për NjA Kastrat, dhe 1 inspektor për NjA. Shkrel, ndërsa NjA. Kelmend mbulohet nga NjA. Koplik.

Paketa fiskale është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 185, datë 20.12.2018, dhe shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 1492/1, datë 04.01.2019, e cila ka pësuar disa ndryshime me VKB nr.15, datë 22.02.2019, ndaj këtij ndryshimi ka dhënë konfirmim edhe Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.291/1 datë 12.03.2019

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore është mbajtur regjistër elektronike për evidentimin dhe pasqyrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë bashki dhe njësitë administrative Koplik, Qender, Gruemirë, Kastrati, Shkrel dhe Kelmend, por nuk është mbajtur regjistër manual.

Në auditimin e kryer mbi burimin e krijimit të ardhurave dhe përdorimi i tyre u audituan dokumentacioni i paraqitur nga zyra e taksave dhe tarifave vendore si: Evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifatat vendore, Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore, evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve, administrimi i aseteve, procedura e lëshimit të Liçencave dhe Autorizimeve, si dhe dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale, dhe për strukturën organike, ku u konstatua se:

1. Titulli i gjetjes: *Gjendja e subjekteve objekt të taksave dhe tarifave vendore*

Situata:

Për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 460 subjekte (346 subjekte të biznesit të vogël, 114 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione), ndërsa për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 481 subjekte (356 subjekte të biznesit të vogël, 125 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione), të dhëna sipas aneksit 1, si vijon:

Gjendja e bizneseve për vitin 2018, 2019,

Aneksi nr.1

Nr	Lloji i Biznesit	Viti	Gjendja ne fillim	Regjistrime te Reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi i Vogël	2018	344	44	42	346
		2019	346	30	20	356
2	Biznesi i Madh	2018	113	4	3	114
		2019	114	22	11	125
3	Gjithsej	2018	457	48	45	460
		2019	460	52	31	481



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkinë Malësi e Madhe”

Përsa më sipër konstatohet se:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk ka një regjistër të bizneseve të ndarë në kategorinë e biznese të mëdhenj (BM) dhe biznese të vogla (BV), prej nga mund të nxjerrësh statistika të sakta për detyrimet dhe pagesat e tyre në dobi të buxhetit të bashkisë të ndara sipas kategorisë së bizneseve.
- Numeri i bizneseve ka ardhur duke u rritur nga viti 2018 në vitin 2019, me 21 subjekte nga të cilat 11 biznese të mëdhenj, dhe 10 biznese të vegjël.
- Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të liçensuar dhe të mbrojtur, veprim që bie në kundërshtim me pikën 7⁸, neni 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”
- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, **66** subjekte të biznesit të vogël, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Njësinë Administrative, Koplik, Qender, Gruemirë, Kastrat, Shkrel dhe Kelmend, nuk janë regjistruar në QKB, kjo ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për detyrimin e këtyre subjekteve që të regjistrohen në QKB, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre, veprim që bie në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, në lidhje me zbatimin e nenit 41 dhe 121, pika 3, e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteri:

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Impakti:

Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

⁸ “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar”.



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë, regjistrimin e subjekteve sipas kategorisë, si dhe mirë administrimin e dosjeve të tyre, i cili ngarkon me përgjegjësi:

1. **F. C.** me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 01.01.2018 - 03.04.2018;
2. **E. L.** me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 04.04.2018 e vazhdim;
3. **R. T. E. D. E. S. A. R. V. V. E. B. E. L. T. V. T. B.** me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave për periudhën respektive në këtë sektor, që përkon edhe me periudhën e auditimit;

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me policinë bashkiake të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur regjistrimin e **66 subjekteve në QKB**. Të përgatit, sekretojë dhe administroj regjistrat manual të biznesit. Të pasuroj e administroj dosjet e bizneseve që janë subjekte të taksës së thjeshtë mbi fitimin në përputhje me kuadrin ligjor.

Kundërshti nga subjekti i audituar:

Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), ku thuhet; "Spektori i Taksave dhe Tarifave vendore ka Regjistër të bizneseve për secilën Njësi Administrative, të kategorizuar sipas madhësisë së biznesit me informacionet përkatëse sipas aktivitetit, adresës, sipërfaqes së ndërtesë ku operojnë, sipërfaqes së truallit, tabelat identifikuese, tabelat reklamuese dhe informacione të tjera sipas subjekteve specifike. Regjistri i Biznesit printohet çdo fund viti, dhe në bazë të regjistrit krijohen dosjet për secilin subjekt të shoqëruara me inventarin e brendshme të dosjes.

Qëndrimi i grupi të auditimit:

Pretendimi juaj që përmendni në kundërshtinë tuaj nuk qëndron për arsyen se: mbajtja e Regjistrat Manual për bizneset është detyrim ligjor, i cili në vetvete është dokument zyrtar, me nr. protokolli, dhe nr. fletësh të përcaktuara, ai përdoret dhe administrohet sipas rregullave në fuqi për dokumentacionin zyrtar.

2. Titulli gjetjes: *Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2018, 2019.*

Situata:

Nga analiza e të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se:

a. Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **98,375,000** lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën **66,944,559** lekë ose **68 %**, me një diferencë në vlerën **31,430,441** lekë. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 7,957,281 lekë, ose 15% të planifikimit, të ardhurat nga tarifave nuk janë realizuar në vlerën 14,527,490 lekë, ose 44% të planifikimit, nga



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

të ardhurat e tjera nuk janë realizuar në vlerën 7,099,297 lekë, ose 74% të planifikimit, të ardhura nga debitorët nuk janë realizuar në vlerën 1000.000 lekë ose 100% të planifikimit, taksa vendore për ujitjen nuk është realizuar në vlerën 500,000, ose 100% të planifikimit, etj.

b. Për vitin 2019 të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga **100,377,000** lekë të

parashikuara, janë realizuar, në vlerën **66,780,775** lekë, ose **66.5 %**, me një diferencë në vlerën **33,596,225** lekë. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 22,272,327 lekë, ose 50% të planifikimit, të ardhurat nga tarifatat nuk janë realizuar në vlerën 12,617,361 lekë, ose 36% të planifikimit, të ardhura nga debitorët nuk janë realizuar në vlerën 100,000 lekë, ose 100% të planifikimit, të ardhura nga gjobat nuk janë realizuar në vlerën 200,000 lekë, ose 100% të planifikimit, etj.

Të dhëna të përmbledhura për realizimin e të ardhurave vendore për vitin 2018 dhe 2019. E detajuar në pasqyrën Aneksi nr. B/6.1, bashkëlidhur projektraport auditimit.

Nr	Përshkrimi	Plan 2018	Fakt 2018	Realiz. %	Plan 2019	Fakt 2019	Realiz. %
1	Të ardhura nga taksat	52,500,000	44,542,719	85	44,702,000	22,429,673	50
2	Të ardhura nga tarifatat	33,175,000	18,647,510	56	34,625,000	22,007,639	64
3	Të ardhura të tjera	9,600,000	2,500,703	26	5,030,000	4,664.493	93
4	Të ardhura nga gjobat	2,100,000	335,865	16	1,400,000	681,366	49
5	Tatim i thjeshtuar/fitimin	1.000.000	560.394	56	1.100.000	538.405	49
6	Të ardhura kombëtare	0	357,368	-	13,520,000	16,459,199	122
7	Shuma	98.375.000	66.944.559	68	100,377,000	66,780,775	66,5

Burimi: Sektorin e Taksave Vendore

- Niveli i arkëtimit të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat vendore ka ardhur në ulje nga viti 2018 në vitin 2019, në vlerën 2,165,784 lekë ose **1.5 %** më pak, **gjë e cilat tregon mos eficientë e kësaj strukture në menaxhimin e të ardhurave.**


-Për vitin 2019 vlerën më të lartë të mos realizimit të ardhurave vendore e zënë të ardhura nga Taksat Vendore në shumën **22,833,922** lekë.

Konstatohet se megjithëse janë planifikuar të ardhura nga arkëtimi i debitorëve, për periudhën objekt auditimi nuk është arkëtuar asnjë vlerë, **gjë e cila tregon punën e dobët të kësaj administrate.**

Përsa më sipër konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos marrë në konsideratë numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën të dhënave për subjektet të cilët në bazë të xhiros do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, etj.

Nga Sektori i Taksave është rakorduar (çdo 6-muaj) me Drejtorinë e Rajonale Tatimore Shkodër për realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, në cilësinë e agjentit tatimor.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- **Të ardhura nga taksat kombëtare** për vitin 2018 nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Malësi e Madhe, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.

-**Taksa e mjeteve të përdorura** është planifikuar sipas të dhënave historike, pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe nuk ka rakordime çdo muaj me Drejtorinë e Shërbimit të Transporteve Shkodër.

Sektori i Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agentëve tatimorë, në bazë të cilave të bëjë akt-rakordimet, veprime të cilat kanë çuar në mos evidentimin e saktë të ardhurave nga agentët tatimor, në kundërshtim me nenin 117, të ligjit nr. 9920, dt./- 19.5.2008, "Për Procedurat Tatimore", ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 68-2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9920, dt. 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, "Për taksat kombëtare"

- **Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët**, konstatohet se për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj) në Bashkinë e Malësisë së Madhe të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të "Njoftim Vlerësimit", apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, veprime në kundërshtim me neni 70 pika 3 " E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 " Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar.

Bashkia Malësi e Madhe nuk ka përcaktuar mënyra efçente për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjar nëpërmjet shoqërisë "Ujësjiellësi Kanalizime" sha, sipas pikës (ii) e nenit 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ku i jep të drejtën e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agentit fiskal, nuk është realizuar përfshirja e vlerës së taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit dhe do ti jepte më shumë mundësi për shërbime dhe investime ndaj komunitetit.

- **Në lidhje me taksën e tokës bujqësore**, konstatohet se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë së saj, dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu nëse vërejmë pasqyrat e mëposhtme do të konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme për sa i përket taksës së tokës bujqësore. Kjo tregon se Sektori i Taksave dhe Tarifave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë, dhe për të realizuar një procese sa më real të planifikimit të ardhurave, veprime në



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

kundërshtim me pikën 1⁹ të nenit 23 të ligjit nr. nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se në bashkinë Malësi e Madhe janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **16065** familje të cilat duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme sipas kuadrit ligjor në fuqi, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë gjatë planifikimit të taksës së tokës për familjarët. Toka bujqësore u përket kategorive IV deri VIII, sipas përkatësisë, Kategoria e IV 1,625 ha, kategoria V 2,919 ha, kategoria VI 4,738 ha, kategoria e VII 4,194 ha, dhe kategoria e VIII 2,077 ha. Gjithsej fondi i tokës bujqësore për Bashkinë Malësi e Madhe është **15,553** ha.

Sipas fondit të tokës që është në posedim të 16065 familje, bashkia duhet të kishte planifikuar 12,432,200 lekë, në fakt janë planifikuar vetëm 3,100,000 lekë për vitin 2018, dhe 3,502,000 lekë për vitin 2019. Nga krahasimi i të dhënave sa më sipër diferenca në planifikim është **9,332,200** lekë për vitin 2018 (12,432,200 - 3,100,000), dhe **8,930,200** lekë për vitin është 2019 (12,432,200 - 3,502,000), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për të dy vitet të marra së bashku në vlerën **18,262,400** lekë, sipas pasqyrës Aneks B/6.3; 3/2 dhe 3/3.

Të dhëna për realizimin e të ardhurave vendore për vitin 2018 dhe 2019.

Aneksi nr.2

Nr	Përshkrimi	Plan 2018	Fakt 2018	Realiz. %	Plan 2019	Fakt 2019	Realiz. %
1	Të ardhura nga taksat	52,500,000	44,542,719	85	44,702,000	22,429,673	50
2	Të ardhura nga tarifat	33,175,000	18,647,510	56	34,625,000	22,007,639	64
3	Të ardhura të tjera	9,600,000	2,500,703	26	5,030,000	4,664.493	93
4	Të ardhura nga gjrobat	2,100,000	335,865	16	1,400,000	681,366	49
5	Tatim i thjeshtuar/fitimin	1.000.000	560.394	56	1.100.000	538.405	49
6	Të ardhura kombëtare	0	357,368	-	13,520,000	16,459,199	122
Shuma		98.375.000	66.944.559	68	100,377,000	66,780,775	66,5

Inventari tokës bujqësore që disponon Bashkia Malësi e Madhe, si dhe ndarja e saj familjeve.

Aneksi nr.3

Nr	Njësit Administrative	Sip. e tokës gjithsej ha	Numri familjeve gjithsej	Marre toke me AMTP sip. Ha	Marre toke me AMTP familje gjithsej	Toke ne perdorim (Përdorues faktik pa AMTP) në Ha	Nr. i Familjeve përdorues faktik
1	Koplik	930	2972	384.5	947	545.5	2025
2	Kelmend	1046	1877	10.8	6	1035.2	1871
3	Kastrat	4163	3509	1038	1012	3125	2497
4	Qender	3610	1919	475	467	3135	1452
5	Shkrel	1759	1799	47	85	1712	1714
6	Gruemire	4045	3989	1130	1302	2915	2687
Bashkia Malesi e Madhe		15553	16065	3085.3	3819	12467.7	12246

⁹ “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka”



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Fondi i tokës bujqësore klasifikuar sipas kategorisë.

Aneksi nr.3/2

Nr	Nj. Administrative	Kategoria 4	Kategoria 5	Kategoria 6	Kategoria 7	Kategoria 8	Sip. Tot. Ha
1	Kelmend	-	-	-	1046	-	1046
2	Kastrat	1625	2134	404	-	-	4163
3	Shkre	-	-	401	1211	147	1759
4	Qendër	-	589	1091	-	1930	3610
5	Gruemirë	-	196	1912	1937	-	4045
6	Kopliku	-	-	930	-	-	930
Shuma/hektar.....		1625	2919	4738	4194	2077	15553

Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/çmimit.

Aneksi nr.3/3

Nr.	Kategoria/tokë	Çmimi/ha/vit	Sipërfaqja/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit	2018	2019
1	Kategoria IV	1,000 lekë	1625	1,625,000			
2	Kategoria V	900 lekë	2919	2,627,100			
3	Kategoria VI	800 lekë	4738	3,790,400			
4	Kategoria VII	700 lekë	4194	2,935,800			
5	Kategoria VIII	700 lekë	2077	1,453,900			
Totali		-	15,553 hektar	12,432,200	3,100,000		3,502,000

Kriteri:

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 132, datë 07.03.2018, “Mbi metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme-ndërtesa”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 8, datë 22.01.2018, (Paketa Fiskale 2018), Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 185, datë 20.12.2018, ndryshuar me VKB nr.15, datë 22.02.2019 (Paketa Fiskale 2019)

Impakti:

Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:


Mungesa e zbatimit me rigorozitet i akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë, planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore etj, i cili ngarkon me përgjegjësi:

1. F. C. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 01.01.2018 – 03.04.2018;
2. E. L. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 04.04.2018 e vazhdim;
3. R. T. E. D. E. S. A. R. V. V. E. B. E. L. T. V. T. B. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave për periudhën respektive në këtë sektor, që përkon edhe me periudhën e auditimit;

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore të mbështetet në treguesit real të të ardhurave duke shfrytëzuar resurset që ka bashkia Malësi e Madhe gjatë procesit të planifikimit të paketës fiskale për ta bërë atë sa më të plotë dhe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

realizueshme. Në bashkëpunim me Sektorin e Financave dhe Buxhetin dhe Policinë Bashkiake, të realizojë planifikimin e të ardhurave në të gjithë treguesit.

Kundërshti nga subjekti i audituar:

Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), ku në mënyrë të përmbledhur thuhet; "Gjatë vitit 2019 dhe 2020 janë dërguar njoftime për detyrimet si fillim për punonjësit e administratës publike, duke vazhduar me të gjithë familjarët e tjerë debitorë. Bashkangjitur gjeni 10 (dhjetë) nga njoftim detyrimet dërguar punonjësve të administratës shtetërore të institucioneve publike (shkresa me nr 6068- 6068/10, dt. 11.12.2019) dhe 10 (dhjetë) nga njoftim detyrimet dërguar kryefamiljarëve debitorë deri në vitin 2020 (shkresa me nr 824/458- 824/ 449 prot., datë 10.03.2020).

Për sa më sipër kërkoj të rishqyrtohen konstatimet e evidentuara nga ana juaj.

Qëndrimi i grupi të auditimit:

Pretendimi juaj që përmendni në kundërshtinë tuaj qëndron për arsyen se; është shoqëruar me dokumentacionin përkatës justifikues.

3. Titulli i gjetjes: *Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimi.*

Situata:

Nga të dhënat që disponon Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Malësi e Madhe, në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër ka dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve, banorë të kësaj njësie vendore, shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP Shkodër.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2019, sipas listave të vëna në dispozicion të cilat paraqesin personat që janë pajisur me leje legalizimi, dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë likuiduar taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se nga **387** persona gjithsej që kanë përfituar nga procesi i legalizimit të objekteve, vetëm **198** persona kanë paguar vlerën **7,941,228** lekë në dobi të arkës së bashkisë, ndërsa **189** persona nuk kanë paguar detyrimin i cili është në vlerën **8,128,740** lekë, **shumë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe**, (sipas pasqyrës së paraqitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të administruar në dosje), veprime në kundërshtim me VKM nr.860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1, të dhëna të paraqitura në pasqyrën *Aneks B/6.4*.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Aneksi nr.4

Viti	Nr. Personave	Likuiduar	Vlera	Pa likuiduar	Vlera
2018	121	51	2,010,698	70	3,492,874
2019	266	147	5,930,530	119	4,635,866
Shuma	387	198	7,941,228	189	8,128,740

Kriteri:

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillim Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 132, datë 07.03.2018, “Mbi metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme-ndërtesa”
Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 8, datë 22.01.2018, (Paketa Fiskale 2018),
Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 185, datë 20.12.2018, ndryshuar me VKB nr.15, datë 22.02.2019 (Paketa Fiskale 2019)

Impakti:

Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet i akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave që burojnë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet dhe ndërtimet reja, i cili ngarkon me përgjegjësi:

1. F. C. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 01.01.2018 – 03.04.2018;
2. E. L. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 04.04.2018 e vazhdim;
3. R. T. E. D. E. S. A. R. V. V. E. B. E. L. T. V. T. B. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave për periudhën respektive në këtë sektor, që përkon edhe me periudhën e auditimit;

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin debisë së krijuar nga mos likuidimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtesave.

4. Titulli i gjetjes: Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2019

Situata:

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2019 gjendja e detyrimeve debitorë për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Malësi e Madhe në vlerën paraqitet në vlerën **113,743,328 lekë**, nga e cila: debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh për **211** subjekte në vlerën **26,652,289 lekë** (21,864,060 lekë detyrimi + 4,788,229 lekë kamata vonesë), (e kontabilizuar), dhe **11209** abonentë familjarë për taksë toke, taksë ndërtesa,

**KONTROLI I LARTË I SHITIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën **87,091,039 lekë**, sipas të dhënave të pasqyrave Aneks 5, më poshtë:

Gjendja e bizneseve debitor për taksa e tarifave deri në 31.12.2019.

Aneksi nr. 5

Nr.	Debitorët	Principali	K/vonesë	Shuma	Kontabiliz.
1	Biznesi	21,864,060	4,788,229	26,652,289	21,864,060
2	Taksën infrastrukturë.	14,608,473	3,199,256	17,807,729	14,608,473
3	Debit. Famil	87,091,039	0	87,091,039	0
4	Shuma	123,563,524	7,987,533	131,551,057	36,472,533

Aneksi nr. 5/1

Nr	Njësia vendore	Biznes i vogel		Biznes i madh		Totali (pa kamatvonesa)	Kamatvonesa /Leke (21.9%)	Totali/ Leke
		Nr	Vlera/Leke	Nr	Vlera/Leke			
1	Nj.A. "KOPLIK"	78	3,903,090	16	1,521,870	5,424,960	1,188,066	6,613,026
2	Nj.A. "QENDER"	5	138,200	6	1,252,300	1,390,500	304,120	1,695,020
3	Nj.A "GRUEMIRE"	13	1,160,500	6	2,608,033	3,768,533	825,309	4,593,842
4	Nj.A "KASTRAT"	42	1,947,695	22	7,690,790	9,638,485	2,110,828	11,749,131
5	Nj. A "SHKREL"	0	0	9	546,72	546,720	119,732	666,452
6	Nj.A. "KELMEND"	11	974,862	3	120,000	1,094,862	239,775	1,334,637
Shuma/ Lekë.....		149	8,124,347	62	13,739,713	21,864,060	4,788,229	26,652,289

Për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për **149** subjekte në vlerën **8,124,347** lekë, dhe debitorët e biznesit të madh për **62** subjekte në vlerën **13,739,713** lekë, dhe **1.841.865** lekë kamat vonesa. (sipas të dhënave të administruara të dërguara nga Sektori i Taksave dhe Tarifave).

Sektori i Taksave dhe Tarifave, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", të ndryshuar.

Sektori i Taksave dhe Tarifave për **93** bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia Bashkiake.

Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga **211** subjekte debitorë në vlerën **21,864,060 lekë**, janë aktiv **118** subjekte ose 56 % e totalit të debitorëve të evidentuar të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa në vlerën **10,848,212 lekë** ose rreth 50 % e vlerës totale të debisë, ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr.9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Edhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave, nuk është bërë kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 181¹⁰ -Mospagimi i taksave dhe tatimeve

Vlera prej **87,091,039** lekë janë debitorë **11209** familje për taksat e tarifave vendore deri në datë 31.12.2019, për mospagesën e detyrimeve sipas pasqyrës **Aneks 5/1**, si më poshtë:

Gjendja e debitorëve familjarë deri në 31.12.2019.

Aneksi nr. 5/2

Nr.	Njësia Admin. Vendore	Taksat vendore			Tarifa vendore	Shuma taksa+tarifa	Nr. Familje Debitorë deri në 31.12.2019
		Taksë toke	Taksë ndërtese	Taksë trualli			
1	Koplik	204,735	6,366,650	737,800	21,560,400	28,869,585	2,441
2	Gruemirë	709,390	3,330,188	434,600	13,025,000	17,499,178	2,677
3	Shkrel	140,135	1,410,400	196,750	5,965,500	7,712,785	1079
4	Kastrat	1,766,237	2,296,800	380,000	13,676,000	18,119,037	2610
5	Qender	53,761	1,122,500	143,000	3,862,000	5,181,261	841
6	Kelmend	779,296	2,236,647	276,700	6,416,550	9,709,193	1,561
	Shuma	3,653,554	16,763,185	2,168,850	64,505,450	87,091,039	11,209

Kriteri:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar

Impakti:

Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet i akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë administrimin dhe arkëtimin e borxhit tatimor të krijuar ndër vite, i cili ngarkon me përgjegjësi:


1. F. C. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 01.01.2018 - 03.04.2018;
2. E. L. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 04.04.2018 e vazhdim;
3. R. T. E. D. E. S. A. R. V. V. E. B. E. L. T. V. T. B. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave për periudhën respektive në këtë sektor, që përkon edhe me periudhën e auditimit;

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Financë Buxhetit dhe Policinë Bashkiake të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore që ka në dispozicion për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga subjektet fizik dhe juridik si dhe të detyrimeve familjare të pa likuiduara.

¹⁰ “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”



5. Titulli i gjetjes. *Administrimi i aseteve pronë e bashkisë dhe realizimi i të ardhurave nga dhënia me qera e tyre.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Bashkia Malësi e Madhe në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qera të tyre, prej vitit 2009 e në vazhdim ka lidhur 21 kontrata me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për një afat kohor që shkon nga 1 vit deri në 30 vjet, nga të cilat: 10 kontrata janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, 3 kontrata janë lidhur për dhënien me qera të sipërfaqeve për panele solar, 6 kontrata janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për ndërtimin e HEC-ve, 1 kontratë është lidhur për dhënien me qera të një godine për ambiente zyre, dhe 1 kontratë për dhënien me qera të fondit kullimore për kullotë.

- Nga kontratat e lidhura për dhënien me qera të sipërfaqeve nga fondi pyjeve dhe kullotave për instalimin e antenave celulare, janë lidhur gjithsej 10 kontrata, prej të cilave; 5 kontrata janë lidhur për një afat 9 vjeçar, dhe 5 kontrata janë lidhur me një afat 5 vjeçar, në 3 raste kontratat janë rinovuar, por janë zvogëluar sipërfaqet e marra me qera, nisur nga ankesa e qiramarrësve dhe riverifikimit të kryer nga strukturat e bashkisë, sipas dokumentacionit të paraqitur.

- Tre kontrata janë lidhur me 3 persona juridik të ndryshëm por me të njëjtin pronar, për një sipërfaqe prej 15 ha për të instaluar panele solar, me afat prej 30 vjetësh, etj

-Konstatohet se 6 kontrata janë lidhur me 3 subjekte ndërtues të HEC-ëve, të cilët kanë shfrytëzuar sipërfaqe kullimore dhe pyjore për ndërtimin e infrastrukturës, prej të cilave 3 kontrata janë lidhur për një afat 1 vjeçar, dhe 3 për afatin 5 vjeçar.


Më poshtë po renditim të detajuara kontratat në të cilat, në bazë të vlerësimit të riskut, janë konstatuar me mangësi në lidhje me formën dhe përmbajtjen e tyre, si dhe respektimin e kushteve të kontratës në lidhje me arkëtimin e vlerës së qerasë në dobi të bashkisë në cilësinë e qiradhënesit:

1. Kontrata nr._433, datë 17.05.2009, lidhur për vendosjen e antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullisor në pronësi të bashkisë, me kompaninë V...A SH.A, me sipërfaqja 200 m²

2. Kontrata nr._4962, datë 06.08.2018, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullisor në pronësi të bashkisë, me kompaninë V...A SH.A, me sipërfaqja 166 m² + 667 ml për rrugë kalim

3. Kontrata nr. 4963, datë 06.08.2018, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullisor në pronësi të bashkisë, me kompaninë V...A SH.A, me sipërfaqja 300 m² + 500 ml.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e kontratave për likuidimin e qerasë, rezulton se:



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

a. Lëshimi i faturës nga qiradhënësi për likuidimin e shumës nga qiramarrësi, është lëshuar në datë 20.08.2018 (3 fatura), ndërsa likuidimi i tyre është bërë në 12.07.2019. Vlera e detyrimit është 1,105,045 lekë.

b. Nuk është zbatuar pika e kontratës kur qiramarrësi nuk ka paguar në afat këstin e qerasë, për të aplikuar kamat vonesë në masën 0,01% në ditë deri në 10%

4. Kontrata nr. 5082, datë 19.12.2017, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, me kompaninë T...A SH.A, me sipërfaqja 230 m² + 63 ml.

7. Kontrata nr. 3692, datë 26.10.2009, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, me kompaninë E...E SH.A, me sipërfaqja - 200 m².

8. Kontrata nr. 1296, datë 06.04.2011, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, me kompaninë E...E SH.A, me sipërfaqja - 200 m².

9. Kontrata nr. 4 337, datë 26.10.2017, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, me kompaninë A...A SH.A, me sipërfaqja - 0.02 ha + 0.3 km rrugë.

10. Kontrata nr. 319, datë 15.01.2019, lidhur për vendosjen antenës celulare në sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, me kompaninë A...M SH.A, me sipërfaqja - 0.02 ha.

11. Kontrata nr. 5101, datë 10.08.2018, lidhur për dhënien me qera të sipërfaqes nga fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, personit juridik S...I, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqja - 0.211 ha
Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e kontratës për likuidimin e qerasë, rezulton se:

a. Fatura nga qiradhënësi për likuidimin e shumës nga qiramarrësi, është lëshuar në datë 26.09.2018 (2 fatura), ndërsa likuidimi i tyre është bërë në 09.04.2019, dhe 09.05.2019. Vlera e detyrimit është 327,570 lekë.

b. Nuk është zbatuar pika e kontratës kur qiramarrësi nuk ka paguar në afat këstin e qerasë, për të aplikuar kamat vonesë në masën 0,01% në ditë deri në 10%

12. Kontrata nr. 320, datë 16.01.2019, lidhur për dhënien me qera të sipërfaqes nga fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, personit juridik S...I, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqja - 0.2276 ha

13. Kontrata nr. 6481, datë 18.10.2018, lidhur për dhënien me qera të sipërfaqes nga fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, personit juridik M...O, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqja - 0.2469 ha

-14. Kontratat nr. 626, 627, 628, datë 26.02.2013, lidhur midis Komunës Shkrel, për ndërtimin stacionit të paneleve diellore, në sipërfaqe e fondit pyjor dhe kullor në pronësi të bashkisë, me kompaninë M...R 1, 2, 3, me sipërfaqja - 15 ha,

Nga auditimi rezulton se nga subjekti M...R 1,2,3, për vitet 2013 - 2019 janë arkëtuar gjithsej vlera prej **920,640 lekë** në dobi të bashkisë Malësi e Madhe.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Nga krahasimi i shumës së detyrimeve dhe shumës së arkëtimeve, rezultojnë këto 3 subjekte të marra së bashku nuk kanë derdhur në arkën e Bashkisë Malësi e Madhe vlerën prej **11,949,360 lekë** (12,870,000 – 920,640), shumë e cila ka sjell të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë.

- Përveç shumës së detyrimit të pa paguar që rrjedh nga zbatimi i kushteve të kontratës, subjektet M...R 1,2,3, ngarkohen edhe me kamatë vonesë për vonesat në shlyerjen e detyrimeve të qerasë, kusht i cili rrjedh nga neni 5, pika 5.4, i kontratës .

Gjendur përpara këtij fakti subjekti duhet ti nënshtrohet edhe kamatë vonesës prej 10% që është si në vijim; $11,949,360 \times 10\% = 1,194,936$ lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë.

Në total subjektet "M...R", 1, 2, 3 me mos pagesën e detyrimeve vjetore që rrjedhin nga kontratat përkatëse të qerasë dhe aplikimit të kamat vonesës i kanë sjell buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe të ardhura të munguara në vlerën **13,144,296 lekë**, sipas pasqyrës Aneks 6; 6/1 dhe 6/2, si vijon:

Aneksi nr. 6

Nr	Kontrata		Subjekti	Vendndodhja	Sipërf aqja ha	Tarifa lek/ha/v it	Vlera/vit	Vite shfryt ëzimi	Detyrimi në lekë
	Nr	Data							
1	626	26.02.2013	"M...R 1"	Lohe e Poshtme	5	143,000	715,000	6	4,290,000
2	627	26.02.2013	"M...R 1"	Lohe e Poshtme	5	143,000	715,000	6	4,290,000
3	628	26.02.2013	"M...R 1"	Lohe e Poshtme	5	143,000	715,000	6	4,290,000
TOTALI									12,870,000

Arkëtimet e realizuara nga M...R 1,2,3 deri në 31.12.2019

Aneksi 6/1


Nr	SUBJEKTI	2014		2015		2016		2017		2018	Totali Lekë
		data e pagesës	vlera	data e pagesës	vlera	data e pagesës	vlera	data e pagesës	vlera	Dt. 26. 3. 2018	
1	M...R 1	03.04.14	52,900	12.02.15	63,480	21.02.16	63,500	31.03.17	63,500	63,500	306,880
2	M...R 2	03.04.14	52,900	12.02.15	63,480	21.02.16	63,500	31.03.17	63,500	63,500	306,880
3	M...R 3	03.04.14	52,900	12.02.15	63,480	21.02.16	63,500	31.03.17	63,500	63,500	306,880
TOTALI / VIT			158,700		190,440		190,500		190,500	190,500	920,640

Përmbledhje e detyrimeve, arkëtimeve dhe, diferencave të krijuara nga M...R 1,2,3 deri 31.12.2019.

Aneksi nr.6/2

Nr	Nr Kontratës	Data	Emri i Subjektit	Detyrimi në lekë	Arkëtuar	Diferenca	Kamatë vonesë 0,01 - 10%
1	626	26.02.2013	"M...R 1"	4,290,000	306,880	3,983,120	398,312
2	627	26.02.2013	"M...R 1"	4,290,000	306,880	3,983,120	398,312
3	628	26.02.2013	"M...R 1"	4,290,000	306,880	3,983,120	398,312
TOTALI				12,870,000	920,640	11,949,360	1,194,936

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

-Nuk janë zbatuar kushtet e kontratës që përcakton mënyrën, kohën e pagesës së qerasë, si dhe pasojat kur shkelin detyrimet e përcaktuar në kontratë për mos shlyerjen në kohë të qeras, si dhe nuk është aplikuar sanksion për ndërprerjen e njëanshme të saj në rastet e parashikuar nga kontrata konkrete, veprime të cilat kanë sjell të ardhura të munguara të pamatshme në buxhetin e bashkisë.

-Nuk është zbatuar penaliteti i parashikuar në kontratë për kamatë vonesën në rastet kur qiramarrësi nuk likuidon në kohë detyrimin, nga 0.01% në ditë, por jo më shumë se 10% e vlerës së detyrimit përkatës. Konkretisht me kompaninë "V...A Sha" për vlerën 110,504 lekë, dhe subjektin "S...I" për vlerën 32,757 lekë. Veprimi i cili ka sjell të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën **143,261** lekë.

- Kontratat e lidhura midis Bashkisë Malësi e Madhe me subjektin M...R, 1,2,3, janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", Lidhja nr. 2, Pika nr. 8.

- Nga Bashkia Malësi e Madhe nuk është zbatuar neni 13.2, për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, pasi rezulton se subjektet "M...R" 1,2,3, nuk kanë derdhur në arkën e bashkisë detyrimin e qerasë vjetore siç është parashikuar në nenin 5, pika 5.1 të kontratës së lidhur me Bashkinë Malësi e Madhe nga momenti i lindjes së detyrimit dhe deri në 31.12.2019 vlerën prej **13,144,296** lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, (prej të cilave 11,949,360 lekë detyrim qera, dhe 1,194,936 lekë kamatë vonesë).


- Formulimi i kontratave të qeras më këto subjekte, në disa raste, vendos në kushte të pafavorshme qiradhënësin në raport me qiramarrësin, duke mos përcaktuar qartë kushtet kontraktuale, dhe penalitetet në rastet kur shkelet ajo nga qiramarrësi.

- Kontratat e qirasë midis Bashkisë Malësi e Madhe, e përfaqësuar nga titullari saj, etj me subjektet qiramarrëse, në 12 raste nuk janë lidhur me akt noterial, në kundërshtim me paragrafin e "I" të nenit 83, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

- Kontratat e qerasë të lidhura me subjektet qiramarrëse të aseteve pronë e bashkisë në 6 raste nuk kanë parashikuar si klauzolë aplikimin e kamatë vonesës, në rastet e mos pagimit në afat të qerasë, si dhe në 3 raste nuk kanë parashikuar zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rastin e shkeljes së afatit të shlyerjes së qerasë.

Kriteri:

Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Kodi Civil i RSH, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Impakti:

Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet i akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë mirë administrimin e aseteve pronë e bashkisë, si dhe hartimin dhe zbatimin e kontratave të qerasë, i cili ngarkon me përgjegjësi:

1. F. C. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 01.01.2018 – 03.04.2018;
2. E. L. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 04.04.2018 e vazhdim;
3. R. T. E. D. E. S. A. R. V. V. E. B. E. L. T. V. T. B. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave për periudhën respektive në këtë sektor, që përkon edhe me periudhën e auditimit;
4. E. A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik;
5. E. H., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të aseteve;

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Sektori i Aseteve të marrë masa për administrimin e aseteve pronë e bashkisë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sektori Juridik të marrë masa për korrigjimin e kontratave të dhënies me qera të aseteve pronë e bashkisë që nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor, si dhe të zbatoj në mënyrë rigoroze penalitetet që burojnë nga këto kontrata për zgjidhjen e njëanshme të tyre kur janë shkelur kushtet e parashikuara në to. Sektori i Taksave dhe tarifave vendore të marrë masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve që lindin nga zbatimi i kontratave të dhënies me qera të aseteve pronë e bashkisë, si dhe të zbatoj sanksionet e parashikuara në këto kontrata.

Kundërshti nga subjekti i audituar:


Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, sektorin juridik dhe sektorin i aseteve, me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), ku në mënyrë të përmbledhur thuhet; " Pas kërkesës së subjekteve M...R 1, 2 dhe 3, grupi i punës i ngritur me Urdhër nr 41, datë 09.04.2019 për vlerësimin dhe verifikimin për subjektin në fjalë, ka konstatuar se subjektet M...R (me seli në Tiranë) nuk ka filluar asnjë aktivitet dhe asnjë lloj ndërtimi apo punimi në tokën që ata kanë marrë me qira. Ky proces verbal shoqërohet edhe me fotografi të marra gjatë inspektimit.

Ne këto kushte duke qenë se toka nuk është përdorur, dhe pas njoftimit të shkëputjes së kontratës nuk ka patur më pretendime nga subjekti për përdorimin e tokës, si dhe duke marrë parasysh mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, e vërtetuar edhe me aktet e bashkangjitura këtij observacioni, vlera e referuar nga ju nuk është e saktë.

Ne kemi realizuar të gjitha procedurat e nevojshme, si për njoftimin e palës qiramarrëse detyrimet e prapambetura ashtu dhe për qëndrimin e Bashkisë Malësi e Madhe ndaj shkëputjes së njëanshme të kontratës.

Qëndrimi i grupi të auditimit:

Pretendimi juaj që përmendni në kundërshtim tuaj nuk qëndron për arsyen se; nuk keni paraqitur asnjë dokument ligjor që tregon se kontrata me subjektin është



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

ndërprerë në zbatim të nenit 13.2 të kontratës së qerasë me subjektin në fjalë, dhe bashkë me të edhe detyrimi në vazhdim. Për sa kohë kontrata e qerasë është në fuqi edhe kundërshtitë e tjera në lidhje me këtë problem bien.

6. Titulli gjetjes: Krijimi i të ardhurave nga lëshimi i Licencave/Autorizimeve.

Situata:

Bashkia Malësi e Madhe për periudhën e vitit 2018 dhe 2019, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, përsa i përket arkëtimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburant për konsumatorët fundor, që ndodhen në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Referuar kapitullit II, pikës 1; germës "b", pikës 9, dhe pikës 15.1, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar.

Sipas evidencës së paraqitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitetet me seli në territorin e bashkisë Malësi e Madhe dhe në Njësitë Administrative në vartësi, u audituan pagesat për dhënien dhe përsëritjen e Licencave/ Autorizimeve për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante, për periudhën objekt auditimi, mbështetur në legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, Vendimeve të Këshillit Bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë për tregtim karburanti me pakicë (Autorizim), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, u konstatua se:

- Në bashkinë Malësi e Madhe gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundor 15 subjekte prej të cilave 10 subjekte janë pajisur për gjatë viteve me Autorizim/Licencë për një afat 5 vjeçar, ku 7 nga këto subjekte janë pajisur me Licensë/Autorizim përpara hyrjes në fuqi të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 (tarifa 100,000 lekë/ Autorizimi/5vjeçar).

-Nga auditimi rezulton se, nga 8 subjektet që janë pajisur me Autorizim/Licensë për tregtimin me pakicë të hidrokarbureve, 5 prej tyre nuk kanë likuiduar detyrimin për pajisjen me këtë dokument, duke i shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë në vlerë **500,000 lekë**,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Nga **15** subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit të hidrokarbureve me pakicë në territorin e bashkisë Malësi e Madhe, **5 prej tyre nuk janë pajisur me Autorizim/Liçensa** nga kjo bashki, dhe konkretisht subjekti "O...A", "L...L", "R...J", "K...R", "G...G", duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të saj në vlerën **5,000,000 lekë**, (5 x 1000,000), veprim në kundërshtim me pikën 15.1¹¹ të Kapitullit II, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015, i ndryshuar.

- Nga auditimi, rezulton se nga 7 subjektet që ishin pajisur me Liçensa/ Autorizim përpara hyrjes në fuqi të VKM nr. 970, datë 02.12.2015, u konstatua se 4 subjekt **nuk kanë rinovuar Licencën/Autorizimin** për periudhën në vazhdim edhe pse vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin tregtar të tregtimit me pakicë të karburanteve etj, konkretisht: "D...L", përfunduar liçensa në datë 01.10.2018, "R...P", përfunduar liçensa në datë 11.02.2019, dhe "B...L", përfunduar liçensa në datë 13.07.2019, "J...L", përfunduar liçensa në datë 12.03.2019.

Mos pajisja e këtyre subjekteve me Liçensen/ Autorizimin përkatës, kanë sjell për pasojë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë në vlerën **4,000,000 lekë**, (4x 1,000,000), veprime në kundërshtim me pikën 15.1 të Kapitullit II, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015, i ndryshuar.

Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburant me pakicë në territorin e bashkisë Malësi e Madhe, sa janë pajisur me Autorizim/liçensë dhe likuidimi i tarifës deri në 31.12.2019

Aneksi nr.7

Nr	Emri Shoqërisë	Vend ndodhja	Autorizimi/licenca, data e lëshimit	Detyrimi në lekë	Arkëtuar në lekë	Dif. për arkëtim, në lekë
1	A...L	VUKPALAJ	3.3.2015- 3.3.2020	100,000	0	100,000
2	"Z...A 2006"	ALIAJ	01.12.2019-31.11.2023	1,000,000	1,000,000	0
3	J...L	HOT	13.3.2014- 12.3.2019 (100,000	0	100,000
4	B...O	HOT	19.06.2015-18.06.2020	100,000	100,000	0
5	K...L	Pjetrosan	18.02.2015-17.02.2020	100,000	0	100,000
6	O...A	GRILË	Pa autorizim	1,000,000	0	1,000,000
7	O...I	Boriç I MADH	09.12.2019-08.12.2023	1,000,000	1,000,000	0
8	M...A	GRIZHE	23.10.2018- 2.10.2023	1,000,000	1,000,000	0
9	D...L	DOBËR	01.10.2013- 01.10.2018	100,000	0	100,000
10	L...L	DOBER	Pa autorizim	1,000,000	0	1,000,000
11	R...P	KOPLIK I SIPËRM	03.08.2014- 02.08.2019 (përfunduar)	100,000	0	100,000
12	R....J	Koplik i Sipërm	Pa autorizim	1,000,000	0	1,000,000
13	"B...L"	LLAZAN	14.07.2014- 13.07.2019 (përfunduar)	50,000	50,000	0
14	K...R	Rrethrotullimi Bajze- Koplik	Pa autorizim	1,000,000	0	1,000,000
15	G...G	Rruga Nationale Shkodër- Han i Hoti	Pa autorizim	1,000,000	0	1,000,000
	Shuma			8,650,000	3,150,000	5,500,000

¹¹ 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, me njëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundor.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Kriteri:

Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017

Impakti:

Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë, taksat dhe tarifave vendore, administrimin e dhënies me qera të aseteve, administrimin e lëshimit të Liçencave/ Autorizimeve etj, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi:

1. F. C. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 01.01.2018 – 03.04.2018;
2. E. L. me detyrë P/Sektorit të Taksave për periudhën 04.04.2018 e vazhdim;
3. R. T. E. D. E. S. A. R. V. V. E. B. E. L. T. V. T. B. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave për periudhën respektive në këtë sektor, që përkon edhe me periudhën e auditimit;

Rëndësia: *E lartë.*

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorin e Financ/Buxhet, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë arkëtimit të borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore, dhënia me qera e aseteve dhe nga administrimi i lëshimit të Liçencave dhe Autorizimeve.

Kundërshti nga subjekti i audituar:

Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), ku në mënyrë të përmbledhur thuhet; "Ju informojmë se Bashkia Malësi e Madhe në përputhje me legjislacion në fuqi ka informuar Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Drejtorinë e Inspektimit të Naftës, Gazit, dhe Nënprodukteve të tyre, nëpërmjet shkresave si mëposhtëm:

-Shkresa me nr.5566.prot, datë 06.11.2019, dhe nr.706.prot, dt.02.03.2020, "Dërgim informacioni mbi subjektet që operojnë pa autorizime për funksionimin si stacione shitjeje të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante", bashkangjitur shkresës është vendosur edhe lista e subjekteve që operojnë pa autorizime.

Në këto shkresa kemi kërkuar nga ana e tyre marrjen e masave të duhura ligjore për subjektet që operojnë pa licencë dhe që ushtrojnë aktivitet tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegies, për përdorim nga konsumatorët fundor në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Qëndrimi i grupi të auditimit:

Pretendimi juaj që përmendni në kundërshtinë tuaj nuk qëndron për arsyen se: sepse nga ana juaj nuk janë marrë masa në zbatim të pikës nr 15.1 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar, për bllokimin e aktivitetit tregtar të subjekteve që nuk janë pajisur me Autorizim/ Liçensën përkatëse, dhe ndjekjes së mëtejshme të procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky aktivitet.

(Gjerësisht problemet janë trajtuar në faqen 29-46, të Projektraport Auditimit)

IV/C. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitet 2018 - 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

1. Titulli i gjetjes: Në fund të vitit Bashkia Malësi e Madhe ka pasur fonde të pa përdorura të trashëgueshme për vitin 2018, në shumën 179,436 mijë lekë, ndërkohë që detyrimet kreditore për vitin 2018 janë në shumën 185,766 mijë lekë.

Situata:

Për evidentimin kontabël të aktivitetet ekonomik dhe financiar, në këtë bashki, është organizuar dhe funksionon Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit e përbërë nga këta punonjës:

Nr	Emër/ mbiemër	Funksioni/ Emërtimi	Diplomimi/ Profesioni	Eksperiencë pune në kontabilitete	Dt. e emërimit në detyrë
1	A. RR	Drejtor Finance	Finance, cikël i plotë	13 vite	30/07/2015
2	N. D.	Inspektor Finance	Finance, cikël i plotë	25 vite	01/10/1997
3	V. Z.	Specialist Buxhet	Finance, cikël i plotë	25 vite	15/06/2016
4	S. D.	Arkëtare	Arsim i mesëm		11.01.2019
5	E. R.	Kontabilist	Financë, cikël i plotë	2 vite	13/06/2016

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2018.

Për vitet 2018 dhe 2019, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të Bashkisë Malësi e Madhe, me NIPT K48420701I, Kodi i Njesisë 2130001, dërguar Degës së Thesarit Malësi e Madhe me shkresat nr. 1830 prot., datë 29.03.2019 dhe nr. 956 prot., datë 31.03.2020, të përbëra si vijon:
Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (Bashkëngjitur Aktivi dhe Pasivi i bilancit Pasqyrat Nr.1 dhe Nr.2)

- Baza ligjore (për të dy vitet 2018 dhe 2019).

Hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, shfuqizuar me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" etj. legjislacion rregullues.

Mbajtja e kontabilitetit (Për dy vitet 2018 dhe 2019).

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Nuk përdoren programe elektronike për mbajtjen e kontabilitetit. Janë hapur ditarrë përkatës për bankën, magazinën, arkën dhe ditari i veprimeve të ndryshme. Përveç këtyre janë hapur dhe ditari i angazhime dhe ditari i detyrimeve.

Për vitin 2018.

-Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2018

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llog. 520 "Disponibilitete në Thesar", është në pasqyrat financiare **për vlerën debitorë 179,436,183 lekë**. Nga të dhënat e rakorduara me Degën e Thesarit, kjo vlerë është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit të Malësisë së Madhe. Në fakt hyrjet të kësaj llogarie, janë në total në shumën 459,342,981 lekë, daljet janë në shumën 279,907,178 lekë dhe të trashëguara për vitin 2019, në shumën 179,435,803 lekë.

Më konkretisht analizuar si më poshtë:

I. Të trashëguara nga viti 2017.	
Sipas akt rakordimit për vlerën	134,737,934 lekë.
Këto të ardhura të trashëguara, janë të analizuar me burime si vijon:	
Grande dhe të ardhurat lokale	119,737,683 lekë,
Grande specifike.....	15,000,251 lekë
II. Të hyra (shtesat debitorë) gjatë vitit 2018	
Granit i vitit i pa kushtëzuar.....	227,411,094 lekë
Të ardhurat e veta.....	5,552,771 lekë
Granit specifik.....	91,641,182 lekë
Totali i te ardhurave (Hyrjet debitorë) për vitin 2018 (I+II).....	459,342,981 lekë
III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:	
Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore).....	279,907,179 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Gjendja debitorë (Saldo debitor) në vitin 2018, është $(459,342,981 - 279,907,179) = 179,435,802$ lekë.

Në këtë rast, u konstatua se në pasqyrat financiare është gjendja debitorë më tepër për diferencën $(179,436,183 - 179,435,802) = 381$ lekë.

-Po kështu llog. 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 30,989,676 lekë dhe është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit. Kjo llogari gjatë vitit 2018, është pakësuar për diferencën 1,958,550 lekë $(32,948,226 - 30,989,676)$ ngurtësime në fund të vitit 2017). Këto ngurtësime të kryera gjatë viti ushtrimore përfaqësojnë 5% të vlerës nga situacione e punimeve dhe shërbimeve të paraqitura nga sipërmarrësit sipas kontratave të lidhura pas procedurës me tender. Është e analizuar sipas objekteve dhe vlerës së ngurtësuar.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se në debi të kësaj llogarie, janë të ngurtësuara fonde që u përkasin ish Komunave; Kelmend, Shkrel dhe Gruemirë, sot NjA të Bashkisë Malësia e Madhe për 16 raste në shumën 2,724,465 lekë për periudhën e viteve 2014-2015.

Për këto fonde të ngurtësuara, ka kaluar afati i garancisë së punimeve dhe për këto fonde duhet të procedohet sipas kërkesave ligjore për tu përdorur për interes publik nga Bashkia Malësia e Madhe.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet gjithashtu se gjendja e mjeteve të ngurtësuara në fund të vitit 2017, është në shumën 32,948,226 lekë, shtuar ngurtësime gjatë vitit 2018 për 15,695,985 lekë, pakësuar (likuiduar 5% e vlerës së ngurtësimeve) për shumën 17,654,535 lekë. Gjendja në fund është për vlerën $(32,948,226 + 15,695,985 - 17,654,535) = 30,989,676$ lekë.

-Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik:

Inventarët


Për vitin 2018, na u paraqit dokumentacion mbi kryerjen e inventarizime fizike të aktiveve të Bashkisë Malësia e Madhe. Për kryerjen e inventarizimi, Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, Urdhrin nr. 113, datë 14.12.2018 të protokolluara me nr. 7780 prot., datë 14.12.2018.

Nga inventarizimi nuk kanë rezultuar diferenca.

Në vitin 2018, janë miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e inventarëve të cilat u propozuan për tu nxjerrë nga përdorimi nga inventari i kryer në vitin 2017.

Nxjerrjet jashtë përdorimit, janë miratuar me Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Nr. 5662, 5664, 5661, 5660, 5663 prot., datë 06.09.2018. Këto vendime i referohen nxjerrjeve të inventarëve jashtë përdorimit të vitit të kaluar 2017, përkatësisht referuar procesverbaleve të datës 22.12.2017 të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit si dhe raportit vlerësues të këtij komisioni.

Për asgjësimin e inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit sipas inventarizimit të vitit 2017, është krijuar komisioni me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 5757 prot., datë 11.09.2018 me kryetare E. R.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Vlera e këtyre inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit, sipas llogarive përkatëse, është sipas tabelës që vijon.

Llogaritë	327	2181	2184	2185	2186	2187	214	
Emërtimi	Materiale ndryshme	Rafte, tavolina, karrrike etj.	Fotokopje	Fakse	Kompjuterë	Printera Fotokopje	Paisje ndryshme	Totali
Sh. Lekë	1,819,598	7,713,521	710,940	20,040	3,898,234	2,876,952	1,372,777	18,412,062

Burimi: Sektori i financës

Kjo pasqyrë është sipas Pasqyrave të Bilancit të vitit 2018, Formati nr. 7/b Gjendja dhe ndryshimet afatgjata (Vlera neto)

Në përfundim

Në pasqyrat financiare dhe llogaritë kontabële të vitit 2018, janë kryer sistemimet e llogarive sipas rezultateve të inventarëve të vitit 2017, ku janë nxjerrë nga inventari gjithsej 18,412,062 lekë, pra sistemi i llogarive sipas rezultateve të inventarizimit, nuk është bërë për vitin kur është kryer inventarizimi.

Kjo praktikë e mos pasqyrimit në kohë të rezultateve të inventarizimit, është shkelje e kërkesave të UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Kap. II, pikat 5, 8, 30.

Nga ana e grupit të auditimit, referuar të dhënave të riskut *u testua rakordimi* i gjendjes fizike sipas inventarëve me gjendjen kontabël të mjeteve të transportit, llogaria 215 sipas të dhënave të pasqyrës si vijon:

Nr	Njësitë Administrative	Sipas inventarit Fizik		Vlera kontabël (Historike)	Diferenca
		Vlera Lekë	Nr. mjtesh		
1	Njësia Koplík	57,432,996	19		
2	Njësia Qender	1,644,000	2		
3	Njësia Kelmend	8,037,000	5		
4	Njësia Kastrati	9,079,275	4		
5	Njësia Gruemirë	2,473,200	1		
6	Njësia Shkreli	12,349,870	4		
	Zjarrfikëse dhe Rrugët Rurale	2,253,400	5		
	Shuma	93,269,741	40	93,269,741	

Burimi: Të dhënat janë nxjerrë nga grupi KLSH

Nuk u konstatuan diferenca midis vlerës sipas raportimit në pasqyrat financiare për llogarinë 215 “Mjete transporti” me inventarin fizik të kryer sipas kartelave inventariale të personave përgjegjës material.

-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë: 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2018.

U audituan gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (Kosto historike) sipas të dhënave të Formati nr. 7/a (Vetëm për llogaritë që kanë pasur shtesa dhe pakësime) si vijon:

Lekë

**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

Nr	Nr. llogarisë	Gjendja në fillim të vitit	Shtuar		Pakësuar	Gjendja në fund të vitit
			Blerje	Brenda sistemi		
1	A. Afatgjatë Materiale					
2	212 Ndërtime Konstruksiione	740,019,271	122,683	0	1,372,777	738,769,177
3	213 Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,663,452,612	204,486,405	0	0	1,867,939,017
4	214 Instal. Teknike, mak. Paisje, vegla pune	29,479,305	3,010,800	384,000	0	32,874,105
5	215 Mjete transporti	89,370,941	3,898,800	0	15,219,687	78,050,054
6	218 Inventar ekonomik	97,419,789	0	2,521,920	0	99,941,709
	Shuma	2,619,741,918	211,518,688	2,905,920	16,592,464	2,817,574,062

Blerjet për llogaritë 212-215 përfaqësojnë investimet gjatë vitit për këto llogari. Kurse për shtesat brenda sistemit është bërë veprimi kontabël duke debituar llogarinë 21 përkatës në kredi të llogarisë 231 respektive. Për llogaritë 214 dhe 218 përfaqësojnë shtesat në inventarë të materialeve të blera gjatë vitit 2018 por që nuk janë likuiduar brenda vitit ushtrimor dhe është bërë veprimi kontabël debi llogaria 21 përkatëse në kredi të llogarisë 467 respektive.

Vepruar si në rastin e llogarisë 214 shtuar për vlerën 384,000 lekë e cila është likuiduar me Urdhër Shpenzimin 151 datë 20.03.2019 Paisje bllokues për automjete me vlerë 198,000 leke dhe Urdhër Shpenzimi 599 datë 25.10.2019 Motorrkorrese bari me vlerë 186,000 lekë.

Përsa janë vendosur në Formatin 7/a pakësime në llogaritë 212 për vlerën 1,372,777 lekë dhe në llogarinë 215 për vlerën 15,219,687 lekë, referencat janë të gabuara pasi sipas inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit dhe të dhënave të Formatit nr. 7/b, këto pakësime u përkasin llogarive 214 dhe 218 referuar rezultateve të inventarizimit. Në Formatin 7/b, regjistrimet kontabël, janë konformë rezultateve të inventarizimit.

-Analiza e llogarive debitorë viti 2018

Në pasqyrat financiare të vitit 2018, gjendja e llogarisë debitorë 468 "Debitorë të ndryshëm", paraqitet me vlerë kontabël 30,808,197 lekë, kjo llogari është pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën $(38,890,038 - 30,808,197) = 3,571,141$ lekë.

Në këtë llogari, janë evidentuar edhe subjekte debitorë për tatim taksat lokale. Më hollësisht për debitorët të subjekteve tatim taksave vendore, janë analizuar në pikën përkatëse sipas programit të auditimit. Sipas të dhënave analitike të kësaj llogarie, vlera e debitorëve për tatim taksat lokale, është në vlerën 23,046,240 lekë.

Diferenca për $(30,808,197 - 23,046,240) = 7,761,957$ lekë, janë për 9 subjekte debitorë nga ish Komunitat, sot Njësi Administrative të Bashkisë Malësi e Madhe dhe për dy subjekte të tjera sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimet e kaluara. Më konkretisht analizuar si më poshtë vijon:

	Subjekti debitor	Viti i krijimit	Shuma Lekë	Shënime
1	F. H. (Gjobë)	2009	550,000	Nga ish Komunitat
2	F. M. (Gjobë)	2009	50,000	Nga ish Komunitat
3	F. SH. (Gjoba)	2009	505,900	Nga ish Komunitat
4	M. B.		1,000,000	Nga ish Komunitat
5	G. I.		897,360	Nga ish Komunitat
6	M...D		1,240,267	Nga ish Komunitat
7	D...X	2015	717,220	Nga ish Komunitat
8	S...I	2018	2,131,854	Nga auditimet e KLSH
9	B...i	2018	669,356	Nga auditimet e KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Subjekti debitor	Viti i krijimit	Shuma Lekë	Shënime
Shuma		7,761.957	

-Llogaria 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" për vlerën kontabile 5,560,256 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 79 subjekte persona fizikë dhe përfaqëson debitorë për paga dhe paradhënie në vite. (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 4)

-Analiza e llogarive kreditore viti 2018

Gjendja e llogarive kreditore, sipas pasqyrave financiare, është si më poshtë vijon:

Llogaritë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është për vlerën 116,724 lekë e shtuar gjatë vitit ushtrimor.

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është për vlerën 185,649,966 lekë e pakësuar nga viti paraardhës për diferencën (248,036,858- 185,649,966)= 62,386,892 lekë. (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 5)

Kjo llogari është e analizuar për 109 subjekte kreditore. Nga këto për 29 subjekte në vlerën **39,750,140 lekë, detyrime nga viti 2014** dhe janë trashëguar si të tilla nga ish Komunat, në dy raste për vlerën totale 16,491,149 lekë, përfaqësojnë detyrime sipas vendimeve të formës së prerë të Gjykatave në viteve 2013 dhe 2015, në 5 raste për vlerën 39,025,925 lekë, janë detyrime nga viti 2017 ndaj subjekteve për punime të kryera sipas kontratave të lidhura midis palëve. Diferenca për 145,899,826 lekë, përfaqësojnë detyrime të krijuara gjatë vitit 2018.

Impakti:

Në menaxhimin e burimeve financiare të Bashkisë si dhe pagesën e detyrimeve kreditore.

Shkaku:

Mos zbatimi i kërkesave ligjore në menaxhimin e fondeve dhe programimin e buxhetit vjetor, mos programimi i pagesës së detyrimeve të kaluara dhe mos marrjen e angazhimeve të reja pa pasur burimet e financimit.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave ligjore, duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit. Të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

2. Titulli i gjetjes: Në fund të vitit Bashkia M. Madhe ka pasur fonde të pa përdorura të trashëgueshme për vitin 2019, në shumën 97,657 mijë lekë, ndërkohë që detyrimet kreditore për vitin 2018 janë në shumën 114,509 mijë lekë.

Situata:

-Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. Viti 2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponilitete në Thesar”, është në pasqyrat financiare për vlerën debitorë 97,657,442 lekë. Kjo vlerë është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Malësi e Madhe, dhe e analizuar si vijon:

<i>Të trashëguara nga viti 2018.</i>	
Sipas akt rakordimit për vlerën.....	154,770,640 lekë.
Këto të ardhura të trashëguara, janë të analizuar me burime si vijon:	
Grande dhe të ardhurat lokale	142,100,640 lekë,
Grande specifike	12,670,146 lekë

II. Të hyra (shtesat debitorë) gjatë vitit 2019	381,144,753 lekë.
Granit i vitit i pa kushtëzuar	239,876,789 lekë
Të ardhurat e veta.....	47,990,419 lekë
Granit specifik	93,277,545 lekë
Totali i te ardhurave (Hyrjet debitorë) për vitin 2019 (I+II).....	535,915,393 lekë.

III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:	
Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore)	438,257,952 lekë.

Gjendja debitorë (Saldo debitor) në vitin 2019, është $(535,915,393 - 438,257,952) = 97,657,441$ lekë.

-Po kështu **llog. 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”**, në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 35,768,687 lekë dhe është sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, shtuar gjatë vitit ushtrimor për $(35,768,687 - 30,989,676$ që është ngurtësimi në fund të vitit 2018) = 25,22,989 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për garanci të punimeve të kryera në vitet para vitit 2018. **Konkretisht për 25 raste në shumën 4,962,799 lekë, janë ngurtësime nga viti 2017 të cilave u ka kaluar afati i garancisë dhe si të tilla duhet të ngurtësohen dhe të përdoren në interes publik nga Bashkia e M. Madhe.** (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 6)

-Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik viti 2019:

Për vitin 2019, na u paraqit ky dokumentacion mbi kryerjen e inventarizime fizike të aktiveve të Bashkisë Malësi e Madhe.

Për kryerjen e inventarizimi, Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e komisioneve të inventarizimit me Urdhrat nr. 128/129/130/ 131/132/133, datë 12.12.2019 me nr. 6098/ 6099/ 6100/ 6101/ 6102/ 6103 prot., datë 12.12.2019.

Për asgjësimin e inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit, është krijuar komisioni me Urdhri Nr.138, datë 27.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë.

Nga ky komision për vitin 2019 janë propozuar për ti nxjerrë jashtë përdorimit gjithsej vlera inventarizimi për shumën 4,939,064 lekë dhe sipas llogarive është; llogaria 218 në vlerë 4,506,158 dhe llogaria 327 në vlerë 432,906 lekë.

Nxjerrjet jashtë përdorimit, janë miratuar me Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Nr. 169 prot., datë 24.12.2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Për asgjësimin e inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit, është krijuar komisioni me Urdhri Nr.138, datë 27.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë.

Sistemi i llogarive sipas rezultateve të inventarizimit fizik, është pasqyruar në Formatin nr. 7/a mbi: "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (Kosto historike)", ku llogaria 218 është pakësuar për 4,506,158 lekë inventarë të nxjerra jashtë përdorimit.

-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë: 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32 viti 2019.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike si dhe lëvizjet në këto llogari shitesat dhe pakësimet dhe veprimet kontabël të kryera për këto raste. Referuar pasqyrave financiare përkatësisht Formatin nr. 7/a mbi: "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (Kosto historike)", është si vijon:

Lekë

Nr	Nr. llogarisë	Gjendja në fillim të vitit	Shtuar			Pakësuar Nxjerrje jashtë përdorimit	Gjendja në fund të vitit
			Blerje	Jashtë sistemit	Brenda sistemit		
	A. Afatgjatë Materiale						
	210 Toka, troje terrene	9,342,194	479,989			9,822,183	
	212 Ndërtime Konstrukione	738,769,177	131,906,226	29,618,502		900,293,905	
	213 Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,867,939,017	321,937,326			2,189,876,343	
	214 Instal. Teknike, mak. Paisje, vegla pune	32,874,105	11,535,110		394,800	44,804,015	
	215 Mjete transporti	78,050,054	3,870,000	2,050,000		83,970,054	
	218 Inventar ekonomik	99,941,709	4,857,000	5,836,840	108,000	106,237,391	
	Shuma		474,585,651	37,505,342	502,800	4,506,158	


A-Shtesat jashtë sistemit në shumën 37,505,342 lekë për llogaritë 212, 215 dhe 218, përfaqësojnë përsa më sipër dhurimet e shtuara në inventarë nga subjekte të ndryshme. Për këto është prerë fletë hyrjen dhe është mbajtur procesverbali marrjen në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe është kryer ky veprim kontabël debitohet llogaria 21 përkatëse në kredi të llogarisë së fondeve 101. Duke e analizuar si vijon:

1-Vlera 29,618,502 lekë përfaqëson shtesën *pa pagese* të ndërtimit shtesës të godinës së Shkollës së Mesme Kopluk të financuar nga IADSA. Referuar kontratës në gjuhën angleze me Ref. No. IADSA/2017/02 të lidhur datë 20.04.2017 midis Ministrisë së Financave të R. Shqipërisë, Kryetarit të Bashkisë M. Madhe dhe Ambasadës Italiane në R. Shqipërisë me vlerë totale për 40,087,551 lekë.

Referuar dokumentacionit si me poshtë:

- Kontrate punimesh nr. 3689 datë 4.09.2017, për vlerën 28,100,485 lekë, përkatësisht faturat tatimore 36 datë 01.02.2018, vlerë 6,893,889 lekë, faturës tatimore 38 datë 12.02.2018, vlerë 6,893,889 lekë, faturës tatimore 39 datë 23.02.2018, vlerë 6,893,889 lekë, faturës tatimore 39 datë 23.02.2018, vlerë 7,418,817 lekë.

-Kontratës së projektimit nr. 2259 datë 13.05.2017 me vlerë 1,010,400 lekë. Faturës tatimore nr 316 datë 20.09.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

-Kontratë supervizim nr. 3869/1 datë 04.09.2017 me vlerë 438,018 lekë dhe faturës tatimore nr. 04, datë 06.12.2018.

-Akt Marrëveshjes nr. 7466 prot. Datë 04.12.2018 për kolaudimin e punimeve për vlerën 69,600 lekë dhe faturës tatimore nr. 304, datë 06.12.2018. Gjithsej shtese pa pagese në *llogarinë 212*.

Shuma = 28,100,485 + 1,010,400 + 438,018 + 69,600 = 29,618,502 lekë

Veprimi kontabël për këto shtesa është debi te llogarisë 21 përkatëse te kredi te llog. 101.

2-Vlera 2,650,000 lekë nga të cilat në *llogarinë 215* për vlerën 2,050,000 lekë përfaqëson vlerën e dy automjeteve zjarrfikese *dhuruar* për Bashkisë Malësi e Madhe nga komuna Namur, Belgjike. Kjo Komunë përveç dy zjarrfikësve i ka dhuruar Bashkisë dhe një Autoambulancë në vlera 600,000 lekë sipas akt-dhurimeve dt. 18.06.2019 dhe 01.09.2019.

Këto aktive, janë bërë hyrje sipas Fletë hyrjes nr. 42, datë 30.12.2019, referuar procesverbalit nr. 6266/1 prot., datë 30.12.2019, detajuara si vijon:

-Zjarrfikës Mercedes copë 1 lekë	850,000 lekë,
-Ambulancë Mercedes copë 1 lekë	600,000 lekë,
-Zjarrfikës cisternë steyr copë 1 lekë	1,200,000 lekë.

Shuma = 2,650,000 lekë

Kurse për Ambulancën, pas marrjes në dorëzim me vlerë 600,000 lekë i është dorëzuar Drejtorisë së Shërbimit Spitalorë Malësi e Madhe qe si rrjellojë nuk është e pasqyruar në pasqyrën e aktiveve te Bashkisë, kjo gjë referuar procesverbalit të dorëzimit datë 30.12.2019 dhe Fletë Daljes nr. 370 dt. 30.12.2019.

3-Vlera 5,836,840 lekë e analizuar si vijon:

4,961,640 lekë përfaqëson, transferime *pa pagesë* për shkollat e Bashkisë M. Madhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë sipas dokumentacionit dërguar me shkresën Nr. 135 prot., datë 24.12.2019.

Referuar faturës tatimore nr. 32, datë 16.07.2019. Fletë hyrja në Bashkinë M. Madhe me nr. 43, datë 31.12.2019 për 17 artikuj Inventar ekonomik, *llogaria 218*.

226,700 lekë përfaqëson transferime *pa pagesë* për zyrat e gjendjes civile nga Ministria e Brendshme. Referuar Autorizimit nga Kryetari i Bashkisë për tërheqje materiali nr. 6183 dt. 20.12.2019, Fletë Daljes në Ministrinë e Brendshme me nr.702 datë 19.12.2019, Fletë hyrje në Bashkinë M. Madhe me nr. 40, datë 19.12.2019 për 6 artikuj Inventar ekonomik, *llogaria 218*.

Vlera 648,500 lekë përfaqëson transferime *pa pagese* nga investitori i Shkollës "Sherif Hoxha" "Involve me. i Learn "

Referuar faturës tatimore nr. seri. 69960300, datë 17.04.2019 për 41 artikuj. Fletë hyrje në Bashkinë M. Madhe me nr. 9 , datë 14.04.2019 për 41 artikuj Inventar ekonomik, *llogaria 218*. **Gjithsej shtese pa pagese në llogarinë 4,961,640 + 226,700 + 648,500 = 5,836,840 lekë.**

B-Shtesat brenda sistemi në shumën 502,800 lekë për llogaritë 214 dhe 2018, përfaqësojnë materiale të blera gjatë viti 2019 por të pa likuiduara brenda vitit.



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

C- Shtesa 502,800 lekë brenda sistemit përfaqëson:

1-Vlera 394,800 lekë përfaqëson shtesa *te blera por te palikuiduara* për radio komunikimi per Policinë Bashkiake.

Referuar aneksit nr. 9 Detyrime v. 2019, rreshti 19. Fletë hyrja në Bashkinë M. Madhe nr. 39 datë 19.12.2019, Fatura tatimore nr 82 datë 19.12.2019 për 13 artikuj. Ilogaria 214.

2-Vlera 108,000 lekë përfaqëson shtesa *të blera por të palikuiduara* të pajisjeve kompjuterike Laptop Printer.

Referuar aneksit nr. 9 Detyrime v. 2019, rreshti 3. Fletë hyrja në Bashkinë M. Madhe nr. 19 Datë 28.06.2019. Fatura tatimore 855V datë 28.06.2019 për 2 artikuj **Ilogaria 218**. Veprimi kontabël per këto shtesa është debi te llogarisë 21 përkatëse te kredi të 486.

Analiza kontabël e llogarive:

-Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" për vlerën historike 9,822,183 lekë gjatë vitit ushtrimor ka pasur shtesa për vlerën (9,822,183 - 9,342,194)= 479,989 lekë.

Gjendja e kësaj llogarie, e analizuar përfaqëson vlerën e

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI Lekë
D veprimeve	1	Celja e tepricës dt 01.01.2019	9,342,194
	2	Hartim i planit te detajuar Vendore	479,989
		Gjendja totale më 31.12.2019	9,822,183

Vlera e studimit për hartimin e planit Vendor, duhej të ishte kontabilizuar në llogarinë 202, veprim që duhet të sistemohet, pasi:

-Kemi të bëjmë me Aktive Afatgjatë jo materiale për të cilat normativat e llogaritjes së amortizimit është e ndryshme nga aktivet e tjera, referuar UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" Kap. III, pika 36.

-Kjo është në kundërshtim me përcaktimin e Aktiveve Afat gjatë jo materiale sipas përcaktimeve në referuar UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018, Kap. III, pika 62, Rubrika II.

-Llogaria 211 "Pyje, kullota Plantacione" për vlerën historike 15,388,760 lekë. Kjo llogari nuk ka pasur lëvizje në shtesa ose pakësime gjatë vitit 2019.

E analizuar në mënyrë kontabële kjo llogari përfaqëson vlerat si më poshtë:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	Objekti	
	2	Ndertim Lulishte Komuna Gruemire	3,429,858
	3	Gjelbërim i territoreve te Komunës Gruemire	3,052,480
	4	Gjelbërim territori i Shkolles Dedaj	477,660
	5	Gjelbërim territori i Shkolles Reç	478,224
	6	Gjelbërim territori i Shkolles Zagore	362,089
	7	Gjelbërim territori i Njësia Administrative Dedaj	480,000
	8	Gjelbërim varrezat Dedaj	479,016
	9	Gjelbërim territori i Shkolles Dodë Kaçja Bajze	479,213
	10	Gjelbërim territori i Shkolles Preke Gjoni	479,268
	11	Gjelbërim territori i Shkolles Dede Gjon Luli	478,598
	12	Gjelbërim territori i Shkolles Rapsh	479,596
	13	Gjelbërim territori varrezat Vukpalaj	479,683
	14	Gjelbërim territori i Shkolles Pjetershan	32,880
	15	Mbjellje Shelgu ne Jubice	477,660



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
	16	Gjelbërim territori i Shkolles Kamice	478,224
	17	Mbjellje plepa Lohë poshtë	158,304
	18	Pyllezim me Selvi varrezat Jubice	479,016
	19	Gjelbërim ne Njesine Administrative Kelmend	2,606,991
		Gjendja totale më 31.12.2019	15,388,760

Burimi: Sektori i financës

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” për vlerën historike 900,293,905 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (900,293,905 - 738,769,177)= 161,524,728 lekë e analizuar për objektet si më poshtë vijon:


REFERENC	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	Çelja e tepricës dt 01.01.2019	738,769,177
	2	Lyerje ONE STOP SHOP	206,520
	3	Rikonstruksion Shkolla "Dede Gjon Luli Hot"	3,927,558
	4	Rikonstruksion Shkolla "Rifat Nuzi" Rec	5,769,026
	5	Rikonstruksion Shkolla "Vasil Shanto" Vrake	6,357,684
	6	Rikonstruksion Shkolla "Muhamet Hasmuja" Ktosh	6,711,744
	7	Rikonstruksion Shkolla Kçar I poshter	1,470,688
	8	Rikonstruksion Shkolla Sherif Hoxha Koplik	55,058,014
	9	Rikonst. I Shkolles 9-vjecare "Abdyl Bajraktari" dhe Kopeshtit Koplik	76,000,113
	10	Rrethim Varreza	1,949,560
	11	Rikonstruksion Godina ekzistuese ne Tamare	3,943,033
	12	Kolaudim Qendra kulturore Dedaj	130,788
		Gjendja totale më 31.12.2019	900,293,905

Burimi: Sektori i financës

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për vlerën historike 2,189,876,343 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (2,189,876,343- 1,867,939,017)= 321,937,326 lekë me analizë sipas të dhënave kontabël si vijon:

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e llogarive dt 01/01/2019	1,867,939,017
	2	Rruga Cenaj Rragom Lacaj	29,484,746
	3	Rruga fshati Marshej- Koplik Dedaj	23,589,012
	4	Rruga Ura e Zhajes Zagore	44,415,779
	5	Rruga Gjorm	29,326,071
	6	Sist. Rruga Llazan Autostrate	9,789,119
	7	Sistemim Asfaltim Rruga e Dragovoje	24,701,148
	8	Sistemim Asfaltim Rruga e Sigurimeve	11,802,017
	9	Rikualifikim Qendra Bajze	101,042,933
	10	Rikualifikim Aksi Koplik-Baypas	23,278,824
	11	Sistemim Asfaltim Rruga e Palvar-Pigza	7,349,770
	12	Ndertim Sheshi I Bashkisë	7,658,093
	13	Rezervuari Goraj	5,816,241
	14	Sistemi I vaditjes Shetitorja Koplik	564,090
	15	Projekt Ures lidhese te fshatrave Vermosh- Velan-Velipoje	2,524,911
	16	Supervizim Shkolles 9-vjecare "Abdyl Bajraktari" likuiduar gabimisht ne llogarinë 2133100	594,572
		Shuma e tepricës dt 31/12/2019	2,189,876,343

Burimi: Sektori i financës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Vlera e supervizorit të shkollës 9 vjeçare "Abdyl Bajraktari" në shumën 594,572 lekë, duhej të ishte kontabilizuar në llogarinë e investimeve 212, pasi përmbajtja e shpenzimit është për objekt ndërtimor shkollë llogaria 212.

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" për vlerën kontabël 44,804,015 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (44,804,015- 32,874,105) = 11,929,910 lekë.

REFERENCA	NR	PERSHKRIMI	DEBI
D veprimeve	1	çelja e tepricës dt 01/01/2019	32,874,105
	2	Instalim I Tabelës Elektronike	9,573,854
	3	Blerje kosha te vegjël per trotuare	880,896
	4	Dera Akses kontrollor	117,600
	5	Bl. Kapak peseta Graveta	185,760
	6	Kondicioner	57,000
	7	Fikese zjarri	720,000
	8	Radio Komunikimi	394,800
		Shuma e tepricës dt 31/12/2019	44,804,015

Burimi: Sektori i financës

U verifikuan përsa vlerat e kondicionerit, fikse zjarri dhe radio komunikimi, janë kontabilizuar në llogarinë 214, janë vendosur në inventar të personave që i përdorin ato, kartelat inventariale të firmosura nga personat përkatës.

-Llogaria 2015 "Mjete transporti" për vlerën historike 83,970,054 lekë, shtuar gjatë vitit për diferencën (83,970,054 - 78,050,054)= 5,920,000 lekë. Kjo llogari është e analizuar sipas rezultateve të inventarizimit.

-Llogaria 218 "Inventar ekonomik" për vlerën historike 106,237,391 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (106,237,391 - 99,941,709)= 6,295,682 lekë.

-Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë M. Madhe Viti 2019

Për administrimin e Aseteve në Bashkinë Malësi e Madhe është krijuar Sektori i Aseteve nga viti 2016 e në vazhdim.

Janë përgatitur Regjistrat e aktiveve të qëndrueshme dhe janë plotësuar në zbatim të kërkesave të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kap. III, pika 26, 27 dhe 30.


Megjithatë për disa zëra të asetëve, është duke punuar dhe verifikuar objektet në terren për vendndodhjen e tyre, gjendjen fizike dhe funksionimin e tyre.

Aktualisht janë regjistruar në Kadastrën Urbane 15 objekte në pronësi të Bashkisë M. Madhe, të konfirmuara me shkresën nr. 1675 Prot., datë 28.06.2016 ku 12 janë Certifikata Originale të Pronësisë dhe 3 Vërtetime Hipotekore.

Në Proces për regjistrim janë pronat kaluar Bashkisë M. Madhe sipas miratimit me VKM nr. 366, datë 18.05.2016, nr. 458, datë 26.07.2018 dhe nr. 433, datë 8.6.2016.

- Analiza e llogarive debitorë viti 2019

-Llogaria 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" për vlerën 6,117,726 lekë, është e analizuar për 79 subjekte debitorë. (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. .7)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" për vlerën 43,565,134 lekë, është e analizuar përfaqëson të gjithë subjektet debitorë në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2019 dhe gjordat e vendosura personelit dhe të subjekteve të vendosura nga konstatimet në auditimet e periudhave të mëparshme. Në këtë llogari vlera 36,472,533 lekë janë debitorët për subjektet tatim taksat lokale. **Diferenca 7,092,601 lekë janë 8 subjekte debitorë nga viti 2008 për të cilat nuk është proceduar sipas ligjit për arkëtimin e vlerave debitorë.** (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 8)

-Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" për vlerën 114,509,322 lekë, në aktivin e bilancit. Paraqet detyrimet kreditore të pa paguara deri në periudhën e mbylljes së vitit ushtrimor. (Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 9)

Nga analiza e kësaj llogarie, detyrime ndaj të tretëve për tu paguar, konstatohet se: 72,049,100 lekë janë detyrime të krijuara gjatë vitit ushtrimor 2019, 22,387,896 lekë janë ndaj 8 subjekteve të trashëguara nga vitit 2018, 3,581,177 lekë janë detyrime para vitit 2015 ndaj 24 subjekteve dhe 16,491,149 lekë janë detyrime sipas vendime Gjyqësore ndaj 2 subjekteve para vitit 2015.

- Analiza e llogarive kreditore viti 2019

-Llogaritë 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 15,687,975 lekë ku sipas listë pagesës së muajit dhjetor, përfaqëson vlerën e pagës bruto minus tatimin mbi të ardhurat personale 16,407,165 - 719,195= 15,687,975 lekë.

Në këtë rast, detyrimi ndaj personelit, detyrimi neto, nuk është i saktë, pasi nuk është zbritur ndalesa për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe ndalesa për tatimin mbi të ardhurat. Sipas listë pagesave, paga neto është 13,737,187 lekë.

Në këtë rast llogaria **42 duhej të ishte detyrim pagë e pa paguar për punonjësit në vlerën 13,737,187 lekë.**

Pra diferenca 15,687,975- 13,737,187= 1,950,788 lekë, është pasaktësi për llogarinë 42 sepse nuk i tregon saktë detyrimet ndaj personelit për pagat.


Kuadrimi i kësaj llogarie, është duke analizuar; Shumën bruto të pagave - (detyrimet për tatimin mbi të ardhurat për tu paguar nga punonjësit + detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguhen nga personeli)

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat" për vlerën e pasqyrave financiare 719,190 lekë sipas përmbledhësës së listë pagesave të muajit dhjetor 2019, detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale.

-Llogaria 433 "Detyrime, shteti, fatkeqësi natyrore" për vlerën kontabël 2,460,677 lekë, është regjistruar gabim, **duhej të ishte regjistruar në llogarinë 436** dhe është detyrime për sigurime shëndetësore sipas përmbledhësës së listë pagesës së sigurimeve shoqërore të muajit Dhjetor 2019.

-Llogaria 432 "Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal" në pasiv të pasqyrave financiare për vlerën 49,682,860 lekë nuk ka analizë se çfarë përmban kjo llogari.

Pretendimi për kjo llogari 432 ka si kundërpasiv llogaritë debitorë llogaria 423 "Debitorë për paga dhe shpërblime" për vlerën 6,611,726 leke dhe llogaria 468 "Debitorë" për vlerën 43,565,134 lekë, nuk është e saktë për faktin se:



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

-Shumat e këtyre llogarive (6,611,726 + 43,565,134) = 50,176,860 lekë, janë më tepër për diferencën 50,176,860- 49,682,860= 494,000 lekë për të cilat nuk kundrojnë vlerat debitorë me kreditin e llogarisë 432.

-Përveç kësaj, nga analiza e llogarive 423 dhe 468, konstatohet se në to janë kontabilizuar debitorë të ndryshëm, ku vetëm shuma 36,472,533 lekë janë debitorë për tatim taksat lokale.

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vlerën 135,352,723 lekë përfaqëson detyrime për tu paguar në pasiv të pasqyrave financiare dhe është e analizuar sipas subjekteve kreditore dhe në vlerat përkatëse.

Bazuar në UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kap. III, pika 42, kjo llogari ka si kundërparti veprimin kontabël në debi të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" llogari e cila në pasqyrat financiare është për vlerën debitorë 114,509,322 lekë dhe është e analizuar për këtë vlerë sipas subjekteve, faturave dhe vlerave përkatëse.

Në këtë rast diferenca për (135,352,723- 114,509,322)= 20,843,401 lekë, është vlerë e pa justifikuar me dokumente. Për diferencën 20,843,401 lekë gjendja kreditore e llogarisë 467 është më shumë se gjendja debitorë e llogarisë 486 përsa mungojnë dokumentet vërtetues, pra fiktivitet, në kundërshtim me kërkesat ligjore të sipërcituar mbi funksionimin e këtyre dy llogarive.

Pra diferenca për 20,843,401 lekë, nuk ka kundërparti debitorë për të balancuar kreditin e llogarisë 467.

Në pasqyrat financiare të vitit 2019, nuk përdorur llogaritë specifike të lidhura me të drejtat dhe detyrimet që evidentojnë institucioni për marrëdhëniet me shtetin (Llog. 4342 e 4341) si të drejtat dhe detyrimet, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi mbi: "Veçoritë e evidencës të llogarive të klasës"

(Gjerësisht problemet janë trajtuar në faqen 46-58 të Projektraport Auditimit)

Komente dhe sqarime:

Me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH me nr. 259/4, datë 10.06.2020), nga A. RR. me detyrë Drejtor i Financë/Buxhetit, janë paraqitur kundërshti lidhur me sa janë konstatuar pasaktësi në disa llogari të pasqyrave financiare të vitit 2019:

1-Përsa kontabilizuar në debit ë llogarisë 210 "Toka, troje, terrene" vlera studimit "Hartimi I Planit të detajuar Vendor".

2-Përsa shpenzimet e supervizimin për objektet e përfunduara nuk janë kontabilizuar në debit ë vlerës së objektit.

3-Përsa llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit", nuk pasqyron saktë detyrimet për pagat.

4-Përsa llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" dhe llogaritë e tjera kreditore, nuk janë të kundruara me llogarinë kundërparti 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme".

Sqarimi i grupit të auditimit sipas pikave më sipër:

1-Nuk merret në konsideratë pasi nuk keni dhënë sqarime të bazuara në kërkesa ligjore.

2-Ok përsa keni pranuar se do të sistemohet llogaria gjatë vitit 2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

3-Ju nuk keni sjellë argumente dokumentarë, nuk merret në konsideratë ndërkohë nga jonë, është analizuar referuar dokumenteve kontabël, diferenca e pasaktësisë të kësaj llogarie.

4-Pretendimet tuaja nuk janë të argumentuara referuar kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi mbi: "Veçoritë e evidencës të llogarive të klasës".

IV/C .1 - Ekzekutimi i testeve thelbësore të veprimeve të kryera me bankë.

1. Titulli i gjetjes: Nga testimi i llogarive të detyrimeve për tu paguar.

Situata:

Testimi i llogarive

Përgjithësisht, konstatohet se shpenzimet (transaksionet), janë bazuar në dokumentacionin e nevojshme ligjor dhe evidentuar në llogaritë përkatëse sipas përmbajtjes ekonomike, por që një pjesë e tyre nuk janë regjistruar si detyrime në pasqyrat financiare të viteve respektive, konkretisht janë testuar gjithsej 11 urdhër pagesa në vlerën 116,459,463 lekë, nga e cila në vitin 2018 janë testuar 6 urdhër pagesa në shumën 52,087,280 lekë dhe për vitin 2019 janë testuar 11 urdhër pagesa në shumën 64,372,183 lekë, si vijon:

• Banka 2018.

-Me urdhër shpenzimi nr. 61, datë 21.02.2018, është paguar subjekti "G...R" për blerje karburanti në vlerën 5,362,720 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 64, datë 26.02.2018, është paguar subjekti "L...A" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 9,975,000 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 68, datë 2.03.2018, është paguar subjekti "A...U" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 18,000,000 - 5% garanci punimesh = 17,100,000 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 70, datë 2.03.2018, është paguar subjekti "B...I" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 6,250,000 - 5% garanci punimesh = 5,937,500 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 71, datë 2.03.2018, është paguar subjekti "K...N" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 6,249,780 - 5% garanci punimesh = 5,937,291 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 102, datë 19.03.2018, është paguar subjekti "K...N" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 6,249,780 - 5% garanci punimesh = 5,937,291 lekë.

• Banka 2019.

-Me urdhër shpenzimi nr. 36, datë 6.02.2019, është paguar subjekti "L...A" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 1,750,000- 5% garanci punimesh = 1,662,500 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

-Me urdhër shpenzimi nr. 37, datë 6.02.2019, është paguar subjekti "L...A" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 11,315,921 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 38, datë 6.02.2019, është paguar subjekti "S...I" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 5,600,033- 5% garanci punimesh = 5,320,031 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 42, datë 7.02.2019, është paguar subjekti "S...I" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 5,250,000 - 5% garanci punimesh = 4,987,500 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 39, datë 6.02.2019, është paguar subjekti "S...J" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 15,447,300 - 5% garanci punimesh = 14,674,935 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 39, datë 7.02.2019, është paguar subjekti "N...A" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 3,500,000 - 5% garanci punimesh = 3,325,000 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 40, datë 7.02.2019, është paguar subjekti "N...A" për rikonstruksion rrugësh në vlerën 3,500,000- 5% garanci punimesh = 3,325,000 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 41, datë 7.02.2019, është paguar subjekti "N...A" për rezervuar uji në vlerën 2,110,749 - 5% garanci punimesh = 2,005,212 lekë. Referuar fatura nr. 38, datë 11.12.2018.

-Me urdhër shpenzimi nr. 97, datë 1.03.2019, është paguar subjekti "N...A" për rikonstruksion shkolle në vlerën 9,945,916- 5% garanci punimesh = 9,448,620 lekë.

-Me urdhër shpenzimi nr. 93, datë 21.02.2019, është paguar subjekti "M...I" për rikonstruksion shkolle në vlerën 5,952,264 - 5% garanci punimesh = 5,654,651 lekë.

Konstatohen *pa deklaruar si detyrime në bilancin e vitit 2018*, fatura tatimore për një rast *në shumën 15,447,300 lekë si vijon:*

-Subjekti "S...J", fatura tatimore nr. 182 datë 03.06.2018 për vlerën 30,292,680 lekë, kjo faturë është paguar pjesërisht datë 18.10.2018 në vlerën 14,845,380 lekë, ndërsa diferenca *për 15,447,300 lekë, nuk është pasqyruar si kreditor më 2018.*

**** Gjithashtu u audituar rregullshmëria e likuidimit të faturave të vitit 2019 gjatë periudhës së 4/mujorit parë/2020, ku është konstatuar se **23** fatura me vlerë 55,235,838 lekë të vitit 2019 janë likuiduar gjatë vitit 2020, *ku në 5 raste me vlerë 9,530,202 lekë faturat nuk kanë qenë të regjistruara si detyrime në bilancin e vitit 2019, konkretisht pasqyra:*

Faturat e vitit 2019, likuiduar gjate vitit 2020						Nuk paraqiten si fatura kreditore më 31.12.2019
Urdhër shpenzimi						
Nr.	Nr	Datë	Vlera/lekë	Objekti shpenzimit	Subjekti	
1	83	10.02.2020	2,392,342	Mirembajtje dhe riparim automjetesh	L. N.	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”


Faturat e vitit 2019, likuiduar gjate vitit 2020						Nuk paraqiten si fatura kreditore më 31.12.2019
Urdhër shpenzimi						
Nr.	Nr	Datë	Vlera/lekë	Objekti shpenzimit	Subjekti	
2	110	13.02.2020	4,689,722	Rikonstruksion i Shkolles "Vasil Shanto", Fshati Vrake	“M...P”	4,689,722
3	113	14.02.2020	3,900,000	Sistemim Asfaltim Rruga Palvar	L...J	3,900,000
4	94	10.02.2020	3,000,000	Sistemim Asfaltim rruga Shkolla e Mesme-Sukapigeza	L...J	
5	103	11.02.2020	6,000,000	Sistemim Asfaltim rruga Fundi i Brinjës	N...A	
6	102	11.02.2020	3,000,000	Sistemim Asfaltim Rruga Rrustemaj-Stationit (Lagje e Re Koplik)	L...J	
7	97	11.02.2020	4,500,000	Sistemim Asfaltim Rruga Vukpalaj	N...A	
8	28	22.01.2020	857,880	Dekor per festa	S...I	857,880
9	45	23.01.2020	41,300	Fushe futbollit	N. D.	41,300
10	46	23.01.2021	41,300	Fushe futbollit	N. D.	41,300
11	86	10.02.2020	958,800	gaz per ngrohje	"G...G"	
12	92	10.02.2020	134,688	Sherbim Interneti	M...I	
13	220	22.4.2020	5,800,000	Rikonstruksion "Eko Kampi Shegan dhe Pandus per personat me aftësi te Kufizuara per Nj. Adm. Ke	M...I	
14	152	17.3.2020	3,700,000	Ndertim ujësjellësi Balshaj	L...J	
15	169	24.3.2020	10,070,573	Rik. Shkolla Vasil Shanto	“M...P”	
16	222	22.4.2020	4,500,000	Riparime me Asf. Rruge Rurale	S...I	
17	87	10.2.2020	356,141	Veshje per Sherb. Publike	B...a	
18	88	10.2.2020	118,334	Blerje Flamuj	M. O.	
19	90	10.2.2020	105,600	Qera Ambienti	SH...I,	
20	91	10.2.2020	105,600	Qera Ambienti	SH...I	
21	40	22.01.2020	195,248	Sherbime Postare Dhjetor '19		
22	85	10.2.2020	244,000	Lavazh per Makineritë Grasatim	L...E	
23	112	14.2.2020	524,310	Materiale Pastrimi	S...P	
SHUMA			55,235,838	-	-	9,530,202

- **Në 72 raste me vlerë 102,369 mijë lekë**, likuidim i faturave është kryer jashtë afatit **30 ditor** nga momenti i dorëzimit të tyre në subjektin Bashkia Malësi e Madhe, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën *Aneksi B/1 bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 7, datë 22.05.2020*.

- **Në 19 raste**, faturat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, kështu nga vlera prej 152,645 mijë lekë janë likuiduar nga bashkia vlera prej 120,725 mijë lekë të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën *Aneksi B/2 bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 7, datë 22.05.2020*.

Kriteri:

Kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kap. II, pikat 5, 8, 30; pika 3 e nenit 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014 dhe nenin 55 të ligjit nr. 68/2017, datë 24.7.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kap. II, pikat 5, 8, 30, **duke ngarkuar me përgjegjësi A. RR me detyrë Drejtori i komanduar Financës/Buxhetit, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues dhe specialisten e kontabilitetit E. R..**

Impakti:

Në gjendjen financiare të Bashkisë Malësi e Madhe.

Shkaku:

Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: *E lartë.*

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa që në zbatim të kërkesave ligjore në programimin e buxheteve, kryerjen e pagesave të detyrimeve kreditore në kohë dhe vlerën e tyre të plotë, si dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet për pasqyrimin e saktë të situatës kreditore që Bashkia Malësi e Madhe ka ndaje të tretëve.

2. Titulli i gjetjes: *Testimi mbi llogarinë 6001 "Paga personeli dhe krijimi i strukturës së Bashkisë Malësi e Madhe*

- **Për vitin 2018.**


Numri i punonjësve për vitin 2018, është miratuar me vendimin nr. 17 prot. datë 31.01.2018 të Këshillit Bashkiak në total **379 punonjës**, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.185/1 prot, datë 15.02. 2018.

Kryetari Bashkisë Malësi e Madhe me urdhrin nr. 08 prot, datë 30.01.2018, ka miratuar strukturën organizative sipas numrit të përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Në fakt janë paguar 385 punonjës (referuar muajit Dhjetor 2018). Gjatë viti 2018 (për 12 muaj), shpenzimet totale (bruto) për pagat, llogaria 600, rezultojnë 179,286,000 lekë. Në fund të vitit ushtrimor, janë pa pagua pagat e 2018 për shumën **14,798,446 lekë**, pasqyruar në llogarinë 421 të pasivit të bilancit si detyrim për tu paguar.

- **Për vitin 2019.**

Numri i punonjësve është miratuar me vendimin nr. 06 prot. datë 21.01.2019 të Këshillit Bashkiak, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve për vitin 2019, në total **395 Punonjës**, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 98/1 prot. datë 04.02.2019.

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe me urdhrin nr. 119 prot, datë 31.12.2018, ka miratuar strukturën organizative sipas numrit të përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Kjo strukture ka ndryshuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18 datë 22.02.2019 dhe miratimin e Prefektit të Qarkut Shkodër me shkresën nr 232/1 prot datë 06.03.2019. Ka ndryshuar me Vendim të KB nr. 22 datë 22.02.2019 dhe miratimin e Prefektit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

të Qarkut Shkodër me shkresën nr 236/1 prot datë 06.03.2019. Në fakt janë paguar 385 punonjës (referuar muajit Dhjetor 2019).

Gjatë vitit 2019 (për 12 muaj), shpenzimet totale (bruto) për pagat, llogaria 600, rezultojnë 196,746,000 lekë. Në fund të vitit ushtrimor, janë pa paguar pagat e muajit dhjetor 2019 për shumën **15,687,975 lekë**, pasqyruar në llogarinë 421 të pasivit të bilancit si detyrim për tu paguar.

- Listëpagesat, janë të firmosura nga inspektori i Financës, Përgjegjësi i Financës dhe Titullari i Institucionit që është Kryetari i Bashkisë. Listprezencat, janë të firmosura nga përgjegjësit e sektorëve dhe shefi I personelit.

Sipas strukturës aktuale, bashkia ka 105 vende pune me punonjës të shërbimit civil, nga të cilat janë plotësuar 31 pozicione, ndërsa 67 pozicione nuk janë të plotësuara, por janë plotësuar me punonjës të tjerë me kontratë apo akte emërimi pa u zbatuar procedurat e konkurrencës.

Janë pozicione të lira të shërbimit civil 7 pozicione, *konkretisht*: Sekretari i Përgjithshëm, Specialist Ambienti, Specialist Urbanistike, Specialist Inxhinjer ndërtimi, Specialist finance/arkiv/protokoll në NJA Shkrel, Specialist Kadastrë në NJA Kelmend dhe Inspektor Taksash në NJA Kelmend.

Këto mangësi janë evidentuar dhe nga auditimi i kryer nga Komisioneri i Shërbimit Civil sipas urdhrit nr. 97, datë 23.10.2019, ku në përfundim kanë dale me vendim nr. 97, datë 23.10.2019, duke lënë rekomandime për ndryshimin e situatës.

Për vitin 2020, struktura e Bashkisë Malësi e Madhe ka pësuar ndryshime, miratuar kjo me Vendim nr. 5, datë 18.01.2020 të Këshillit Bashkiak dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 70/1, datë 29.01.2020, konkretisht: *Janë 5 Njësia Administrative me 52 punonjës (NJA Qendër me 8 punonjës; NJA Kastrat me 11 punonjës; NJA Kelmend me 12 punonjës; NJA Shkrel me 8 punonjës dhe NJA Gruemirë me 13 punonjës.*

a- *Janë krijuar 7 drejtori, konkretisht: Drejtoria e Burimeve Njerzore me 17 punonjës (vendi i drejtorit vakant); Drejtoria e Financës dhe Menaxhim Buxheti me 8 punonjës (drejtor komanduar); Drejtoria e të Ardhurave me 8 punonjës (drejtor vakant); Drejtori e PZHT me 8 punonjës (drejtor vakant); Drejtoria Juridike me 9 punonjës (drejtor vakant); Drejtoria e Shërbimit Pyjor me 42 punonjës me drejtor komanduar; Drejtoria e Administrimit të Pyjeve me 17 punonjës me drejtor të emëruar.*

b- *Janë krijuar dhe 10 sektorë, si: Sektori i Ndihmës Ekonomike me 14 punonjës; Sektori i Turizmit me 3 punonjës; Sektori i Kadastrës me 10 punonjës; Sektori i Sportit me 5 punonjës; Sektori i Mirëmbajtjes së Rrugëve me 27 punonjës; Sektori i PMNZSH me 22 punonjës; Sektori i ujitjes dhe kullimit me 6 punonjës; Sektori i Emergjencave Civile me 4 punonjës; Sektori i Auditit me 3 punonjës dhe Sektori i Sportit me 5 punonjës*

c- *Punonjës të deleguar, si: Arsimit parashkollor edukator dhe punonjës të qendrës kulturore me 61 punonjës; punonjës psikolog në arsimin 9-vjecar me 4 punonjës; punonjës të shërbimeve mbështetës me 10 punonjës; punonjës të arsimit*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

të mesën 10 punonjës; punonjës të Gjendjes Civile me 7 punonjës; punonjës të QKB me 1 punonjës; punonjës sezonale (vrotues sezonale të pyjeve) me 10 punonjës dhe punonjës sezonale (shërbime publike) me 10 punonjës. **Gjithsej numri i punonjësve prej 427 persona.**


Referuar analizës së riskut për testet e kryera mbi pagesën e punonjës (klasifikimin dhe nivelin arsimorë), konstatohet se dosjet të personelit kanë këto mangësi:

- a- Dosjet nuk janë të inventarizuara me numër rendor;
- b- Në pjesën më të madhe mungojnë vlerësimet e punës së punonjës dhe masat disiplinore/administrative që punonjësit mund të marrin gjatë periudhave;

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e periudhës (Janar- Mars 2018; Tetor-Dhjetor 2018 dhe Janar- Mars 2019; Tetor-Dhjetor 2019), ku konstatohet se mbështetur në Vendimin të KM nr.142, datë 12.03.2014 ndryshuar me VKM nr.305, datë 5.4.2017 dhe VKM nr. 765, datë 26.12.2018, për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e Administratës Shtetërore dhe institucioneve të pavarura", tek Kategoria IV Nënpunësi Civil të kategorive ekzekutive: Emërtimi i Pozicionit është vetëm Specialist i nivelit (a) dhe (b), pra lejohet vetëm emërtesa specialist dhe jo përgjegjës pasi përgjegjësit futen tek klasa e III kategoritë III-a/1 si dhe e III-b dhe arsimi duhet të jetë master shkencor e profesional; kjo e argumentuar në fund të çdo klase ku përcaktohen kërkesat e posaçme. Në VKM nr. 177, datë 8.3.2017, tek lidhja 4, klasa IV, kategoria IV-a, emërtimi i pozicionit të punës është vetëm specialist.

Në vendimin respektive të Këshillit Bashkiak për periudhën e viteve 2018 – 2019 – 2020 mbi strukturën e pagave, në disa pozicione pune janë emëruar punonjës jo me arsimin e duhur, duke i klasifikuar në kategorinë III/a-1, ndërkohë që janë me arsim Bachelor por jo master shkencor dhe duhej të vendoset kategoria e IV-a, **veprime të cilat kanë çuar në kryerjen e pagesave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore për vlerën 563,952 lekë, konkretisht pasqyra:**

- a- Punonjës **A. G.** me pozicion "Sekretar i Këshillit", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/ dhe funksioni në vlerën 44,074 lekë/ muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/ muaj ose më shumë për pagën neto 102,330 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.
- b- Punonjës **E. S.** me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 11.09.2019 – 30.03.2020 është paguar neto për grupit/ dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/ muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/ muaj ose më shumë për pagën neto 31,836 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.
- c- Punonjës **E. M.** me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/ dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/ muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/ muaj ose më shumë për pagën neto 143,262 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

d- Punonjës **GJ. P.** me pozicion "Përgjegjës Kulture", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/ dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/ muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/ muaj ose më shumë për pagën neto 143,262 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

e- Punonjës **P. Ç.** me pozicion "Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/ dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/ muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/ muaj ose më shumë për pagën neto 143,262 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020. Në mënyrë tabelore pasqyra aneks 4, bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 7, datë 22.05.2020

Kriteri:

Kërkesat e nenit 23, pika 4 e nenit 23, neni 25 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013 "Për Nënpunësi Civil" i ndryshuar; nenin 108 pika (i) dhe (ii) të shkronjës (a) dhe (ç) të ligjit nr. 44/2015 "Kodi Procedurës Administrative"; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore", i ndryshuar me VKM nr. 177, datë 8.3.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 165, datë 2.3.2016, të këshillit të ministrave, "për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"; Vendimin të KM nr. 142, datë 12.03.2014 ndryshuar me VKM nr. 305, datë 5.4.2017 dhe VKM nr. 765, datë 26.12.2018, për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e Administratës Shtetërore dhe institucioneve të pavarura" dhe **ngarkon me përgjegjësi Përgjegjësen e Burimeve Njerzore P. G.**

Impakti:

Rëndim të fondeve buxhetore të bashkia nga kryera e pagesave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.


Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njësore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin për arkëtimin e pagave të paguar padrejtësisht në vlerën **563,952 lekë**, konkretisht:

- **vlera 102,330 lekë**, ndaj punonjës **S...P** me pozicion "Sekretar i Këshillit", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

- **vlera 31,836 lekë**, ndaj punonjës **E. S.** me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 11.09.2019 – 30.03.2020.

- **vlera 143,262 lekë**, ndaj punonjës **E. M.** me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- vlera 143,262 lekë, ndaj punonjës GJ. P. me pozicion "Përgjegjës Kulture", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.
- vlera 143,262 lekë, ndaj punonjës P. Ç. me pozicion "Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020
- Drejtoria e Burimeve Njësore, të marrë masa për:
Plotësimin e vendeve të punës me kontratë me punonjës me status, pasi janë pozicione më statute të Nën-punësit civil, duke ndjekur procedurat ligjore të konkurrimit.
Të përgatisë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura veçanta deri në shkurt 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të Shërbimit Civil".
Të inventarizojë dosjet e personelit dhe plotësimin e tyre me vlerësimet vjetore të punës.

(Gjerësisht problemat janë trajtuar në faqen 46-58 të Projektraport Auditimit)

3. Titulli i gjetjes: Testimi mbi llogarinë 602 "shpenzime operative". Në lidhje me rregullshmërinë dhe përputhshmërinë ligjore të kryerjes së pagesave nëpërmjet bankës dhe dokumentacionit mbështetës shoqërues si dhe të procedurave të prokurimit me vlera të vogla

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 – 31.12.2019), Bashkia Malësi e Madhe ka zhvilluar procedurat me blerje me vlera të vogla për blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në rrugë elektronike. Nga auditimi, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer gjithsej **127** procedura me vlera të vogla për vlerën e fondit limit prej 34,840,652 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 30,429,546 lekë ose 87 % e vlerës së fondit limit, nga e cila në vitin 2018 për 67 procedura me fond 15,925 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur 14,088 mijë lekë ose 88 % e vlerës së fondit limit dhe për vitin 2019 janë 60 procedura me fond 18,914 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur 16,341 mijë lekë ose 82 % e fondit limit.

Grupi i auditimit duke vlerësuar të dhënat e materialitetit dhe riskut të auditimit ka vlerësuar për auditim **30 procedura** me vlerë kontrate të lidhur prej 16,901 mijë lekë ose 55.5 % e vlerës së kontratave të lidhura, nga e cila për vitin 2018 janë audituar 12 procedura me vlerë kontrate 7,548 mijë lekë ose 53.5 % e vlerës së kontratave të lidhura dhe për vitin 2019 janë audituar 18 procedura me vlerë kontrate 9,353 mijë lekë ose 57.2 % e vlerës së kontratave të lidhura.

Për pagesat e kryera dhe dokumentacioni teknik/ ligjor bashkangjitur për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla, **nuk** janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin me vlera të vogla" me ndryshimet, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 5 datë 16.07.2013, me nr. 1, datë 28.02.2014.

Situata:

Në testet e kryera nga analiza e riskut mbi pagesat e kryera në artikullin 602, u konstatua se subjekti Bashkia e Malësi e Madhe ka financuar në formë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Sponsorizime ekipin e futbollit, i cili ka status "Shoqatë", duke e financiar për dieta, trajtim ushqimorë, shërbimin e transporti, gjithsej në shumën **12,004,500 lekë**, nga të cilat në vitin 2018 në shumën 4,566,000 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 7,438,500 lekë.

Kriteri:

Veprime financiare në kundërshtim me kërkesat e neneve 1, 3, 4 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizime"; të neneve 13, 19, 20, 21 dhe 39 të ligjit nr. 79/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin" dhe **nenit 54 të ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi **A. RR me detyrë Përgjegjës I Sektorit të Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues.**

Impakti: Përdorim pa efektivitet të fondeve publike.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave drejtues në zbatimin e kuadrit rregullator ligjor.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë/Buxhet dhe Drejtorinë Juridike, të analizojnë rastin dhe të marrin masa për ndërprerjen e sponsorizimet të Klubit të Futbollit, pasi praktika bie ndesh me kërkesat ligjore të sipërcituara.

Situata:

Referuar VKM nr. 458, datë 26.7.2018 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të palujtshme shtetërore, që përdoren për kryerjen e veprimtarive sportive", Bashkia Malësi e Madhe i është kaluar në pronësi për zhvillimin e aktiviteteve sportive (fusha sporti), konkretisht:

a- ZK 2220 me nr. Pasuri 423 e llojit "Truall" me emërtese "Stadiumi i Qytetit", për sipërfaqen 18730 m² në NJA Koplík me status "Zënë forcërisht nga pronari i tokës pa dokumente sipas shkresës së bashkisë nr. 1083, datë 12.2.2018;

b- ZK 3982 me nr. Pasuri 51 e llojit "Truall" me emërtese "Fushë Sporti, Qendër Bajzë", për sipërfaqen 8900 m² në Malësinë e Madhe me vlerë kontabël 2,485,878 lekë, sipas shkresës së bashkisë nr. 1083, datë 12.2.2018

c- ZK xxx me nr. Pasuri xxx e llojit "Fushë sporti fshati Vrith" me emërtese "Sport", për sipërfaqen 6500 m² në Malësi e Madhe ;

d- ZK xxx me nr. Pasuri xxx e llojit "Fushë sporti fshati Boge" me emërtese "Sport", për sipërfaqen 5000 m² në Malësi e Madhe me status "Zënë forcërisht nga pronari I tokës pa dokumente sipas shkresës së bashkisë nr. 1083, datë 12.2.2018, prona të cilat janë uzurpuar nga të tretë dhe Bashkia Malësi e Madhe është detyruar të marrë me qira prona të tjera për zhvillimin e aktiviteteve sportive, ku për periudhën objekt auditimi janë paguar qira fushë sporti në shumën 628,100 lekë, nga e cila për viti 2018 në shumën 282,500 lekë dhe për aktivitetin e vitit 2019 në shumën 345,600 lekë, shpenzim ky pa ekonomikitet në përdorimin e fondeve buxhetore.

Gjithashtu nga Bashkia Malësi e Madhe është shpenzuar vlera prej 2,737,013 lekë (nga i cili për vitin 2018 në vlerën 1,006,000 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 1,731,013 lekë për objekte me qira për nevojat e bashkisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH në Bashkinë Malësi e Madhe është konstatuar dhe njëherazi rekomanduar në lidhje me administrimin e aseteve, ku është konstatuar se **11 objekte** me sipërfaqe funksionale ndërtimi **1646 m²** të miratuar me VKM si pronë e kësaj bashkie, nuk është bërë asnjë punë për evidentimin e tyre në terren mbi gjendjen aktuale dhe regjistrimin si prone e kësaj bashkia, pasi ato aktualisht janë në përdorim nga persona privat (*zënë forcërisht*) dhe bashkia nuk mundëson mos realizmin e asnjë të ardhure në favor të saj, ku nga mos menaxhimi i tyre për lirimin ose lidhjen e kontratave të qirasë së objekteve me personat që i kanë zaptuar ato, Bashkisë malësi e Madhe i mungojnë të në vlerën **5,925,600 lekë**

Kriteri:

Kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizime" dhe ligjin nr. 79/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin"; VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar, Kapitulli III, pika 1/a,b; nenin 54/dh dhe 55/3 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe nenet 40 dhe 46 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", **duke ngarkuar me përgjegjësi E. H. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Aseteve dhe A. RR me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues dhe V. Z. me detyrë Specialiste buxheti.**

Impakti: Përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike.


Shkaku: Përgjegjësi e strukturave drejtues në zbatimin e kuadrit rregullator ligjor.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financ/Buxhet, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për lirimin e pronave publike që shfrytëzohen padrejtësisht nga persona privat pa pagesë, por në interes të Bashkisë për mos kryerjen e pagesave të qirave për objekte të cilat vetë bashkia është pronare.

Në rast të kundërshtimit nga personat të cilat i kanë zaptuar ato, të mundësohet lidhja e kontratave të qiradhënies, duke përlllogaritur detyrimet që rrjedhin nga shfrytëzimi i pronave publike që nga hyrja në fuqi e VKM nr. 269, datë 12.03.2008 dhe VKM nr. 93, datë 07.02.2012 "Për miratimin e listës së inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Malësi e Madhe (ish Bashkia Koplik), të Qarkut Shkodër", për mungesën e të ardhurave të krijuar në vlerën **5,925,600 lekë** nga mos lidhja e kontratave për dhënie me qira të këtyre objekteve.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

4. Titulli i gjetjes: Për konsumin e karburantit (mjetet motorike apo gjeneratorët) që disponon bashkia miratimi në këshillin bashkiak dhe zbatimi i normativave të harxhimit të karburanteve, për secilin tip mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, sipas urdhrave të titullarit.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Specialistja e Buxhetit V. Z. (personi i ngarkuar për menaxhimin e karburantit) dhe magazinieri F. C. në lidhje me sasinë e karburantit të përdorur nga Bashkia Malësi e Madhe për periudhën 2018 - 2019, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit mbi hyrjet e mallit, shpërndarje sipas mjeteve dhe gjendjes në fund të periudhave.

Në lidhje me sasinë e përdorur sipas mjeteve dhe agregateve që disponon Bashkia Malësi e Madhe, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2019, paraqiten në Tabelën 1, bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 7, datë 22.5.2020.

(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqet 58-68 të Projektraport Auditimit)

IV/D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017.

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.


Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB, pasqyra aneks D/1 & 2 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, konstatoi shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 - 31.12.2019 nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe, janë zhvilluar gjithsej **49** procedura prokurime me vlera të larta, si vijon:

EMËRTIMI	VLERA 000/Lekë	Në % ndaj fondit
Fondet prokuruar gjithsej	829,015	
<i>Nga të cilat</i>		
- Në fushën e ndërtimit	745,560	89.9
-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve	83,456	10.09
Financime nga Bashkia/Grande	388,464	47.37
Financim nga FZHR	370,944	44.6
Financim me grandë specifike	72,293	8.6



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

1. Titulli i gjetjes: *Mos likuidim në afat i kontratave të lidhura për shërbime dhe investime.*

Situata:

Për aktivitetin e vitit 2018, vlera e kontratave të lidhura paraqitet në shumën 216,975 mijë lekë, nga e cila likuiduar vlera 73,661 mijë lekë ose 34 % e vlerës së kontratave të lidhura. Ndërsa gjatë vitit 2019 është likuiduar vlera prej 106,870 mijë lekë ose 49 % vlerës së kontratës dhe në vitin 2020 deri me datë 20.04.2020 është likuiduar vlera 19,847 mijë lekë ose 9% e vlerës së kontratave dhe mbetet pa likuiduar akoma vlera prej 16,595 mijë lekë ose 8 % e vlerës së kontratave.

Për aktivitetin e vitit 2019, konstatohet se vlera e kontratave të lidhura për likuidim paraqitet në shumën 734,584 mijë lekë, ku gjatë vitit ushtrimorë 2019 është likuiduar vlera 166,128 mijë lekë ose 34 % e vlerës së kontratave të lidhura dhe në vitin 2020 deri me datë 20.04.2020 është likuiduar vlera prej 27,482 mijë lekë ose 49 % vlerës së kontratës dhe mbetet pa likuiduar akoma vlera prej 540,973 mijë lekë ose 74 % e vlerës së kontratave.

Nga subjekti nuk është bindës fakti se këto kontrata nuk janë likuiduar për mungesë fondesh nga mos realizmi i të ardhurave, pasi referuar gjendjes së llog. 520 "Disponibilitete në thesar", në fund të vitit 2018, Bashkia Malësi e Madhe paraqitet vlerën 179,436 mijë lekë të trashëgueshme për vitin 2019 dhe në fund të vitit 2019 paraqitet vlerën prej 97,657 mijë lekë të trashëgueshme për vitin 2020, të pa përdorura megjithëse Bashkia ka detyrime të pa paguara ndaj të tretëve,

Kriteri:

Veprimeve në kundërshtim me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 - *Detyrimet e prapambetura të Njësiave të Vetëqeverisjes Vendore*" dhe ngarkon me përgjegjësi **A. RR me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, në cilësinë e Nënpunësit zbatues.**

Impakti:


Kritjen e paargumentuar të gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, duke rritur kështu borxhin që bashkia ka ndaj të tretëve.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave drejtues në mos ndjekjen e radhës së pagesave.

Rëndësia: *I lartë*

- **Rezultatet e auditimit të procedurave periudha 01.01.2018 – 31.12.2019**

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, mbi bazën e të dhënave nga subjekti nga **49** procedura me vlerë kontrate 816,517 mijë lekë, auditoi **31** procedura me vlerë kontrate 805,055 lekë ose 99 % e totalit të kontratave.



KONTROLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Në procedurat e zhvilluara kanë marrë pjesë 149 OE/BOE dhe janë skualifikuar 56 OE/BOE.

Janë zhvilluar me vetëm një operatorë pjesëmarrës 22 procedura ose 44.8 % e procedura me vlerë kontrate 160,221 mijë lekë ose 11.3 % e kontratave të lidhura.

a- Gjatë fazës së auditimit në terren, nga procedurat e vlerësuara për auditim, gjithsej 31 procedurave me vlerë kontrate 805,055 mijë lekë, rezultuan pa probleme 16 procedura ose 52 % e procedurave të audituar me vlerë kontrate prej 132,132 mijë lekë ose 10 % e kontratave të audituara.

b-

2. Titulli i gjetjes: *Aplikimi i kriterëve në procedurat e prokurimit, jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP*

Situata:

Nga auditimi dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.6.2020), është konstatuar se 4 procedura me vlerë kontrate 389,465 mijë lekë ose 48 % e vlerës së kontratës së audituar, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, duke bërë që direkt ose indirekt të kemi mos pjesëmarrje të OE në gara, duke ulur kështu numrin e pjesëmarrësve në procedura, pasi kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, konkretisht pasqyra.

Nr	Objekti prokuruar	Operatori fitues	Kontrata me OE fitues	
			Nr/ datë	Vlera pa TVSH në lekë
1	Instalimi i Tabelës Elektronike	S...J & E...p..,	350/17.01.2019	7,793,950
2	Rehabilitim, pastrim i kanaleve kulluese	"S...J + E...k..."	5889/13.09.2018	4,951,414
3	Furnizim me karburant, per vitin 2019	K...i sh.a.	1035/14.02.2019	12,499,000
4	Furnizimi i me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Kopluk i Sipërm	C...I & S...J	5601/ 07.11.2019	364,221,317
SHUMA 2018+2019				389,465,681

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e NJHDT sipas procedurave.

Impakti:

Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, ka çuar në uljen e numërit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë dhe zhvillimin e tyre me një operatorë, duke eliminuar kështu konkurrencën midis operatorëve dhe efijence e fondeve publike.

Shkaku:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Përgjegjësi e anëtarëve të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve, gjatë kohës së zhvillimit të procedurës.

Rëndësia: *I lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (*sipas llojit të procedurës*), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes.

3. Titulli i gjetjes: *Nga KLSH, u konstatua se OE/BOE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga AK, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2019.*

Situata:

Nga auditimi dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit të audituar me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), u konstatua se nga 31 procedura të audituara në **4 procedura** me vlerë kontrate 118,638 mijë lekë, janë konstatuar shkelje, ku nga KVO janë kualifikuar padrejtësisht OE/BOE me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke mos anuluar procedurën dhe zhvilluar procedurë të re, me kriterë më të favorshme për rritjen e numërit të pjesëmarrësve në procedurë, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **118,638 mijë lekë pa TVSH**, konkretisht pasqyra:

Nr	Objekti prokuruar	Operatori fitues	Kontrata me OE fitues	
			Nr/ datë	Vlera pa TVSH në lekë
1.	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Abdyl bajraktari dhe Kopshti Koplík	“S...I”, & S...N,	6449/09.10.2018	64,700,422
2.	Skeme ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, Loti 2	“S...I”, & S...N,	3684./16.07.2019	35,872,731
3.	Sistemim Asfaltim Rruga Rrustemaj-Stationit (Lagje e Re Koplík)	" "L...J” & S...I,	3321/20.06.2019	8,562,992
4.	Ndërtim Ujësjellësi Balshaj	“L...J”& “A...N”	4150/20.08.2019	10,026,559
SHUMA 2018+2019				118,638,753

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar **ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, sipas procedurave respektive.**

Impakti:

Nga vlerësimi jo i drejtë i operatorëve në garë, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet për vlerën **118,638 mijë lekë pa TVSH.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kriterëve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të LPP.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK), nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet.

➤ Për aktivitetin e vitit 2018.

I. Procedura me objekt "Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë viti 2018", rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>"Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë viti 2018"</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 01, datë 19.3.2018 (prot 1733)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 01, datë 19.3.2018 (prot 1733) E. S. L M F. C.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1/1, datë 19.3.2018 A. RR - kryetar J. N. - anëtar D. Rr.– anëtar
2. Lloji i Procedurës "HAPU"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,755,667 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) "K...I" SHA me ofertë 9,755,667 lekë me TVSh, marzhë fitimi 9.8 %, me kontratë 2640 prot., datë 9.5.2018 dhe afat deri 31.12.2018.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.4.2018 REF-58647-03-26-2018	9. Burimi Financimit Bashkia Malësi e Madhe + grande	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -- ; KPP --- APP-s'ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Hartimi fondit limit:

Fondet janë akorduar nga të ardhurat e Bashkisë dhe grandet e qeverisë, të miratuara në Këshillin Bashkiak. Referuar urdhër prokurimit detajimi i fondeve është bërë sipas nevojave të sektorëve, ku administrata për vlerën 1,433,438 lekë, Shërbimet Publike për vlerën 3,425,138 lekë, Rrugët rurale për vlerën 1,448,768 lekë, Pyje dhe kullota në vlerën 1,899,696 lekë, Infrastruktura ujitjes e kullimit në vlerën 2,000,000, Emergjencat (zjarrfikëset) në vlerën 666,560 lekë dhe Arsimi në vlerën 833,200 lekë. *Gjithsej në vlerën 11,706,800 lekë ose 70100 litra me një çmim mesatar 167 lekë/litri.*

Përlllogaritja e fondit limit në këtë mënyrë është në kundërshtim me ligjin, pasi fondi llogaritet mbi bazën e mjeteve që bashkia ka dispozicion, normativës së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

harxhimit të tyre (procesverbal i cili nuk ekzistonte), sasia mujore e harxhimit e cili përlllogaritet për gjithë vitin, ku si çmimi referencë merret çmimi mesatar në treg ose çmimi nga kontratat e mëparshme, veprime këto në kundërshtim me neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu II "Rregullat e Përgjithshme të prokurimit" neni 9 "Llogaritja e vlerës së kontratës", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: E. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, L. M me specialist në SPZHT dhe F. C. me detyrë magazinier.

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), është kundërgargumentuar në lidhje me hartimin e fondit limit, ku pretendon se:

Se pari, sipas urdhrimit të prokurimit nr. 01 datë 19.03.2018 (prot. 1733), rezultoi se njësitë e prokurimit nuk është e përberë nga E. A.; L. M.; V. Z., por përbëhet nga E. S.; L. M.; F. C..

Se dyti, mënyra e përlllogaritjes së fondit limit ka të bëjë me faktin se nuk mund të llogaritet në fillim të vitit masa e harxhimit në total të automjeteve të bashkisë, pasi nuk mund të parashikohet në mënyrë të sakte se sa do të jete puna që kryejnë këto automjete gjatë vitit. Gjithashtu Bashkia Malësi e Madhe për vitin 2018, ka patur të parashikuar në planin e investimeve edhe blerjen e makinerive të reja, gjë e cila ndikon direkt edhe në masën e karburantit të prokuruar.

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH, merret në konsideratë vetëm fakti se kryetar nuk është E. A. por është E. S.. Ndërsa në lidhje me fondin argumenti nuk qëndron, pasi nuk është bindës fakti që nga bashkia nuk dihet në fillim të periudhës normative e harxhimit, kur dihet aktivitetet që bashkia kryhen në një vit. Gjithashtu përlllogaritja bëhet mbi bazën e mjeteve që bashkia ka dispozicion, normativat e harxhimit për 100/km ose orë pune dhe volumet e punëve që janë kryer gjatë vitit paraardhës ushtrimore. **Argumenti nuk qëndron.**

II-Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-Vjeçare Abdyl Bajraktari dhe Kopshti në Koplík", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Abdyl Bajraktari dhe Kopshti në Koplík"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 11, datë 5.7.2020 (prot 4423)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 11, datë 5.7.2020 (prot 4423) E. A. L. M. V. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave nr. 11/1, datë 5.7.2018 B. B. - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Tender i Hapur"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 64,700,422 lekë REF-78105-07-05-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh)	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,427 mijë lekë ose 2.2 %

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

<i>Pagesa, në vitin 2018 në shumën 33,385,418 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 44,255,089 lekë</i>	BEO "M...P" + "N...A", me ofertë 63,273,971 lekë me kontratë . 6449, datë 9.10.2018, me afat 100 ditë kalendarike.	
8. Data e hapjes së tenderit Datë 6.8.2020, ndryshuar me datë 13.8.2018, <i>pasi janë ndryshuar kriteret</i>	9. Burimi Financimit Bashkia 70% dhe buxheti 30%	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE b) Skualifikuar 5 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr., dt. 6.7.2018 -; KPP-- APP--s'ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 456/1, dt. 13.7.2018	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --- -

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe është kundërshtuar fakti mbi konstatimin e grupit të KLSH për numrin e punonjës prej 70 veta dhe kriteret NP-2B dhe NS-4B, duke argumentuar se numri i lart është kërkuar për faktin se punimet duhet të përfundonin për një afat prej 100 ditëve në mënyrë që nxënësit të hynin në shkollë. Ndërsa në lidhje me kategoritë e punimeve NP-2B (Ndërtime civile dhe industriale) pohojmë që është kriter i sakte pasi objekti përfshihet në tipologjinë e ndërtimeve civile dhe vlera e investimit kalon 20 milionë për tu përfshirë në kategorinë (B). NS-4B (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to) pohojmë që dhe ky kriter është i sakte pasi vlera që përfaqëson këto zëra punimesh kalon 20 milionë.

Zërat e punimeve që përfshihen në punime rifiniture (specifikime teknike, seksioni 6 RIFINITURAT)

-Ne preventiv (Godina e Shkollës):

3. Punime shtresa dhe veshje = 7,017,507 leke pa TVSH
4. Punime suvatimi = 7,201,380 leke pa TVSH
5. 1 F.V dritare d/alumini dopio xham = 2,299,710 leke pa TVSH
6. Punime bojatisje = 1,378,340 leke pa TVSH

-Ne preventiv (Palestra):

4. Punime suvatimi dhe veshje = 1,659,521 leke pa TVSH
7. 1 F.V dritare d/alumini dopio xham = 39,423.6 leke pa TVSH

-Ne preventiv (Kopshtit):

3. Punime shtresa dhe veshje = 704,314.8 leke pa TVSH
4. Punime suvatimi = 722,464 leke pa TVSH
6. Punime bojatisje = 118,100 leke pa TVSH

Shuma = 21,140,760 leke pa TVSH

Sqarime të grupit të KLSH.

Argumentet e paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe qëndrojnë dhe merren në konsideratë nga grupi i KLSH.

- Zhvillimi procedurës:

Me datë 13.8.2018 në prani të anëtarë të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, ku konstatohet se kanë marrë pjesë 7 OE. Me procesverbal datë 30.08.2018, nga KVO është bërë vlerësimi i procedurës sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë pjesëmarrëse, ku nga 7 OE/BOE pjesëmarrës janë skualifikuar 5 OE/BOE dhe janë kualifikuar 2 OE/BOE, *konkretisht:*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Janë skualifikuar;

- 1- JV "K...A" + "A...A" me ofertë ekonomike 54,943,280 lekë, me pretendimin se:
- 2- JV "S...N" me ofertë 59,899,244 lekë, me pretendimin se:
- 3- JV "P...P" + "S...L", me ofertë 61,730,286 lekë, është tërhequr nga gara sipas shkresës nr, ekstra datë 28.8.2018, pro Bashkia Malësi e Madhe nr. 5462, datë 28.8.2018.
- 4- JV "A...N" + "A...O", me ofertë ekonomike 54,941,840 lekë, është tërhequr nga gara sipas shkresës nr, 353 datë 24.8.2018, pro Bashkia Malësi e Madhe nr. 5354, datë 24.8.2018.
- 5- Shoqëria "E...L", me ofertë 0 (zero), me pretendimin se ka mungesa të theksuara të dokumentacionit.

-Shqyrtimi i dokumentacionit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP, konstatohet se JV "M...I" + "N...A", me ofertë 63,273,971 lekë nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Nga shoqëria "M...I", nuk ka paraqitur kategoritë për licencë e punimet NP-12A, NS-18A, NS-12A, NS-14A dhe NS-18A, pasi referuar kontratës së bashkëpunimit, kjo shoqëria ka marrë përsipër punimeve për të cilat kërkohet këto kategori punimesh, konkretisht: "Punime për terren sportin; - punomë për sistem ngrohje dhe punime sistem i jashtëm".

b- Nga shoqëria "M...I", është paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave vendore vetëm nga Bashkia Shkodër, ndërkohë që sipas dokumentacionit shoqëria ka punime dhe në Bashkinë Malësi e Madhe, referuar punimeve të ngjashme me kontratën nr. 2703, datë 30.9.2016 me objekt "Mirembajtje objektsh" me vlerë kontrate 11,471,699 lekë me TVSH dhe afat 30.9.2016 deri më 02.11.2016.

c- Nga shoqëria "M...I", nuk plotësohet kriteri i punimeve të ngjashme, pasi sipas dokumentacionit shoqëria si punime të ngjashme ka paraqitur kontratën nr. 2703, datë 30.9.2016 me objekt "Mirembajtje objektsh" me vlerë kontrate 11,471,699 lekë me TVSH me Bashkinë Malësi e Madhe, por që është në bashkim operatorësh me shoqërinë "N...A" e ndarë 52% shoqëria "M...I" dhe 48% shoqëria "N...A".

Kështu për vlerën 11,471,699 lekë shoqëria ka kryer punimet për vlerën 5,965,283 lekë (11,471,699 x 52%).

Referuar kriterëve të DST, shoqëria duhet të paraqesë 50% të fondit limit ose 37,964,382 lekë (75,928,765 x 50%). Duke qenë se shoqëria sipas mavreshjes së bashkëpunimit ka 25.5% të punimeve, vlerë që shoqëria duhet të mbulojë është 9,680,917 lekë (37,964,382 x 25.5%). **Pra shoqëria nuk plotëson këtë kriter, pasi ka një xhiro më të vogël prej 3,715,634 lekë (9,680,917 - 5,965,283).**

d- Shoqëria "M...I", nuk paraqet certifikatat ISO, sipas pikës 2.3.3 të DST;

f- Asnjë nga shoqërinë nuk paraqesin "Karpantier" me IQT;

g- Në lidhje me kriterin që duhet 2 teknik ndërtimi, nga shoqëria "N...A" janë paraqitur E. M. me kontratë datë 01.04.2017 dhe Rail Oslami me kontratë 5.01.2016, **por konstatohet se teknik E. M. nuk parqet licencë siç kërkohet në DST, për të cilat janë skualifikuar OE me ofertë më të leverdishme;**

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i JV "M...I" + "N...A", nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte me operatorin tjetër të mbetur ne garë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave," për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: B. B. me detyrë specialist finance në NJA Kastrat, J. N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, dhe D. Rr. me detyrë Përgj/Sektor/Pastrim/Gjelbërim-mirembajtje Varreza.

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe, janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH, për kualifikimin e padrejtë të JV "M...I" + "N...A", duke kundërshtuar se:

Shoqëria "N...A", nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e taksave vendore për vitet 2016 dhe 2017, sipas DST;

*Në lidhje me piken d sqarojmë se Shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokumente të emërtuar **Licenca teknike** me 58 faqe ku përfshihen dhe gjitha të gjitha vërtetimet për pagesën e taksave lokale ku ka ushtruar aktivitet sipas QKB dhe plotëson kërkesën e DST. (Specifikisht vërtetim nr. 209 prot datë 18.04.2017 "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr. 114 prot datë 30.03.2016 "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore")*

e- Asnjë nga shoqëritë "M...I" dhe "N...A", nuk paraqet certifikatat ISO, sipas pikës 2.3.3 të DST;

*Në lidhje me piken e sqarojmë se Shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokumente të emërtuar **Licenca teknike** me 58 faqe ku përfshihen dhe gjitha certifikata ISO që disponon dhe plotësojnë kërkesën e DST/*

Sqarime të grupit të KLSH:

Grupi i auditimit të KLSH, pasi shqyrtojë pretendimet e subjektit në lidhje me mangësitë e konstatuara për kualifikimin e padrejtë të JV "M...I + N...N", arrin në përfundimin se është sqaruar vetëm një pjesë e tyre, konkretisht:

-Shoqëria "N...A" ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave vendore për vitet 2016 dhe 2017, sipas DST;

- Shoqëritë "N...A" janë paraqitur certifikatat ISO, sipas pikës 2.3.3 të DST, por që nuk janë paraqitur nga shoqëria tjetër si bashkëpronarë në zbatimin e projektit;

Ndërsa në lidhje me mangësitë e tjera nga Bashkia Malësi e Madhe nuk është paraqitur asnjë kundërshti. Në këto kushte **procedura është e parregullt dhe në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.**

III-Tenderi me objekt: "Rikonstrukcion rruga Jubica e vogël dhe Jubica e Madhe", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Rikonstrukcion rruga Jubica e vogël dhe Jubica e Madhe", viti 2018</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 23, datë 25.9.2019 (6187)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 23, datë 25.9.2019 (6187)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 23/1, datë 25.9.2018
2. Lloji i Procedurës "Tender i Hapur"	E. A. F. U.	A. RR - kryetar J. N. - anëtar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

	V. Z.	D. Rr. - anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 13,333,333 lekë REF-87221-09-25-2018 <i>Pagesa, në vitin 2018 në shumën 4.000.000 lekë, në vitin 2019 në shumën 5.600.000 lekë dhe viti 2020 në shumën 6.400.000 lekë</i>	6. Oferta fituese (pa TVSh) JV “S...I” + “S...N” për vlerën 12,866,047 lekë me kontratë . 7590, datë 5.12.2018, me afat 45 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 467 mijë lekë ose 3.5 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 26.10.2018	9. Burimi Financimit Bashkia Malësi e Madhe	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr., dt. ---- -; KPP-- APP-s’ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Komente dhe sqarime:

Në kundërshtitë e paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), në lidhje me mos argumentimin e kriterit për 5 manovrator, është argumentuar se kriteri është në përputhje me makineri, ku sipas pikës 2.3.6 të DST janë kërkuar një autovinç, një autobetonjere, një fadromë, një grejder dhe një Eskavator.

Sqarim i grupit të auditimit.


Për sa sqaroni në komentet tuaja, pretendimet qëndrojnë dhe merren në konsideratë.

IV-Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Ducajve”, viti 2018, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Sistemim asfaltim rruga Ducajve”, viti 2018</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 17, datë 31.7.2018 (prot 4890)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 17, datë 31.7.2018 (prot 4890) E. A. F. U. V. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave <i>Urdhër nr. 17/1, datë 31.7.2018</i> B. B. - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozim”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,999,988 lekë REF-81499-07-31-2018 <i>Pagesa, në vitin 2018 në shumën 3.000.000 lekë, në vitin 2019 në shumën 4.200.000 lekë dhe viti 2020 në shumën 4.799.985 lekë</i>	6. Oferta fituese (pa TVSh) Shoqëria “N...A” për vlerën 9,678,096 lekë me kontratë nr. 6317, datë 02.10.2018, me afat 60 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 321 mijë lekë ose 3.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.8.2018	9. Burimi Financimit Bashkia Malësi e Madhe	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr., dt. ---- -; KPP-- APP-s’ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

pretendimet e grupit të KLSH, për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "N...A", ku pretendon se:

-Shoqëria "N...A" nuk ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave vendore, sqarojmë se shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokument të emërtuar **Licenca teknike** me 35 faqe, ku përfshihen dhe vërtetim **nr. 114 prot datë 30.03.2016** "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim **nr.209 prot date 18..04.2017** "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim **nr. 647 prot datë 31.05.2018** "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim **nr. 1018 prot datë 13.07.2018** "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Maliq, vërtetim **nr. 4550 prot datë 12.07.2018** "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Malësi e Madhe.

-Shoqëria "N...A" nuk paraqet certifikatën ISO të kërkuara 9001-2015; 14001-2015; 18001-2007; 99-2012; 39001-2008, sipas pikës 2.3.2 të DST, sqarojmë se në dokumentin e emërtuar **Licenca teknike** me 35 faqe përfshihen certifikatat e kërkuara.

-Nuk plotësoj kriterin teknik ndërtimi me 1 person. Nga shoqëria janë paraqitur me dokumente 2 teknik ndërtimi, por që nuk plotësojnë kriterin, pasi E. M., nuk janë bashkëlidhur dëftesë/diplomë që tregon kualifikimet e tij. Ndërsa A. I. i ka përfunduar afati i IQT, pasi me datë 16.05.2018, kurse proceduara zhvillohet me datë 14.08.2018.

Në lidhje me piken **c** të teknikut të ndërtimit A. I. i ka skaduar IQT , vërejmë se kolona e IQT ku data e fillimit është 16.05.2018 dhe nuk është specifikuar data e skadencës është e firmosur dhe vulosur, ne kemi nënkuptuar afatin minimal 1 vjeçar duke u referuar edhe kolonës anash dhe dokumenteve të tjerë të ngjashëm.

- Nuk fabrikë asfalti e pajisur me leje mjedisore QKL, sqarojmë se shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokument të emërtuar **Fabrika Asfalto Betoni dhe Nyje Inertesh** me 21 faqe, ku përfshihet dhe Leja e Mjedisit me nr.47 prot, datë 13.02.2009 "Për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit".

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Malësi e Madhe, grupi i KLSH arrin në përfundimin se **pretendimet e subjektet qëndrojnë** dhe procedura është e saktë dhe nuk ka mangësi.

V-Tenderi me objekt: "Instalim i tabelave elektronike", viti 2018, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Instalim i tabelave elektronike", viti 2018</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 25, datë 20.11.2018 (prot 7331)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 25, datë 20.11.2018 (prot 7331) E. A. F. U. V. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 25/1, datë 20.11.2018 A. RR - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë me propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,123,086 lekë REF-95133-11-21-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) Shoqëria ""S...J + E...Y"" për vlerën 7,793,951 lekë me kontratë nr. 350, datë 17.01.2019, me afat 20 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 330 mijë lekë ose 4 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 03.12.2018	9. Burimi Financimit Bashkia Malësi e Madhe	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

11. Ankimime

AK- nr., dt. ----- ; KPP--
APP--s'ka/ka;

12. Përgjigje Ankesës nga AK

Shkresa nr. -----

13. Përgjigje Ankesës nga APP

apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt.

-Dokumentet e tenderit:

Me procesverbal datë 21.11.2018 është bërë miratimi i kriterëve të DST. Në kriteret e vendosura, konstatohet se nuk është bërë argumentimi i tyre, si vijon:

a-Nuk kuptohet vendosja e kategorisë së licencës NS-8A-Ndërtime parafabrikimi beton arme, struktura metalike druri;

b-Është i panevojshëm kërkesa për 2 manovrator, ku sipas DST kemi një mjet të rëndë (autovinç);

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pika 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", dhe **ngarkon me përgjegjësi: E. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, F. U. me detyrë Përgjegjës Sektori I Zhvillimit Urban dhe V. Z. me detyrë Specialiste Buxheti.**

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërarargumentuar në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e vendosura jo në përputhje me procedurën, ku pretendohet se:

NS-8" Ndërtime parafabrikimi beton arme, struktura metalike druri;"- është parë e arsyeshme të vendoset si kriter për arsye se në zërin e punës të parashikuar në preventiv:

F.V.Tabela informuese pllaka P10 SMD full color, ku secili led është 3 ne 1 (një i tille përfshin tre ngjyrat, duke dhënë një pamje me te qarte edhe nga afër), qe mundëson transmetimin te fotove dhe videove te personalizuar, përfshirë montimin, panelin elektrik+elektronik dhe kabllot lidhës nga paneli tek tabela(Duke respektuar parametrat minimal te përcaktuar ne relacionin teknik (Sipas të cilit , Struktura metalike parafabrikate qe shërben për vendosjen e tabelës përbëhet nga dy këmbë metalike te cilat mbështeten ne plintat e vendosur ne dy anët e rrugës).

Gjithashtu argumentojmë se 2 Manovrator janë kërkuar duke i konsideruar si drejtues të mjeteve që janë kërkuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta,(Kamion me kapacitet min. 5 ton-1 copë dhe autovinç min 5 ton- 1 copë).

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e padrejta, sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura **nuk qëndrojnë**, pasi sipas preventivit nuk kemi ndërtime civile dhe nga subjekti janë kërkuar mjete të tonazhit të rëndë që duhet thjeshtë leje drejtimi të tyre. **Argumenti nuk qëndron.**

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"****VI-Tenderi me objekt: "Sistemim asfaltim rruga e Kaldrunit", me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Sistemim asfaltim rruga e Kaldrunit</i> , v		
1. Urdhër Prokurimi nr. 15, datë 31.7.2018 (prot 4888)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 15, datë 31.7.2018 (prot 4888) E. A. F. U. V. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 15/1, datë 31.7.2018 A. RR - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë me propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,333,333 lekë REF-81492-07-31-2018 <i>Pagesa; në vitin 2018 në shumën 2.500.000 lekë, në vitin 2019 në shumën 3.500.000 lekë dhe në vitin 2020 në shumën 4.000.000 lekë</i>	6. Oferta fituese (pa TVSh) Shoqëria "N...A" për vlerën 8,060,661 lekë me kontratë nr. 6315, datë 02.10.2018, me afat 45 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 273 mijë lekë ose 3.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 13.8.2018	9. Burimi Financimit Bashkia Malësi e Madhe	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr., dt. ---- -; KPP-- APP-s'ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërgargumentuar në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e vendosura jo në përputhje me procedurën, ku pretendohet se:

Meqenëse në preventiv janë parashikuar punime betoni për kunetat sipas zërit të punimeve me nr.an. 2.262/3 Beton C 12/15 per kunetat ; 3.207 Shtrese cakull 10 cm nen kunete, dhe duke qenë se në kategorinë punimeve sipas licenceës NP-7(konsiderohen ato ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura), ky kriter është në përputhje më preventivoin e punimeve, prandaj dhe është parë e arsyeshme vendosja e këtij kriteri në DST

Sipas subjekti kriteri për 4 manovrator është i saktë pasi sipas pikës 2.3.6 të DST janë kërkuar 2 Eskavator dhe mjete kamion.

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e padrejta, sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura **qëndrojnë dhe merren në konsideratë.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me pretendimet e grupit të KLSH, për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "N...A", ku pretendon se:

-Shoqëria "N...A" nuk ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave vendore, sqarojmë se shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokument të emërtuar Licenca teknike me 35 faqe, ku përfshihen dhe vërtetim nr. 114 prot datë 30.03.2016 "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr.209 prot date 18..04.2017 "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr. 647 prot datë 31.05.2018 "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr. 1018 prot datë 13.07.2018 "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Maliq, vërtetim nr. 4550 prot datë 12.07.2018 "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Malësi e Madhe.

-Shoqëria "N...A" nuk paraqet certifikatën ISO të kërkuara 9001-2015; 14001-2015; 18001-2007; 99-2012; 39001-2008, sipas pikës 2.3.2 të DST, sqarojmë se në dokumentin e emërtuar Licenca teknike me 35 faqe përfshihen certifikatat e kërkuara.

- Nuk fabrikë asfalti e pajisur me leje mjedisore QKL, sqarojmë se shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokument të emërtuar Fabrika Asfalto Betoni dhe Nyje Inertesh me 21 faqe, ku përfshihet dhe Leja e Mjedisit me nr.47 prot, datë 13.02.2009 "Për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit".

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Malësi e Madhe, grupi i KLSH arrin në përfundimin se **pretendimet e subjektet qëndrojnë** dhe procedura është e saktë dhe nuk ka mangësi.

VII-Tenderi me objekt: "Sistemim asfaltim rruga Gruemirë", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Sistemim asfaltim rruga Gruemirë</i> , viti 2018		
1. Urdhër Prokurimi nr. 16, datë 31.7.2018 (prot 4889)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 16, datë 31.7.2018 (prot 4889) E. A. F. U. V. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 16/1, datë 31.7.2018 A. RR - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë me propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,333,333 lekë REF-81492-07-31-2018 <i>Pagesa; në vitin 2018 në shumën 2.500.000 lekë, në vitin 2019 në shumën 3.500.000 lekë dhe në vitin 2020 në shumën 4.000.000 lekë</i>	6. Oferta fituese (pa TVSh) Shoqëria "N...A" për vlerën 8,082,332 lekë me kontratë nr. 6315, datë 02.10.2018, me afat 45 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 251 mijë lekë ose 3.01 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 13.8.2018	9. Burimi Financimit Bashkia Malësi e Madhe	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

11. Ankimime AK- nr., dt. ----- ; KPP-- APP--s'ka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----
--	--	---

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me pretendimet e grupit të KLSH, për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "N...A", ku pretendon se:

-Shoqëria "N...A" nuk ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e taksave vendore, sqarojmë se shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokument të emërtuar Licenca teknike me 35 faqe, ku përfshihen dhe vërtetim nr. 114 prot datë 30.03.2016 " Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr.209 prot date 18..04.2017 " Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr. 647 prot datë 31.05.2018 " Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr. 1018 prot datë 13.07.2018 " Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Maliq, vërtetim nr. 4550 prot datë 12.07.2018 " Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Malësi e Madhe.

-Shoqëria "N...A" nuk paraqet certifikatën ISO të kërkuara 9001-2015; 14001-2015; 18001-2007; 99-2012; 39001-2008, sipas pikës 2.3.2 të DST, sqarojmë se në dokumentin e emërtuar Licenca teknike me 35 faqe përfshihen certifikatat e kërkuara.

- Nuk fabrikë asfalti e pajisur me leje mjedisore QKL, sqarojmë se shoqëria "N...A" ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokument të emërtuar Fabrika Asfalto Betoni dhe Nyje Inertesh me 21 faqe, ku përfshihet dhe Leja e Mjedisit me nr.47 prot, datë 13.02.2009 "Për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit".

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Malësi e Madhe, grupi i KLSH arrin në përfundimin se pretendimet e subjektet qëndrojnë dhe **procedura është e saktë dhe nuk ka mangësi.**

VIII- Tenderi me objekt: "Rehabilitim, Pastrim i kanaleve kulluese, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rehabilitim, Pastrim i kanaleve kulluese, viti 2018		
1. Urdhër Prokurimi nr. 18 datë 31.07.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 18 datë 31.07.2018 E. A. - kryetar F. U. - anëtar V. Z. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 18/1 datë 31.07.2018 B. B. - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë per propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,115,462 lekë REF-81500-07-31-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "S...J" + "E...Y" me ofertë ekonomike 4,951,414 lekë me kontratë nr. 5889 prot. Datë 13.09.2018, me afat 30 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 204 mijë leke ose 3.9%.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.08.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

11. Ankimime AK- nr. -; KPP-- APP-;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----
--	--	--

- Shqyrtimi i dokumentacionit:

Me procesverbal datë 31.07.2018 është bërë miratimi i kriterëve të DST.

Në vendosjen e kriterëve konstatohet se janë vendosur kriterë jo në përputhje me preventivin e punimeve, konkretisht: "Është e pakuptimtë kërkesa për 4 manovrator, ku janë kërkuar 2 makineri të rënda", veprime në kundërshtim me pika 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", dhe ngarkon me përgjegjësi: E. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, F. U. me Përgjegjës i Sektorit të PZHT dhe V. Z. me detyrë Specialiste Buxheti.

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërgargumentuar në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e vendosura jo në përputhje me procedurën. Sipas subjekti kriteri për 4 manovrator është i saktë pasi sipas pikës 2.3.6 të DST janë kërkuar 2 Eskavator dhe mjete kamion.

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriterë të padrejta, sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura **nuk qëndrojnë**, pasi sipas DST kemi vetëm dy makineri dhe kamionët që pretendohet nga subjekti nuk janë makineri por mjete të tonazhit të rëndë që duhet thjeshtë leje drejtimi të tyre. **Argumenti nuk qëndron.**

X. Procedura me objekt "Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë", rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje karburant per vitin 2019		
1. Urdhër Prokurimi nr. 26, datë 27.12.2018 (prot 7989)	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 26, datë 27.12.2018 (prot 7989) E. A. - kryetar F. U. - anëtar B. B. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave nr. 27/1, datë 27.12.2018 A. RR - kryetar F. B. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Tender i Hapur"	6. Oferta fituese (pa TVSh) "K...I " + "K...I" SHA me ofertë ekonomike marzhë fitimi 14.4 % me kontratë nr. 1035, datë 14.02.2019 me afat deri me 31.12.2019/ ose 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0 %
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,599,000 lekë	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
8. Data e hapjes së tenderit Datë 21.01.2019 i ndryshuar me dt. 28.01.2019		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

11. Ankimime AK- nr. 22.01.2019 -; KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 499, DT. 25.01.2019	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. -- --
--	--	---

Hartimi fondit limit:

Fondet janë akorduar nga fondet e Bashkisë Malësi e Madhe dhe grandet e qeverisë, të miratuara në Këshillin Bashkiak. Referuar urdhër prokurimit detajimi i fondeve është bërë sipas nevojave të sektorëve.

Përlllogaritja e fondit limit në këtë më mënyrë është në kundërshtim me ligjin, pasi fondi llogaritet mbi bazën e mjeteve që bashkia ka dispozicion, normativës së harxhimit të tyre (procesverbal i cili nuk ekzistonte), sasia mujore e harxhimit e cili përlllogaritet për gjithë vitin, ku si çmimi referencë merre çmimi mesatar në treg ose çmimi nga kontratat e mëparshme, veprime këto në kundërshtim me neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu II "Rregullat e Përgjithshme të prokurimit" neni 9 "Llogaritja e vlerës së kontratës", **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: E. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, F. U. me detyrë Përgjegjës i Sektorit PZHT, B. B. me detyrë Specialist Sektori Financës NjA KASTRAT.**

Zhvillimi i procedurës:

Me procesverbal datë 27.12.2018 janë hartuar kriteret për zhvillimin e procedurës. Me procesverbal datë 16.01.2019 është bërë ndryshimi i kriterëve sipas orientimeve të APP

Sipas këtij procesverbali ka ndryshuar dhe afati për depozitimin e dokumenteve nga data 21.01.2019 me datë 28.01.2019.

ANKESA:

Nga shoqëria "2...L" me datë 22.01.2019 (prot Bashkia Malësi e Madhe nr. 498, datë 25.01.2019) është paraqitur ankesë në lidhje me disa kriterë, konkretisht:

a- Janë të paargumentuara vendosje e kriterëve për certifikatat ISO 9001-2015; 1401-2005; BS OHSAS 18001-2007 dhe PASS 99-2012.

b- OE të ketë minimumi 3 stacione të shitjes së karburantit me pakicë jo më larg se 30 km nga Bashkia Malësi e Madhe

Nga titullari i AK Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 499, datë 25.01.2019 është kthyer përgjigje subjekti se ankesa nuk merrte në shqyrtim pasi është jashtë afateve ligjore të ankimit (7 dita nga data e njoftimit të kontratës), pika 1.1 e nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar. Kështu referuar të dhënave, konstatohet se publikimi është bërë me datë 28.12.2019 sipas REF-02324-12-2018.

Pavarësisht faktit se ankimi i subjekti është jashtë afateve ligjore, nisur nga analiza e fakteve që subjekti kundërshtues paraqet, kriteret për të cilat është bërë ankese janë të paargumentuara nga NJHDT me procesverbal dhe që nuk përshtatet me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" me ndryshime dhe nenet 26 dhe 31, të VKM nr.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" me ndryshime për të cilën ngarkohen me përgjegjësi E. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, F. U. me detyrë Përgjegjës i Sektorit PZHT, B. B. me detyrë Specialist Sektori Financës NjA KASTRAT.

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërgargumentuar në lidhje me hartimin e fondit limit, ku pretendon se:

.....Ne datën 26.11.2018, APP ka udhëzuar Autoritetet Kontraktore me udhëzimin nr 15. Date 26.11.2018 "Per një ndryshim ne udhëzimin nr.6 date 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe realizimin e saj me mjete elektronike", ku në pikën 1 thuhet shprehimisht: Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor parashikon me përafërsi sasinë dhe vlerën e pritshme të kontratave që lidhen gjatë marrëveshjes kuadër..."

Në këtë kontekst është e qartë se vlera e fondit limit nuk mund te përcaktohet ne mënyrë të përpiktë për shkak edhe të mënyrës së konsumimit të mallit që prokurohet, kjo pasi nuk është e mundur që të parashikohet në fillim të vitit me saktësi se sa do të jetë masa shpenzimit të automjeteve e cila ndikohet nga puna që bëhet gjatë vitit.

Prandaj, në këtë rast marrëveshja kuadër është e nevojshme pasi i lejon autoritetit kontraktor që të prokurojë një vlerë të përafërt të mallit që kërkon e në rast se nuk e ka të nevojshëm marrjen e të gjithë mallit të prokuruar, merr vetëm atë që janë nevojat e konsumit.

Prandaj në këtë aspekt përlllogaritja e fondit limit në mënyrën e ndjekur nga NJP, është e mbështetur ligjërisht.

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH, merret në konsideratë vetëm fakti se kryetar nuk është E. A. por është E. S.. Ndërsa në lidhje me fondit argumenti nuk qëndron, pasi nuk është bindës fakti që nga bashkia nuk dihet në fillim të periudhës normative e harxhimit, kur dihet aktivitet që bashkia kryhen në një vit. Gjithashtu përlllogaritja bëhet mbi bazën e mjeteve që bashkia ka dispozicion, normativat e harxhimit për 100/km ose orë pune dhe volumet e punëve që janë kryer gjatë vitit paraardhës ushtrimore.

Në lidhje me kriteret jo të argumentuara nga subjekti nuk është sqaruar.

Argumenti nuk qëndron.

(Gjerësisht problemet janë trajtuar në faqen 68-99 të Projektraport Auditimit)

➤ **Për aktivitetin e vitit 2019**

I. Procedura me objekt "Blerje karburanti dhe gaz për nevojat e bashkisë", rezultoi si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje karburant per vitin 2020, viti 2019		
1. Urdhër Prokurimi nr. 32, datë 21.11.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 32, datë 21.11.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës "Tender i Hapur"	E. A. - kryetar F. U. - anëtar	nr. 32/1, datë 21.11.2019 A. RR - kryetar

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

	E. L. - anëtar	F. B. - anëtar D. Rr. - anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 14 166 610 lekë REF-44640-11-22-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) "G...G " me ofertë ekonomike marzhë fitimi 13 % me kontratë nr. 287/datë 24.01.2020 me afat deri me 31.12.2020.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) xxxxxx mijë lekë ose xxxx %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 18.12.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -; KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ---, dt. -- --

Hartimi fondit limit:

Fondet janë akorduar nga fondet e Bashkisë Malësi e Madhe dhe grandet e qeverisë, të miratuara në Këshillin Bashkiak. Referuar urdhër prokurimit detajimi i fondeve është bërë sipas nevojave të sektorëve.

Përlllogaritja e fondit limit në këtë më mënyrë është në kundërshtim me ligjin, pasi fondi llogaritet mbi bazën e mjeteve që bashkia ka dispozicion, normativës së harxhimit të tyre (procesverbal i cili nuk ekzistonte), sasia mujore e harxhimit e cili përlllogaritet për gjithë vitin, ku si çmimi referencë merre çmimi mesatar në treg ose çmimi nga kontratat e mëparshme, veprime këto në kundërshtim me neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu II "Rregullat e Përgjithshme të prokurimit" neni 9 "Llogaritja e vlerës së kontratës", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: E. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, F. U. me detyrë Përgjegjës i Sektorit PZHT, z. E. L. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave.

II-Tenderi me objekt: "Sistemim Asfaltim Rruga Rrustemaj-Stationit (Lagje e Re Koplík)", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Sistemim Asfaltim Rruga Rrustemaj-Stationit (Lagje e Re Koplík)"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 12, datë 25.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 12, datë 25.04.2019 E. A. - kryetar F. U. - anëtar E. L. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdher nr.12/1, datë 25.04.2019 A. RR - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë per propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,749,817 lekë REF-19727-04-25-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "L...J" & S...I, me ofertë ekonomike me vlerë 8,562,992 leke pa tvsh, me kontratë nr. 3321 prot. Datë 20.06.2019 me afat 45 dite kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 186 mijë lekë ose 2.12 % .
8. Data e hapjes së tenderit Datë 15.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

11. Ankimime AK- nr. -; KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --- -
---	--	---

- **Zhvillimi i procedurës:**

Me procesverbal datë 25.04.2019 është bërë miratimi i kriterëve të DST. Procesverbal datë 08.05.2019, për ndryshim kriteresh me iniciativën e AK sipas rekomandimit të APP me poste elektronike, si dhe shtyrje e afatit të pritjes së ofertave sipas ligjit.

Likujdim i punimeve do të kryhet në tre periudha,

Per vitin 2019: 3,200,000 lekë me TVSH

Per vitin 2020: 3,300,000 lekë me TVSH

Per vitin 2021: 3,999,780 lekë me TVSH.

Me datë 15.05.2019 në prani të anëtarëve NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, ku konstatohet se ka marrë pjesë BOE, konkretisht: "L...J + S...I" me ofertë ekonomike 8,562,992 lekë pa TVSH;

Me procesverbal datë 21.05.2019, nga KVO është bërë vlerësimi i procedurës sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë pjesëmarrëse, duke klasifikuar si të rregullt JV "L...J + S...I" me ofertë ekonomike 8,562,992 lekë pa TVSH, pasi plotëson kriteret e DST.

Me shkresën nr. 2983 prot., datë 30.05.2019 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i nënshkruar nga anëtarët e KVO. Me shkresën nr. 2983/1 prot., datë 30.05.2019, nga ana e titullarit të AK është bërë aprovimi i procedurës, duke shpallur fitues JV "L...J + S...I" me ofertë ekonomike 8,562,992 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 2983/2 prot., datë 30.05.2019 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit.

Ndërmjet Bashkisë Malësi e Madhe përfaqësuar nga Kryetari T. M. dhe JV "L...J + S...I" është lidhur kontrata për zbatimin e punimeve me nr. 3321 prot. Datë 20.06.2019 për vlerën 8,562,992 lekë pa TVSH ose 10,275,590 lekë me TVSH.

- **Auditimi i dokumentacionit të OE fitues.**

Nga shqyrtimi në sistemin SEP të dokumentacionit të fitues JV "L...A" + "S...I", konstatohet se nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

a- Shoqëria "L...A" e cila sipas mavreshjes së bashkëpunimit ka 80 % të punimeve nuk disponon kategorinë e licencës NS-18A, ku dhe sipas zërave të punimeve këto punime do kryhen nga shoqëria "L...A" ;

b- Nga shoqëria "L...A" nuk janë paraqitur vërtetimet mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Malësi e Madhe viti 2017 dhe Bashkinë Shkodër.

Gjithashtu dhe subjekti "S...I" nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Malësi e Madhe viti 2017 dhe 2018.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i JV "L...A" + "S...I", **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, AK duhet të anulonte procedurën, duke analizuar shkaqet e dështimit dhe përmisimin e kriterëve për të mundur rritjen e numrit të pjesëmarrësve në procedurë, kjo për të shmangur

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

paligjshmërinë e përdorimit të fondeve për vlerën **8,749,817 lekë pa TVSH**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave," për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: **A. RR me detyrë Drejtor komanduar Financë/ Buxhet, J. N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, dhe D. Rr. me detyrë Përgj/Sektor/Pastrim/Gjelbërim-mirembajtje Varreza.**

III-Tenderi me objekt: "Ndertim Ujësjiellësi Balshaj", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Ndertim Ujësjiellësi Balshaj"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 22, datë 28.05.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 22, datë 28.05.2019 E. A. - kryetar A. Z. - anëtar F. C. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdher nr.22/1, datë 28.05.2019 A. RR - kryetar G. I. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë per propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 10,026,559 lekë REF-24228-05-28-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "L...J" & "A...N" me ofertë ekonomike me vlere 9,783,295 lekë pa TVSH, me kontratë nr. 4150 prot. Datë 20.08.2019 me afat 60 dite kalendarike.	7. Diferenca me fondin li mit (pa TVSh) 243 mijë lekë ose 2.4 %.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 10.06.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 2OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -, KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

- Zhvillimi i procedurës:

Me procesverbal datë 28.05.2019 është bërë miratimi i kriterëve të DST.

Likujdim i punimeve do të kryhet në tre periudha, konkretisht:

Per vitin 2019: 6,800,000 lekë me TVSH

Per vitin 2020: 3,700,000 lekë me TVSH

Per vitin 2021: 1,531,871 lekë me TVSH.


Me datë 10.06.2019 në prani të anëtarëve NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, ku konstatohet se ka marrë pjesë BOE, konkretisht:

1. BOE "D...X", & "Z...O.", me vlerë 9,598,370 lekë pa TVSH.

2. BOE "L...J" & "A...N" me vlerë 9,783,295 lekë pa TVSH.

3. "SH...I" me vlerë 8,942,770 lekë pa TVSH.

Me procesverbal datë 26.07.2019, nga KVO është bërë vlerësimi i procedurës sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë pjesëmarrëse, duke klasifikuar si të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

rregullt JV "L...J" & "A...N" me vlerë 9,783,295 lekë pa TVSH, pasi plotëson kriteret e DST dhe duke skualifikuar 2 shoqëritë e tjera pjesëmarrës, për faktin se:

- Auditimi i dokumentacionit të OE fitues.

Nga shqyrtimi në sistemin SEP të dokumentacionit të fitues JV "L...A" + "A...N", konstatohet se nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

c- Shoqëria "L...A" e cila sipas mavreshjes së bashkëpunimit ka 71.3 % të punimeve nuk disponon kategorinë e licencës NS-16A dhe NS-18A, ku dhe sipas zërave të punimeve këto punime do kryhen nga shoqëria "L...A" ;

d- Nga shoqëria "L...A" nuk paraqet certifikate ISO 3834-5/2015;

e- Deklaratë mbi disponimin e makinerive, konstatohet se shoqëria "L...J" ka depozituar të njëjtat makineri të cilat janë të angazhuara dhe kontrata të tjera, si në kontratën me objekt "Sistemin asfaltim rruga Rrustemaj-Stacion (lagje e re Koplík), ku afati për përfundimin punimeve është 45 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës e cila është lidhur me datë 20.06.2019 dhe duhet të përfundojë nëse nuk do ketë shtesë punimesh me datë 30.7.2019. ndërkohë që procedura aktuale "Ndertim Ujësjetllësi Balshaj" është zhvilluar me datë 10.06.2019'

f- Nga shoqëria "A...N" nuk janë paraqitur certifikata ISO 99/2012, ndërtesa certifikata ISO 3834-2-2006 nuk është sipas modelit të kërkuar në DST (3834-5/2015), pika 2.3.2 e DST.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i JV "L...A" + "A...N", nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, AK duhet të anulonte procedurën, duke analizuar shkaqet e dështimit dhe përmisimin e kriterëve për të mundësuar rritjen e numrit të pjesëmarrësve në procedurë, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve për vlerën **10,026,559 lekë pa TVSH**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave," për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: **A. RR me detyrë Drejtor komanduar Financë/ Buxhet, G. I. me detyrë Specialist në Sektorin e Ujësjetllës Kanalizimit (inxhinjer), dhe D. Rr. me detyrë Përgj/Sektor/Pastrim/Gjelbërim-mirembajtje Varreza.**

IV-Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i Eko Kampit Shegan dhe Pandus per personat me aftësi te kufizuara ne godinen e NjA Kelmend", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion i Eko Kampit Shegan dhe Pandus per personat me aftësi te kufizuara ne godinen e NjA Kelmend"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 29, datë 25.07.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 29, datë 25.07.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë per propozim"	E. A. - kryetar A. Z. - anëtar F. C. - anëtar	Urdher nr.29/1, datë 25.07.2019 A. RR - kryetar G. I. - anëtar D. Rr. - anëtar

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

5. Fondi Limit (pa TVSh) 7,593,518 lekë REF-31511-07-25-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "M...I" & "N...A " me ofertë ekonomike me vlere 7,499,030 leke pa TVSH, me kontratë nr. 5385prot.,datë 25.10.2019 me afat 30 dite kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 94 mijë lekë ose 1.2 %.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 05.08.2019	9. Burimi Financimit Fonde nga Bashkimi Evropian, Programet IPA	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 2OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. 4526 prot datë 11.09.2019 ; nr. 4527 datë 11.09.2019-; KPP--	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 4703 prot. Dhe 4704 prot. Datë 19.09.2019	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), janë kundërshtuar pretendimet e grupit të KLSH, duke kundërgargumentuar se:

Sipas procesverbalit date 25.07.2019 per miratimin e kriterëve te DST nr. i punonjësve qe nevojiten per realizimin e këtij objekti sipas grafikut varion nga 31 ne 36 kjo bazuar edhe ne VKM 629, date 15.07.2015 dhe nr i punonjësve qe jane kërkuar është rrumbullakosur ne 35. Është kërkuar marangoz pasi ne preventiv kemi disa punime (An. Dysheme per Molo druri per personat me aftësi ndryshe; An2.421. Përgatitje e vendosje lende e rrumbullaket; 2.418. Parmake druri per Molo druri; etj) per te cilat është pare e arsyeshme vendosja e këtij kriteri. Është kërkuar një teknik ndertimi si dhe një inxhinier ndertimi pasi ky objekt zhvillohet ne 2 vendodhje te ndryshme me një distance rreth 40km dhe është menduar e arsyeshme kërkesa e një tekniku ndertimi per realizimin e këtij objekti.

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me argumentimin e shkeljeve të konstatuara për vendosjen e kriterëve, sqarojmë se pretendimet e subjektit **qëndrojnë dhe merren në konsideratë.**

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërgargumentuar në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "N...A", ku sqaron se:

Shoqëria "N...A" Sh.p.k ka paraqitur në lidhje me këtë procedurë një dokumente te emërtuar Licenca teknike me 58 faqe ku përfshihen të gjitha certifikatat e kërkuara. Gjithashtu ne ketë dokument te emërtuar Licenca teknike me 58 faqe përfshihen dhe vërtetim nr. 209 prot datë 18.04.2017 "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Shkodër, vërtetim nr. 647 prot datë 31.05.2018 "Vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore" Nga Bashkia Shkodër si dhe vërtetim nr. 1018 prot datë 13.07.2018 "Vërtetim shlyerje detyrimi për subjekt " Nga bashkia Maliq(çështja 9.3.2018).

Sqarim i grupit të auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

Në sqarimet e dhënë nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe, si dhe verifikimi edhe njëherë në sistem i dokumenteve, konstatohet se mangësitë e evidentuara nga grupi i KLSH nuk qëndrojnë **dhe merren në konsideratë pretendimet e subjekti.**

V-Tenderi me objekt: “Skeme ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, Loti 2”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Skeme ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, Loti 2, viti 2019		
1. Urdhër Prokurimi nr. 9, datë 19.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 5, datë 19.04.2019 E. A. - kryetar A. Z. - anëtar F. C. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdher nr.9/1, datë 19.04.2019 A. RR - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 39,148,683 lekë REF-16792-04-04-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “S...I” & S...N, me ofertë ekonomike me vlere 37,739,239 leke pa tvsh, me kontratë nr. 3478 prot.,date 02.07.2019 me afat 10 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,409 mijë lekë ose 3.5% .
8. Data e hapjes së tenderit Datë 29.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit, vkm nr.17 datë 27.3.2019	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 3OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -; KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. -- --

- Zhvillimi i procedurës:

Fondi limit është llogaritur sipas VKM nr.17 datë 27.3.2019.


Me procesverbal datë 19.04.2019 është bërë miratimi i kriterëve të DST. Me procesverbal datë 8.5.2019 nga NJHDT është bërë ndryshimi i kriterëve, sipas rekomandimeve të APP.

Komente dhe sqarime:

Nga personat përgjegjës të subjektit të audituar Bashkia Malësia e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH mbi kriteret, ku kundërshtohet se:

-Kërkesa për 6 kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 tone është pare e arsyeshme për shkak se për realizimin e këtij objekti nevojiten 3 Ekskavatorë të cilët punojnë në kanale të ndryshme dhe dheun që heqin në kanale e shkarkojnë tek kamionët. Ndërsa 3 kamionë shkojnë në vendet e caktuara për shkarkimin e materialit, 3 kamionët e tjerë ngarkohen nga ekskavatorët të cilët punojnë vazhdimisht.

-2 Autobetonjere janë kërkuar për kanalet ku sasia e betonit ka qenë relativisht e madhe si dhe për strukturat monolite të betonit për veprat e arti, ndërsa betonierët janë kërkuar për betonimin e faqeve anesore të kanaleve për rastet ku sasia e betonit është qenë relativisht e vogël.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Sipas grafikut të punimeve si dhe llojit dhe sasisë së punimeve nr. i punonjësve varion nga 33 në 47 dhe është parë e arsyeshme që nr. i punonjësve që duhet të ketë ofertuesi të jete 45.

Sqarim i grupit të KLSH:

Në përfundim të shqyrtimit të kundërshtive të subjektit në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH, sqarohet se pretendimet e paraqitura nga subjekti mbi mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH, **nuk qëndrojnë** dhe merren në konsideratë, duke vlerësuar se kriteret janë në përputhje me dispozitat e LPP.

Me procesverbalin e datës 29.05.2019, nga KVO në prani të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjorë), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 operatorë pjesëmarrës, ku pas vlerësimit të dokumentacionit janë skualifikuar 3 OE për mos plotësim kriteresh, duke kualifikuar si të rregullt JV "S...I & S...N" me ofertë ekonomike 37,739,239 lekë pa TVSH.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 02.07.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar 2 operator, është tërhequr 1 OE dhe është kualifikuar 1 ofertë.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.07.2019 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE "S...I" & "S...N" për të cilën është lidhur kontrata nr. 3478 prot., date 02.07.2019 për vlerën 37 739 239 lekë pa TVSH/ dhe vlera 45 287 087 lekë me TVSH, dhe me afat 10 (dhjetë) muaj.

Komente dhe sqarime:

Nga personat përgjegjës të subjektit të audituar Bashkia Malësia e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me kualifikimin e padrejtë të JV "S...I" & "S...N", ku pretendohet se asnjë nga mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH nuk qëndron, konkretisht:

1. Në lidhje me Mjetin Eskavator me goma i paraqitur nga "S...N", shoqëria ka paraqitur deklaratën doganore që vërteton pronësinë e mjetit i cili do përdoret në kanter dhe disa mjete rimorkiator për transportin e ekskavatorit për të cilët operatori ekonomik ka paraqitur në tender dokumentacion për rimorkiator si psh AA ...RA dhe AFR

2. Në lidhje me Mjetin Autobetonjere nga "S...I", nuk ka bashkëlidhur lejen e qarkullimit dhe dokumentacionin përkatës për mjetet me goma sipas ligjit sqarohet se ky është një nga mjete e paraqitura e cila është një autobetonjere kantieri, por gjithashtu ky bashkim operatorësh ka paraqit edhe dy autobetonjere të tjera me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, mjeti me targë SH...D nga "S...N" dhe një tjetër nga "S...I" me kontratë qeraje nga "D...A" me targë AA...DP që e plotëson kriterin minimal të kërkuar nga AK, Autobetonjere 2 cope.

3. Në lidhje me "Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri për S...I sepse kontrata është në emër të XH. V. dhe nuk ka dokumentacion provues të lidhjes mes titullarit të kontratës dhe përdoruesit" sqarohet se lidhja mes subjektit dhe personit në fjalë është fare e thjeshtë nga Ekstrakti i QKR-se pasi XH. V. është Administratori i shoqërisë "S...I".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

4. Në lidhje Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë njësisë të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitet 2017 dhe 2018. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia sqarojmë se shoqëritë kanë paraqitur dokumente që vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve vendore për çdo seli që kanë sipas ekstraktit Historik, ndërsa për vendet që nuk pasqyrohen në ekstraktin e QKR e kemi të pamundur të vlerësojmë një gjë të tillë dhe i njëjti parim është ndjekur në vlerësimin e të gjithë operatorëve ekonomik.

5. Në lidhje me paraqitjen e Çertifikatë ISO 3834-2: 2002, por sipas DST kërkohet 3834-2: 2012. Ne si komision kemi vlerësuar se është e njëjtës natyre dhe Brenda afatit të vlefshmërisë si çertifikatë dhe nuk mund të skualifikohet për një detaj të tillë që nuk cënon kapacitetet e subjektit në lidhje me këtë kriter.

Sqarim i grupit të KLSH:

Në përfundim të shqyrtimit të kundërshtive të subjektit në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH, sqarojmë se pretendimet e subjekti Bashkia Malësi e Madhe qëndrojnë dhe merren në konsideratë nga grupi i auditimit, duke mos e reflektuar në Raport përfundimtar.


VI-Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i Shkolles "Vasil Shanto", Fshati Vrake", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion i Shkolles "Vasil Shanto", Fshati Vrake"		
1. Urdhër Prokurimi nr.10/2, datë 21.08.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr.10/2, datë 21.08.2019 E. A. - kryetar F. U. - anëtar E. L. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdher nr.10/3, datë 21.08.2019 B. B. - kryetar J. N. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "E hapur"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 35,161,955 lekë REF-34039-08-21-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "M...P" & "E...T " me ofertë ekonomike me vlere 34,501,752 leke pa tvsh, me kontratë nr.5384 prot.,date 25.10.2019 me afat 120 dite kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 660 mijë lekë ose 1.8%.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 23.09.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + buxheti i bashkisë sipas Shkresës se Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.5795 prot. Datë 11.04.2019	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 10 OE/BOE b) Skualifikuar 7OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -; KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. - ---

- Zhvillimi i procedurës:

Me procesverbalin e datës 23.09.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjorë), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë, gjithsej 10 operatorë.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 15.10.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 10 operatorë pjesëmarrës është skualifikuar 8 operator dhe janë kualifikuar 2 oferta.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë JV "M...I" & "E...T", me vlerë oferte prej 34,501,752 lekë pa TVSH.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 15.10.2019 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "M...I" & "E...T" për të cilën është lidhur kontrata nr. 5384 prot., date 25.10.2019 për vlerën 34 501 752 lekë pa TVSH/ dhe vlera 41 402 102 lekë me TVSH dhe me afat 120 (njëqindnjëzet) ditë kalendarike.

Komente dhe sqarime:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërarargumentuar në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e vendosura jo në përputhje me procedurën, ku sqaron se:

Në lidhje me kriterin 2.3.3 Ofertuesi duhet te kete një punësim mesatar jo me pak se 83 punonjës, per periudhën Tetor 2018- Mars 2019, është bazuar në pikën 8 të nenit 26 të VKM-së nr. 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

Në lidhje me pikën 2.3.4 Ofertuesi duhet te kete drejtues teknik ne licencën e zbatimit te punimeve, te paktën: 1 (një) Ing. Topograf, pasi sipas preventivit kemi zëra pune për rrethimin e terreneve sportive, gërmime , punime shtresash, sistemime të jashtme, është parë e arsyeshme kërkimi i 1 ing. Topograf si kriter i nevojshëm për dhënie kuotash dhe piketim.

Gjithashtu, sa i përket pikës 2.3.6 , kriteri për makinerinë "Grejder"-1 copë, argumentojmë se sipas zërit të punimeve në preventiv me nr analize.3.205/2-Shtrese zhavorri t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri, nevojitet makineria "Grejder" siç paraqitet dhe tek analiza përkatëse në Manualin e ndërtimit

Sqarimet e grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e padrejta, sqarojmë se shpjegimet e dhëna nga subjekti qëndrojnë dhe argumentojnë kriteret e vendosura.

Argumenti juaj qëndron.

**** Lidhur me OE të shpallur fitues rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së.*

-Nga NJHDT në DST pika 2.3.6 Dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10), per makineritë e mëposhtme (ne pronësi ose me qera), është kërkuar "Grejder" copë 1 (një), në pronësi ose qira.

Nga auditimi është konstatuar se mjeti i tipit "Grejderi" i marrë me qera nga Shoqëria "C...I" , nuk ka dokumentacionin e kërkuar, leje qarkullimi sipas Udhëzimit nr. 4, datë 28.6.2019 "Për Dokumentet Për Qarkullim Dhe Regjistrim Të Mjeteve Rrugore".

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i JV "M...I" & "E...T", **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"


nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, AK duhet të anulonte procedurën, duke analizuar shkaqet e dështimit dhe përmisimin e kriterëve për të mundësuar rritjen e numrit të pjesëmarrësve në procedurë, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve për vlerën **35,161,955 lekë pa TVSH**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave," për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: B. B. me detyrë Specialist Financë/Arkiv/Protokoll, J. N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, dhe D. Rr. me detyrë P/Sektor/Pastrim/Gjelbërim-mirembajtje Varreza.**

VII. Tenderi me objekt: *Furnizimi me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Kopluk i Sipërm, me këto të dhëna:*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Furnizimi i me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Kopluk i Sipërm, <u>viti 2019</u>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 30, datë 26.08.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 30, datë 26.08.2019 E. A. - kryetar A. Z. - anëtar F. C. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdher nr. 30/1, datë 26.08.2019 A. RR - kryetar G. I. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "E hapur"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 364,936,715 lekë REF-34272-08-26-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "C...I" & "S...J" me ofertë ekonomike me vlere 364,221,316 leke pa TVSh, me kontratë nr. 5601prot., datë 07.11.2019 me afat 18 muaj .	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 715 mijë lekë ose 0.19.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 01.10.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit, fondi i ardhur sipas, shkresës se Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë, Nr. 12101/1 datë 30.07.2019 shkresës se Ministrisë se Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 2261 Prot., datë 31.07.2019 dhe shkresës nr.14886 Prot., datë 07.08.2019	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 2OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. 4314 prot datë 02.09.2019 ; KPP-- APP;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 4438 prot. Dhe 4704 prot. Datë 09.09.2019	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP; Shkresa nr. ---, dt. ---

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 01.10.2019, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjorë), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë, gjithsej 3 operator pjesëmarrës, konkretisht BOE "C...I + S...J" me ofertë ekonomike 364,221,316 lekë, BOE "L...A + SH...T" me ofertë ekonomike 313,157,298 lekë dhe OE "S...A " me ofertë ekonomike zero lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTEJTIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 05.11.2019, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar 1 operator, është tërhequr nga gara 1 OE dhe është kualifikuar 1 ofertë. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë BOE "C...I" & "S...J", me vlerë oferte prej 364,221,316 lekë pa TVSH.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 05.11.2019 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "M...I" & "E...T" për të cilën është lidhur kontrata nr. 5601 prot., date 07.11.2019 për vlerën 364 221 316, 79 lekë pa TVSH/ dhe vlera 436 385 580,14 lekë me TVSH dhe me afat 120 (njëqindnjëzet) ditë kalendarike.

***** Lidhur me kriteret e DST rezulton se vendosja e tyre përgjithësisht është në përputhje me llojin e objektit të investimit të kërkuar si dhe numri i mjeteve, licencave, numrit të punëtorëve të kualifikuar, etj. është i argumentuar dhe nuk çënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, pavarësisht kësaj është konstatuar se:*

-Nga NJHDT në DST pika 2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo me pak se 180 punonjës, për periudhën Gusht 2018- Korrik 2019.

Ky kriter rezulton të jetë një kriter i vendosur në mënyrë të padrejtë tek kapaciteti teknik pasi numri i punonjësve i shtrirë në kohë nuk përcakton kapacitetin dhe eksperiencën e operatorit.

-Nga NJHDT në DST pika 2.3.7. OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij gjithashtu te paktën:


- a) 1 (Një) Ekspert të auditimit të energjisë (Me certifikatën perkatese).
- b) 1 (Një) Inxhinier Menaxhim Projektesh.
- c) 1 (Një) Inxhinier ndertimi, rruga, ura, vepra nëntokësore.
- d) 3 (Tre) Inxhinier Ndertimi.

Stafi i mësipërm duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 12 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Një kriteri i tillë për një ekspert të auditimit të energjisë kur në projektin e veprës nuk ka punime që të justifikojnë praninë e tij; inxhinieri i menaxhimit të projekteve kur për rastin konkret është një vepër unike dhe jo një ansambël veprash; prania e një inxhinieri ndërtimi për rrugë, ura e vepra nëntokësore, kur nuk jemi para ndërtimit të veprave të tilla apo edhe kërkesa për tre inxhinier ndërtimi janë kritereve të paargumentuara dhe krejtësisht të ekzagjeruar. Po ashtu e pa argumentuar është edhe kërkesa që këta punonjës duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë prej të paktën 12 muaj.

-Nga NJHDT në DST pika 2.3.6 Dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10), për makineritë e mëposhtme (në pronësi ose me qera), është kërkuar "Grejder" copë 1 (një), në pronësi ose qira.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pika 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime dhe VKM nr. 629, datë 15.07.2015, me ndryshimet e çmimeve të manualit nga VKM-ja çmimeve të manualit, dhe ngarkon me përgjegjësi: E. A. me detyrë Përgjegjës i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Sektorit Juridik, A. Z. me detyrë punonjës elektrikist dhe F. C. me detyrë Specialiste Projektsh pranë SPZHT.

Kundërshtimet e subjektit:

Nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020) është kundërgargumentuar në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e vendosura jo në përputhje me procedurën, ku sqaron se:

-Me shtojcën e datës 20.09.2019 numri i punonjësve është ndryshuar nga 180 në 150, numër i cili është shikuar i nevojshëm për realizimin e punimeve sipas preventivit dhe grafikut të punimeve. Gjithashtu në lidhje me shtrirjen kohore të numrit të punonjësve të kërkuar shprehim bindjen se ky kriter nuk është i vendosur në mënyrë të padrejtë. Përkundrazi, bazuar në pikën 8 të nenit 26 të VKM-së nr. 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku thuhet: "8.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit", kriteri është i justifikuar ligjërisht, kjo për arsye se operatori ekonomik provon që në realitet i ka kapacitetet e realizimit të kontratës dhe nuk paraqet fakte fiktive në lidhje me kapacitetet e tij, siç mund të ishte për shembull sigurimi i një numri të tillë punonjësish pak para zhvillimit të tenderit.

Pra, numri prej 150 punonjësish është i nevojshëm për të realizuar kontratën dhe gjithashtu koha për të cilën janë kërkuar këta punonjës, provon kapacitetin real të operatorit e jo kapacitete fiktive vetëm sa për të marrë pjesë në tender.

-Është kërkuar eksperti i auditimit të energjisë pasi në preventivin e punimeve parashikohen punime elektrike.

-Është kërkuar inxhinier ndertimi rruga, ura, vepra nëntokësore pasi në preventivin e punimeve janë të parashikuara punime për prishjen e rrugëve dhe për rindërtimin e tyre.

-Jane kërkuar 3 inxhinierë ndertimi pasi projekti i zbatimit është shumë i zgjeruar në terren dhe është parë e arsyeshme që të ketë minimalisht nga një inxhinier në disa zona punimesh njëkohësisht.

-Është kërkuar që ofertuesi të ketë 1 (një) Grejder pasi në preventiv kemi disa zëra punimesh (3.212/1a; 3.211; 3.205/2; 3.212/c) për realizimin e të cilave nevojitet kjo makineri sipas VKM 629 datë 15.07.2015.

Sa me sipër shprehim bindjen se kriteret e vendosura nga NJP janë të mbështetura në ligj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me kriterin e vendosur për dëshminë e punëtorëve edhe pse relativisht të larta dhe numrit prej 3 inxhinierë ndertimi, sqarimet e dhëna nga ana juaj janë vlerësuar dhe marrë parasysh duke mos qenë më pjesë e trajtimit në raportin përfundimtar të auditimit, **ndërsa përsa i përket dy kritereve të tjera të vendosura grupi i auditimit i qëndron vlerësimit se vendosja e tyre nuk argumentohet me zërat konkrete të preventivit përsa i përket volumit të punimeve dhe specifikave teknike të tij.**



KONTROLI I LARTË I SHTESTIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

VIII-Tenderi me objekt: “Ndërtim dhe rikonstrukcion shkollash”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Ndërtim dhe rikonstrukcion shkollash, <i>viti 2019</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr.14, date 06.05.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr.14, date 06.05.2019 E. A. - kryetar A. Z. - anëtar F. C. - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdher nr.14/1, date 06.05.2019 A. RR - kryetar G. I. - anëtar D. Rr. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 33,333,062 lekë REF-20672-05-06-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “M...P” & “N...A” me ofertë ekonomike me vlerë 33,003,403 leke pa tvsh, me kontratë nr.4241 prot.,date 26.08.2019 me afat 120 dite kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 329 mijë lekë 0.98 %.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 01.07.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE b) Skualifikuar 4OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -; KPP-- APP; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. -- --

- Zhvillimi i procedurës:

Lidhur me kriteret e DST rezulton se vendosja e tyre përgjithësisht është në përputhje me llojin e objektit të investimit të kërkuar si dhe numri i mjeteve, licencave, numrit të punëtorëve të kualifikuar, drejtuesve teknik etj është i argumentuar dhe nuk cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, pavarësisht kësaj është konstatuar se:

-Nga NJHDT në DST pika 2.3.3 Ofertuesi duhet te kete një punësim mesatar jo me pak se 85 punonjës, per periudhën Tetor 2018- Mars 2019.

Ky kriter rezulton të jetë një kriter i vendosur në mënyrë të padrejtë tek kapaciteti teknik pasi numri i punonjësve i shtrirë në kohë nuk përcakton kapacitetin dhe eksperiencën e operatorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pika 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime dhe VKM nr. 629, datë 15.07.2015, me ndryshimet e çmimeve të manualit nga VKM-ja çmimeve të manualit, dhe ngarkon me përgjegjësi: E. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, A. Z. me detyrë punonjës elektrikist dhe F. C. me detyrë Specialiste Projektsh pranë SPZHT.

(Gjerësisht problemet janë trajtuar në faqen 68-99 të Projektraport Auditimit)

IV/D.1.4. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Nga verifikimi i regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 – 31.12.2019), konstatohet se janë kryer gjithsej 29 procedura investimi me vlerë të fondit limit prej 803,941,926 lekë pa TVSH dhe kontrata të lidhura për vlerën 794,704,958 lekë pa TVSH.

**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

Pas analizës së riskut dhe në varësi të kohës së auditimit, grupi i auditimit të KLSH nga 29 procedura vlerësojë për auditim **9 procedura** me vlerë kontrate **663,035,388 lekë** ose 83 % e vlerë së kontratave të lidhura për këto 29 procedura.

Nga auditimi i këtyre 8 procedurave, u konstatua se në 6 procedura nuk janë konstatuar probleme në lidhje me zbatimin e kontratave gjatë fazës së zbatimit të tyre, *konkretisht:*

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlerësuar për auditim
Procedura viti 2017					
1	Rikualifikimi i qendrës Bajze Kastrati, loti I	83,324,785	83,158,127	CURRI	83,158,127
SHUMA 2017		93,324,785	92,858,127	0	83,158,127
Procedura viti 2019					
2	Ndërtim dhe rikonstruksion Shkollash	33,333,333	33,003,403	"M...I"	33,003,403
3	Furnizimi i me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Koplik i Sipërm	364,936,715	364,221,317	C...I	364,221,317
4	Rikonstruksion i Shkolles "Vasil Shanto", Fshati Vrake	35,161,955	34,501,752	"M...I"	34,501,752
5	Sistemim Asfaltim rruga Fundi i Brinjës	16,666,667	16,406,060	N...A	16,406,060
6	Sistemim Asfaltim Rruga Vukpalaj	12,500,000	12,134,281	N...A	12,134,281
SHUMA 2019 BV		519,001,790	515,380,516	0	460,266,813

Në tre procedura janë konstatuar mangësi, të cilat po trajtohen si vijon:

1. "Rruga Fshati Marshej – Rruga Koplik Dedaj", Bashkia Malësi e Madhe

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rruga Fshati Marshej – Rruga Koplik Dedaj", Bashkia Malësi e Madhe		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4362 prot datë 26.10.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,604,656 lekë BOE fitues "K...N" & "A...A"	16. Likuiduar -----
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 23,471,622 lekë -Vlera pa tvsh 19,559,685 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 50 ditë, Zbatuar 157 ditë. Fillimi punimeve: 26.10.2017 Përfundimi punimeve : 03.05.2018	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti me nr. 2329 prot, datë 20.04.2018, 13 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve "L...G"	Licenca Nr: MK ...	Kontrata nr. 4365, datë 26.10.2017
21. Kolaudatori i punimeve OE "N.....o"	Licenca Nr: MK ...	Kontrata nr. 2879 prot., datë 28.05.2018
22. Akt Kolaudimi Datë 01.06.2018	23. Akt i marrjes në dorëzim dt. 01.06.2018	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **380,548 lekë pa tvsh**.

**Titulli i Gjetjes
1&2:**

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rruga Fshati Marshej – Rruga Koplik Dedaj", Bashkia Malësi e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

	Madhe, nga zbatuesi i punimeve OE "2T" , për zërin e punimeve 1.3, 3.8, 3.9, 3.12 dhe 4.19+4.20.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Gërmim dheu me esk. 0.5 m3, kanale > 2 m", "Gërmim seksion i detyruar për KUB", "Transport dheu deri 1 km", "Struktura monolite betoni C 25/30" dhe "Shtresë stabilizanti për bankina t=15cm + t=10 cm", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4365, datë 26.10.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2364 prot, datë 18.08.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2879 prot., datë 28.05.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Malësi e Madhe.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivin, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 380,548 lekë pa TVSH nga BOE fitues "K...N" & "A...A" , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4362 prot datë 26.10.2017 me "Rruga Fshati Marshej - Rruga Koplík Dedaj", <i>Bashkia Malësi e Madhe</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

(Gjerësisht trajtuar në faqen 99-108 të Projektraport Auditimit).

Lidhur me objektin e paraqitur me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "L...G" . Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. Zëri i punës me analizë 3.101 /b (Gërmim dheu me Eskavator zinxhir , 0.5 m3 , në kanale me gjerësi me shumë se 2 metra në tokë të zakonshme me shkarkim në tokë)) i përket kapitullit Punime gërmimi dhe mbushje në rrugë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Në akt-kontroll Ju keni shkruar: "Llogaritja është bërë për gjatësinë e rrugës 1159 metra linear, kur rruga sipas projektit të azhornuar është 975 metra".

Rruga sipas projektit të azhornuar, ka gjatësinë $L1=975$ metra e asfaltuar dhe është edhe rruga e shtruar me çakëll, të cilën nuk e keni konsideruar. Ju siguroj se shumica e gjatësive të rrugës me çakëll janë jo më pak se $L2=165$ metra. Po ashtu sipas llogaritjeve në projektin e rrugës së azhornuar sipërfaqja e rrugës me çakëll është 702.55 m^2 .

Për gjatësinë $L1=975 \text{ m}$ Ju keni llogaritur një sasi prej 1953 m^3 , pra një sasi mesatare prej afro $2 \text{ m}^3/\text{metër}$. Ndërsa projektuesi ka dhënë për këtë sasi (preventivi i tenderit, preventivi i projektuesit) 2104 m^3 ose $2104\text{m}^3/975$ metra baras **$2.157949 \text{ m}^3/1 \text{ metër}$** . Ju nuk keni marrë në konsideratë sasinë e gërmimit që ne kemi konsideruar për segmentet shtesë të pa asfaltuar. Sasia që Ju e keni shkruar si e raportuar me tepër është 348 m^3 . Kjo sasi e pjesëtuar me gjatësinë e segmenteve shtesë, jep shifrën mesatare $348 \text{ m}^3/165 \text{ m} = 2.1 \text{ m}^3 / \text{per } 1 \text{ metër}$.

Ju sigurojmë se duke marrë në konsideratë projektin e azhornuar edhe kjo sasi nuk është raportuar me tepër. Pra këto segmente rrugë janë kërkuar nga Bashkia të përfshihen në preventivin dhe projektin e ri-shikuar.

2. Zëri i punës me analizë 3.104 /a (Gërmim seksion i detyruar për ndërtimin e rrjetit të KUB) i përket kapitullit Punime ne kanalizimin e ujërave të bardha.

Sipas të dhënave të projektit të ri-shikuar

$L1(\text{beton}) = 398.29$ metra është gjatësia e kanalit të veshur me beton.

$L2(\text{te paveshur me beton}) = 1179.94$ metra është gjatësia e kanalit të pa veshur me beton.

Po të bëjmë arsyetimin që keni përdorur për gjatësinë e shkruar në akt-kontroll L(akt-kontroll) $=597$ metra me një sasi prej 328.4 m^3 , pra afro me një volum mesatar prej $0.55 \text{ m}^3/1 \text{ metër}$.

Sasia e këtij zëri është llogaritur për të gjithë gjatësinë $L1+L2 = 1578.23$ metra. Kjo gjatësi kanali gjatë procesit të punës i është nënshtruar gërmimit dhe pastrimit.

Në preventivin e projektuesit (tenderit) kjo sasi ishte 45 m^3 . Duke parë situatën në vend bashkë me përfaqësuesit e Bashkisë Malësi e Madhe kjo sasi në preventivin e ri-shikuar u rritë në 380 m^3 . Sasia mesatare për 1 metër linear llogaritet $380/1578.23 = 0.24 \text{ m}^3$ për 1 metër kanal të hapur dhe pastruar. Natyrisht këtu nuk është konsideruar sasia e gërmimit në seksion të lirë që u trajtua në zërin e parë të kontestuar.

Në këtë zë punë ju garantojmë se nuk ka dëm ekonomik, nuk janë situacionuar sasi më shumë se sa janë kryer. Pra edhe vlera 51.4 m^3 që keni shkruar si e raportuar me tepër është realizuar. Nuk është raportuar me tepër.

3. Zëri i punës me analizë 3.158 /1a (Transport dheu me auto 1 km) i përket kapitullit Punime ne kanalizimin e ujërave të bardha.

Tani po që se pranohet koeficienti i shkruarimit 1.2, edhe sasia 456 m^3 që është raportuar në situacion është e vërtetë. Sasia 104.3 m^3 e konvertuar në vlerë në lek me **52150 lek nuk është dëm ekonomik, është realizuar puna e këtij zëri plotësisht**



sipas situacionit. Me sipër argumentuam se sasia e gërmimit 380 m³ është realizuar dhe prej saj rrjedh sasia 456 m³.

4. Zëri i punës me analizë 3.245 (Struktura betoni c 25/30 ,për pustetat 1.8x1.8) i përket kapitullit Punime ne kanalizimin e ujërave të bardha.

Në preventivin bazë ky zë ishte 110 m³ , në preventivin e ri-shikuar ky zë është shtuar me 2 m³ dhe është bërë 112 m³.

Analizuam kontestimin e llogaritjes për betonin poshtë tubave (tombino) që Ju shkruani se ne e kemi llogaritur për një L=46 metra. Ju shkruani se duhej të ishte llogaritur për gjatësinë L(akt-kon)= 6 metra. Ne i ri-shikuaam faktin dhe gjatësia L=46 metra është realizuar, bile kjo sasi në fakt(ri-kontrolli që bëmë gjatë përgatitjes së observacionit) del L=50 metra, pra në librezat gabimisht nuk janë përfshirë edhe 4 metra të tjera. Por le të konsiderojmë L=46 metra, që është shkruar në librezë , e cila është e vërtetë.

$46 \times 0.4 \times 0.2 = 3.68 \text{ m}^3$ mbetet si zë pune i kryer. **Sasia 3.2 m³ nuk është dëm ekonomik.**

Ashtu si shpjegoam gjatë kontrollit në terren kur ishim me Ju dhe të shoqëruar nga inxhinieri i Bashkisë Malësi e madhe , përveç sipërfaqeve me asfalt në disa vende afër urës janë përdorur edhe shtresa me beton.

Sipas projektit të azhornuar sipërfaqja e **shtresës me beton është 65.26 m²** .Kjo shtresë është realizuar jo më pak se 15 cm. E llogaritur në volum rezulton **V(beton shtrese) =9.75 m³** .

E analizuar në tërësi edhe **për këtë zë punë nuk janë raportuar në situacion sasi më shumë se janë kryer në fakt. Pra nuk ka dëm ekonomik.**

5. Zëri i punës me analizë 3.212 /B dhe 3.212/C (Shtresë stabilizanti në bankinë përkatësisht 1x 10 cm dhe 1x15 cm) i përket kapitullit Punime ne Rrugë .

Sasinë prej 1178 m² të shumëzuar me çmimin e tenderit (400 lek/m²+400 lek/ m² e keni llogaritur si dëm ekonomik.

Sipas projektit të azhornuar kjo sipërfaqe na rezulton të jetë 1178 m².

Tani këtu kjo nuk është një rrugë e drejtë, për të arsyetuar një rast klasik që bankina në rrugë të drejtë është konstante me gjerësi 50 cm. Rruga e asfaltuar është 975 metra dhe sipërfaqja e këtij zëri duhet të jetë patjetër 975 m². Në disa raste, pjesët në kthesa e me hark janë konsideruar si nga ne si mbiqyrës ashtu edhe nga Bashkia që ka pranuar Preventivin e ri-shikuar.

Bazuar edhe në këtë arsyetim sasia **203 m² x 800 lek/m² = 162,400 Lek është realizuar dhe nuk është dëm ekonomik.**

Opinionit i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket zërit 3.101 /b Gërmim dheu me Eskavator zinxhir , 0.5 m³ , në kanale me gjerësi me shumë se 2 metra në tokë të zakonshme me shkarkim në tokë)", në llogaritjen e bërë për diferencat në volume, nga ana e grupit të auditimit janë marrë sipërfaqet e gërmimit (m³/ml), njësoj si ato të librit të masave të hartuara nga Kontraktori dhe të miratuara nga Mbikëqyrësi i punimeve. Diferenca në volume ka dalë si rezultat i llogaritjes në librin e masave të distancave pjesore ndërmjet piketave



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

me 22 ml, kur në fakt këto janë nga 20 ml. Sa për rrugën e shtruar me çakull, që ju pretendoni që ne nuk e kemi marrë në konsideratë, ju sqarojmë se ne nuk e kemi marrë në konsideratë, pasi ky volum, nuk është llogaritur në librin e masave, të hartuar nga vetë Kontraktori dhe të miratuara nga observuesi. Megjithatë, llogaria e bërë nga ana juaj nuk është e saktë, pasi thellësia e gërmimit në segmentet rrugorë shtesë të shtruara vetëm me çakull, është 0.2 m dhe jo 0.35 m që është thellësia e gërmimit në rrugën kryesore. Nga rillogaritja diferenca e këtij volumi është 210 m³. Përsa sipër, ky pretendim merret pjesërisht në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

2. Përsa i përket zërit 3.8. Gërmim seksion i detyruar, për ndërtimin e rrjetit KUB", nga ana juaj është bërë një llogaritje që nuk ka të bëjë me diferencën e konstatuar nga ana jonë. Në llogaritjen e bërë për diferencat në volume, nga ana e grupit të auditimit është korrigjuar gjatësia e "gërmim kanali djathtas pg 53.4 - pg. 650" që në librin e masave është marrë 784 ml, ndërsa në fakt, duket qartë që është 597 ml. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

3. Përsa i përket zërit 3.9. Transport dheu me auto deri 1 km", arsyetimi është i njëjtë me atë të zërit 3.8, për pasojë, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

4. Përsa i përket zërit 3.12. Struktura monolite betoni C 25/30, për pusetat 1.8 x 1.8", në llogaritjen e bërë për diferencat në volume, nga ana e grupit të auditimit është korrigjuar gabimi aritmetik i bërë në librin e masave për betonin e portaleve, i cili rezulton me diferencë 5.75 m³, ndërsa argumentet për gjatësinë e tombinove, merren në konsideratë. Përsa sipër, observacioni për këtë pikë, merret pjesërisht në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

5. Përsa i përket zërave 4.19 + 4.20. Shtresë stabilizanti për bankina t=15cm + t=10 cm", në llogaritjen e bërë për diferencat në volume, nga ana e grupit të auditimit është korrigjuar lapsusi i bërë në librin e masave në distancat pjesore ndërmjet piketave, të cilat janë marrë nga 24 ml, kur në fakt këto janë nga 20 ml. Sa i përket argumentit, sipas të cilit kërkoni që të marrim parasysh që gjatë zbatimit gjerësia e bankinës mund të ketë shkuar në më shumë se 0.5 m për secilën anë, ju sqarojmë se situacionimi i këtyre volumeve shtesë nuk bëhet, pasi gjerësia e rritur në rastin e kthesave, është marrë në pjesën asfaltike dhe nëse bankina në disa pjesë është më e gjerë, është pamundësi e kontraktorit për ta bërë sipas projektit dhe jo domosdoshmëri për tu bërë bankina më e gjerë. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Vlera prej 380,548 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. N. P. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. E. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

2. "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" dhe i kopshtit Koplík", Bashkia Malësi e Madhe

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" dhe i kopshtit Koplík", Bashkia Malësi e Madhe		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6449 prot datë 09.10.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 75,928,765 lekë BOE fitues "M...I" & "N...A"	16. Likuiduar -----
17- Situacioni Përfundimtar - Vlera me tvsh 75,928,765 lekë - Vlera pa tvsh 63,273,971 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 100 ditë, Zbatuar 140 ditë. Fillimi punimeve: 09.11.2018 Përfundimi punimeve : 29.03.2019	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. 1, me nr. 342 prot, datë 17.01.2019, 67 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N...P"	Licenca Nr: MK ... Kontrata nr. 6448, datë 09.10.2018	
21. Kolaudatori i punimeve OE "D...S"	Licenca Nr: MK ... Kontrata nr. 2555 prot., datë 10.05.2019	
22. Akt Kolaudimi Datë 14.05.2019	23. Akt i marrjes në dorëzim dt. 14.05.2019	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **350,982 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" dhe i kopshtit Koplík", Bashkia Malësi e Madhe, nga zbatuesi i punimeve BOE fitues "M...I" & "N...A" , për zërat e punimeve A.I.1.8, A.I.3.4, A.I.3.7. A.I.6.1 dhe B.I.4.3 + B.I.4.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Transport materiale ndërtimi, dheu deri 10 km", "Hidroizolim me emulsion bituminoz dhe një shtresë k katrama", "Plintuse grez importi h=10cm", "Bojë hidroplastike importi (brenda)" dhe "Suvatim fasade + bojë hidroplastike importi", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6449 prot datë 09.10.2018. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6448, datë 09.10.2018.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
"Bashkinë Malësi e Madhe"**

	- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2555 prot., datë 10.05.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Malësi e Madhe.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivin.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 350,982 lekë pa tvsh nga BOE fitues "M...I" & "N...A", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6449 prot datë 09.10.2018 me "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" dhe i kopshtit Koplík", Bashkia Malësi e Madhe, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Lidhur me kundërshtitë e paraqitura nga subjekti me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "Novatech Studio". Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. "Zëri i punimeve A.I.1.8 Transport materiale ndërtimi, dheu, me auto deri ne 10 km".

Ne librezën e masave sasia prej 670 m³ është një shifër e vetme dhe e padetajuar, por në fakt sasia e materialeve të ndërtimit, dheu që është transportuar duhej të ishte detajuar sipas faktit si më poshtë:

ZERI A.I.1.8. Transport materiale ndërtimi, dheu, me auto deri ne 10 km.				
	Sip (m ²)	Trashësi (m)	Vol (m ³)	
Hegje suvatimi te brendshëm	5360	0.07	375.2	
Hegje Bazamake shkalle betoni ekzistuese			5.7	
Prishje davanciale betoni ekzistuese			12.8	
Hegje ulluqe ekzistues	29	0.12	3.48	
Hegje dritare	221.8	0.08	17.7	
Hegje dyer	110.5	0.08	8.8	
Prishje catie per riparim	643	0.15	96.5	
Hegje e shtresës mbushëse nen pllake, per te realizuar hidroizolimin kati përdhe	540	0.12	64.8	
Hegje e shtresës mbushëse nen pllake kati i pare	560	0.08	44.8	
Hegje e shtresës mbushëse nen pllake kati i dyte	551	0.08	44.1	
		TOTALI	673.9	m ³

- Për zërat e tjerë janë gabime aritmetike njerëzore të pa qëllimshme dhe i pranojmë.

Opinionimi i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket zërit A.I.1.8 - Transport materiale ndertimi, dheu, me auto deri ne 10 km", në llogaritjen e bërë për diferencat në volume, nga ana e grupit të auditimit janë



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin
“Bashkinë Malësi e Madhe”

marrë të gjitha volumet e prishjes, por trashësia e suvasë nuk është marrë sa ajo e paraqitur në observacione, 7 cm. Nisur nga fakti që suvatimi është i vjetër, trashësia nuk është 2 cm (sa është marrë nga ana jonë), por 4 cm (jo sa është shkruar në observacion). Nga rillogaritja, diferenca e këtij volumi është 160 m³. Përsa sipër argumenti i sjellë në observacion, merret pjesërisht në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

Vlera prej 350,982 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. E. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Vladimir Topi, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

3. “Rruga Ura e Zhajes - Zagore”, Bashkia Malësi e Madhe

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rruga Ura e Zhajes - Zagore”, Bashkia Malësi e Madhe		
14. Lidhja e kontratës Nr. 414 prot datë 11.01.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 43,999,116 lekë OE fitues “S...J”	16. Likuiduar -----
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 43,962,678 lekë -Vlera pa tvsh 36,635,565 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 50 ditë, Zbatuar 143 ditë. Fillimi punimeve: 11.01.2018 Përfundimi punimeve : 03.06.2018	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. 1, me nr. 1280/1 prot., datë 22.02.2018, 50 ditë, dhe Amendamenti nr. 2, me nr. 2115/1 prot., datë 10.04.2018, 50 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve “L...G”	Licenca Nr: MK ...	Kontrata nr. 280, datë 11.01.2018
21. Kolaudatori i punimeve OE “D...s”	Licenca Nr: MK	Kontrata nr. 5900 prot., datë 14.09.2018
22. Akt Kolaudimi Datë 19.09.2018	23. Akt i marrjes në dorëzim dt. 19.09.2018	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **257,000 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rruga Ura e Zhajes - Zagore”, Bashkia Malësi e Madhe, nga zbatuesi i punimeve OE “S...J”, për zërin e punimeve 1.3, III.6 dhe III.7.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV hekur betoni periodik d=6-10mm” dhe “FV hekur betoni



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"


	periodik $d > 10\text{mm}$ ", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 414 prot datë 11.01.2018. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 280, datë 11.01.2018. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 5900 prot., datë 14.09.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Malësi e Madhe.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivin, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 257,000 lekë pa TVSH nga OE fitues "S...J" , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 414 prot datë 11.01.2018 me "Rruga Ura e Zhajes - Zagore", <i>Bashkia Malësi e Madhe</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Lidhur me kundërshtitë e subjektit paraqitur me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "L...G" . Në këtë observacion, është pranuar diferenca e konstatuar nga ana jonë, me pasojë dëm ekonomik.

Vlera prej 257,000 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. N. P. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Vladimir Topi, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.
(Gjerësisht trajtuar në faqen 99-108 të Projektraport Auditimit).

IV/E. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

1- Titulli gjetjes: *Realizimi i Rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimet nuk janë pranuar.*

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve përcjellë nga KLSH-ja me shkresën nr. 1106/8, datë 28.03.2016, u konstatua se:

a. Nga **14** masa organizative të rekomanduara me vlerë 55,687,966 lekë, janë zbatuar **7** masa, janë në proces zbatimi **2** masa dhe nuk janë zbatuar **5** masa me vlerë **55,687,966** lekë.

b. Nga **19** masa shpërblim dëmi të rekomanduara me vlerë **18,441,036** lekë, janë zbatuar plotësisht **2** masa me vlerë **162,000** lekë, janë në proces zbatimi **5** masa me vlerë 8,569,521 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 7,846,282 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 723,239 lekë dhe nuk janë zbatuar **12** masa me vlerë **9,871,916** lekë (ose 53.5 % e vlerës).

c. Nga **13** masa disiplinore të rekomanduara, konstatohet se:

- Për **10** punonjësit me "*Statusit të Nëpunësit Civil*", janë rekomanduar masa disiplinore përkatësisht; 1 (një) masë "*Largim nga Shërbimi Civil*" dhe 9 masa nga "*Vërejtje*" deri në "*Largim nga Shërbimi Civil*", të cilat janë pranuar dhe zbatuar sipas rekomandimit të KLSH.

- Për **6** punonjësit me "*Kodit të punës*", janë rekomanduar masa disiplinore nga "*Vërejtje*" deri në "*Zgjidhjen e Kontratës së Punës*", të cilat janë pranuar dhe zbatuar sipas rekomandimit të KLSH.

e. Nga **11** masa administrative të rekomanduara, gjendja e të cilave paraqitet;


- Kërkuar **IMTV** marrje masa administrative, për **3** mbikëqyrësit e punimeve e përkatësisht; Inxhinier Natasha Myrtaj, Inxhinier Ridvan Gjecaj, Inxhinier Gëzim Likaj, masa të cilat nuk janë vlerësuar dhe nuk është marrë asnjë masë administrative.

- Kërkuar APP për marrje masë administrative/ disiplinore për **7** persona, nga ku sipas Vendimit të APP nr. 119, datë 19.12.2018 janë aplikuar gjoba në masën **2,477,856** lekë. Nga gjobat e aplikuar për **7** persona me vlerë **2,477,856** lekë, janë zbatuar për 6 punonjës me vlerë 2,177,856 lekë dhe është në proces **1** (një) person me vlerë 300,000 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 223,000 lekë dh mbetet për arkëtim vlera 77,000 lekë.

1. Hartimi i programit (Plan veprimin) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

Me shkresën nr. 1106/8, datë 28.03.2019 (prot subjekt me nr.665, datë 31.03.2019), KLSH ka kërkuar subjektin Bashkia Malësi e Madhe, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimet për përmisimin e gjendjes. Bashkia nga ana e saj për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën 5334/1prot datë 06.11.2019, jashtë afatit ligjor **20 ditë**.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30 -Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, KLSH^{ja} me shkresën nr. 390/59, datë 22.10.2019, drejtuar Bashkisë Malësi e Madhe, kërkon informacion mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e saj Bashkia me shkresën nr. 5334/1, datë 06.11.2019, ka informuar KLSH në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana e saj me shkresën nr. 390/59, datë 22.10.2019, **informacion ky dërguar jashtë afatit 6 mujorë** nga data e dërgimit të shkresës (nr. 1106/8, datë 28.03.2016).

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Nga auditimi rezulton se edhe pse Bashkia Malësi e Madhe ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1106/8, datë 28.03.2019, ndërkohë nuk ka raportuar rregullisht në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", pika 5 e nenit 50-Auditimi i jashtëm.

Situata:

Nga auditimi rezultoi se megjithëse bashkia është munduar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja}, konstatohet se për disa nga masat është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kerkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit "Për kundëroajtjet Administrative" (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë, konkretisht:


A. Masa Organizative:

Nga **14** masa organizative të rekomanduara me vlerë 55,687,966 lekë, janë zbatuar **7** masa, janë në proces zbatimi **2** masa dhe nuk janë zbatuar **5** masa me vlerë 55,687,966 lekë, konkretisht.

B. Masa për shpërblim dëmi:

Nga **19** masa shpërblim dëmi të rekomanduara me vlerë **18,441,036 lekë**, janë zbatuar plotësisht **2** masa me vlerë **162,000 lekë**, janë në proces zbatimi **5** masa me vlerë 8,569,521 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 7,846,282 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 723,239 lekë dhe nuk janë zbatuar **12** masa me vlerë **9,871,916 lekë**, të dhëna paraqitur në pasqyrën **Aneks E/2**, bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

D. Masa administrative:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

D/I. Për Inspektoratin Vendor Mbrojtjes Territorit (IVMT)

Nga KLSH^{ja} i është kërkuar Kryeinspektorit të IMTV të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë për **3 (tre)** mbikëqyrësit e punimeve, në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, për shkelje të neneve 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 15, datë 01.03.2013, pikat 2, 5 dhe 6 si dhe VKM nr. 514, datë 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika 9, si më poshtë:

1. N. M. në cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **852,943 lekë** (pa TVSH).

2. R. GJ. në cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **1,480,125 lekë** (pa TVSH).

3. G. L. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës për katër investime (*trajtuar më hollësisht në raportin përfundimtar*) me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **2,333,068 lekë** (pa TVSH).

D/II. Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

KLSH me shkresën nr. 688/9 prot, datë 13.09.2018 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **7** persona në shumën **2,477,856 lekë**.

Nga APP sipas Vendimit të APP nr. 119, datë 19.12.2018 janë aplikuar gjoba në masën **2,477,856 lekë**, nga e cila zbatuar për **6** persona me vlerë **2,177,856 lekë**, në proces **1** (një) person me vlerë 300,000 lekë, nga e cila arkëtuar vlera **223,000 lekë** dh mbetet për arkëtim vlera **77,000 lekë**.

Kriteri:

Veprime në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit" dhe shkresën nr. nr. 1106/8, datë 28.03.2019 "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Malësi e Madhe".

Impakti:

Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën **66,358 mijë lekë**.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave drejtues.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH^{ja} me shkresën nr. 1106/8, datë 28.03.2019 "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Malësi e Madhe", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, *respektivisht:*

a-Për **7 masa** organizative me vlerë **55,687 mijë lekë**, konkretisht për pikat;
b-Për **17 masa shpërblim** dëmi në vlerën **10,594 mijë lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Për **1 masa** administrative me vlerë **77 mijë lekë**.

d- Për 3 (tre) masa administrative ndaj mbikëqyrësve të punimeve; N. M. R. Gj. dhe G. L.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësinë individuale: A. RR me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës; E. A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik; F. U., me detyrë Dr. Planifikimit të Territorit, E. L., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Taksave, B. C. me detyrë Kryeinspektor i IMTV, S. H. me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Aseteve dhe V. P. me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV.

Situata:

Nga auditim i dokumentacionit mbi veprimtarinë e Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), konstatohet se për periudhën objekt auditim nuk është marrë asnjë masë për ndërtimet pa leje.

Nga auditimet e mëparshme të kryera nga KLSH në këtë sektor është konstatuar se nga IMTV janë aplikuar penalitetet për ndërtimet pa leje me vlerë 2,200,000 lekë, por si në periudhën e auditimit ashtu dhe gjatë zbatimit të rekomandimeve nga kjo strukturë nuk është kërkuar asnjë rrugë ligjore arkëtimi i tyre.

Gjithashtu këto gjoba, nuk janë kontabilizuar në librat e llogarive dhe kontabilite si detyrime, pasi nga IVMT^{ja} nuk janë përcjellë për veprime të mëtejshme në Zyrën e Financës për regjistrim kontabël. Për personat e dënuar me gjobë nuk është aplikuar kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj në masën **1,320,000 lekë**.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.02.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore;

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10 324, datë 23.9.2010, neni 3)

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundëroajtjet administrative", përkatësisht: neni 9 -Ekzekutimi i kundëroajtjeve administrative; neni 22 -Vendimi për kundëroajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv" dhe neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Nenin 24-Shndërrimi i vendimit për kundëroajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundëroajtjet administrative".

Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile në RSH" i ndryshuar, nenin 151, Rivendosja në afat, nenin 152 dhe neni 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.12.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim" dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundëroajtje administrative" përkatësisht nenet 9- "Ekzekutimi i kundëroajtjeve administrative" dhe neni 22.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Përgjegjësi e Kryeinspektorit të IMTV për zbatimin e ligjit.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Financës, Bashkia Malësi e Madhe:

a. Të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat të **4** vendime gjobe në vlerën **2,200,000 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH",


b. Kontabilizimin e vendimeve të gjobave të IMTV dhe kthimin në titull ekzekutiv të **4 vendimet e** dënimit me gjobë të vendosura nga IMTV, në vlerën **2,200,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundëroajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundëroajtjet administrative në, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar), bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar", si dhe të ndiqet të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës (sipas listës që disponon paraqitur më sipër).

c- Të kërkohet aplikimi i kamatëvonesës në masën 1,320,000 lekë, për mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor në masën 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", sipas pasqyrës.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. Vend	Data	Vlera e gjobës	Kamata
1.	S. M.	3	27.11.2012	500,000	300,000
2.	A. S.	1	23.04.2013	1,000,000	600,000
3.	R. T.	4	26.02.2015	500,000	300,000
4.	A. K.	3	31.10.2014	200,000	120,000
TOTALI.				2,200,000	1,320,000

Për sa sipër mban përgjegjësi: V. P. me detyrë ish-Kryeinspektor i Inspektoratit vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe B. C. me detyrë Kryeinspektor i IMTV

(Më hollësisht problemet janë trajtuar në faqen 108-112 të Projektraport Auditimit)

**V. OPINIONI AUDITIMIT****I. Opinioni mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare në subjektin Bashkinë Malësi e Madhe të periudhave ushtrimore të vitit 2018 dhe 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Ky auditim ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat e llogarive të pasqyrave financiare, duke bërë vlerësimin e parimeve kontabël të aplikuara, vlerësimet të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe, të standardeve mbi raportimin financiar për vitin 2018 dhe 2019, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare, kjo referuar UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", duke përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e *një opinionit të kualifikuar*¹².

Baza për opinion:

Përgjegjësitë tona janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit (Kap IV/C, faqe 46-60).

Parregullsitë e konstatuar në veprimet mbyllëse të llogarive të vitit 2019, kemi:

-Në llog. 432 "*Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal*" në pasiv të pasqyrave financiare paraqitet vlera 49,682,860 lekë me kundër parti vlerat debitorë të llog. 423 "*Debitorë për paga dhe shpërblime*" për vlerën 6,611,726 leke dhe llog. 468 "*Debitorë*" për vlerën 43,565,134 lekë. Këto kontabilizimi nuk janë të sakta për faktin se shumat debitorë dhe kreditore, nuk kundrojnë për vlerë 494,000 lekë, gjithashtu emërtimi i këtyre llogarive, nuk përputhet me përmbajtjen e veprimit kontabël.

-Llog. 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" për vlerën 135,352,723 lekë përfaqëson detyrime për tu paguar ndaj të tretëve. Kjo llogari ka si kundërparti veprimin kontabël në debi të llog. 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", llogari e cila në pasqyrat financiare është për vlerën debitorë 114,509,322 lekë dhe është e analizuar për këtë vlerë sipas subjekteve, faturave dhe vlerave përkatëse. Diferenca në këtë rast prej 20,843,401 lekë (135,352,723- 114,509,322), është vlerë e pa justifikuar me dokumente.

Për këtë diferencë gjendja kreditore e llog. 467 është më shumë se gjendja debitorë e llog. 486 përsa mungojnë dokumentet vërtetues, pra përfaqëson veprim kontabël, të pa mbështetur në dokumente justifikues.

¹² Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose
2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

**II. Opinioni mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit.**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e procedurave të prokurimit, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Malësi e Madhe mbi zbatueshmërinë e rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, të procedurave të prokurimit në periudhat ushtrimore të vitit 2018 dhe 2019, bazuar në analizën e riskut¹³.

Në përfundim të procesit të auditimit ne kemi konkluduar në dhënien e një *Opinion i kualifikuar*, pasi gjatë auditimit të veprimtarisë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin*", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Baza për opinion:

Auditimi u krye në përputhje me Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), të cilat janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit (Kap IV/D, faqe 69-101).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar në një pjesë të procedurave nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore/ nënligjore në fuqi, veprime të cilat kanë sjellë anomali materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar në procedurat e prokurimit, ku në 4 procedura kriteret nuk janë vendosur në përputhje me dispozitat e LPP dhe se në 3 procedura prokurimi OE/BOE të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë 118,638 mijë lekë.

Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve janë konstatuar mos zbatimin të disa zërave të punimeve, duke evidentuar dëm ekonomik në vlerën 988 mijë lekë.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme¹⁴, për të siguruar bazën për opinion të kundërt.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Stafi drejtues Bashkia Malësi e Madhe, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator lidhur me raportimin financiar, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.

Gjithashtu është përgjegjës për zbatimin dhe përdorimin e burimeve financiare të fondeve të prokuruar në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

¹³ Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

¹⁴ Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejnë ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300)



KONTROLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme¹⁵. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin e tij profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin të cilat i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

VI. GJETJE DHE REKOMANDIM

A. MASAT ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Malësi e Madhe nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk është hartuar regjistri i riskut, strategjia e riskut, plani i veprimit, gjurma e auditimit. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet. Njësia ka në strukturë specialist të IT-së, por nuk ka programe të licencuara dhe për rrjedhojë nuk ka as programe për mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik, veprime në kundërshtim ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe nenin 32, të ligjit nr. 68/2017" Për financat e vetëqeverisjes vendore" (Më hollësisht trajtuar në pikën (A), faqe 14-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).


1.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë vendore dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike.

Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë sigurimin e programeve kompjuterike të licencuara si dhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, plani veprimit si dhe gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

Menjëherë dhe na vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2018 dhe 2019, është kryer inventari fizik i disa aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara/ të trupëzuara dhe qarkulluese, nga ku konstatohet se në vitin 2018 janë kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit, asgjësimin e inventarëve dhe sistemimin e llogarive kontabël, sipas rezultateve të inventarëve të kryera në vitin 2017, duke pakësuar llogaritë përkatëse për shumën totale 18,412,062 lekë.

¹⁵ ISSAI 300, Parimet bazë të auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditim duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimtarive të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektin e auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Mos pasqyrimin në kohë të rezultateve të inventarizimit, është në shkelje të kërkesave të UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" Kap. II, pikat 5, 8, Kap. III, pikat 28, 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën (C), faqe 46-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, të marrë masa për mbylljen e procedurave të inventarizimit, brenda vitit ushtrimor dhe për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël duke nxjerrë në kohë aktet e nevojshme administrative.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2019, gjendja e llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" është për vlerën kontabël 35,768,687 lekë. Nga analiza e përmbajtjes të kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuara fonde për të cilat prej vitesh është përmbushur afati i garancisë prej 1 (një) viti nga dorëzimi i objekteve të investuara dhe nuk është bërë c'bllokimi i tyre, evidentuar kjo për 25 raste në shumën 4,962,799 lekë dhe nga Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit, nuk është kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c'bllokimin e këtyre fondeve, veprime në kundërshtim me kërkesat e pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën (C), faqe 46-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Malësi e Madhe, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera dhe të përfunduara në kohë, për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, duke proceduar sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.


Brenda datës 30.09.2020

4. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2019, gjendja e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm", paraqitet me vlerë kontabël 43,565,134 lekë. Nga analiza konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar edhe subjektet debitorët për tatim taksat lokale në shumën 36,472,533 lekë, ndërsa diferenca në vlerën **7,092,601 lekë** përbën shumën e **8 subjekte** debitorë të krijuar nga viti 2008. Një pjesë e cila është e trashëguar nga ish Komunitat (sot Njësi Administrative e Bashkisë Malësi e Madhe).

Nga Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit dhe Drejtoria Juridike e Bashkisë Malësi e Madhe, nuk është procedura sipas ligjit përfshi kërkesë padi në Gjykatë për arkëtimin e detyrimeve debitorë (Më hollësisht trajtuar në pikën (C), faqe 46-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar në vite duke procedur me kërkesë padi në Gjykatë, në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda datës 31.12.2020



5. Gjetje nga auditimi: Në fund të periudhave ushtrimore të viteve 2018 dhe 2019, kanë rezultuar detyrime të pa paguara ndaj të tretëve, ndërkohë që nuk janë përdorur të gjitha burimet financiare.

Gjithashtu konstatohet se për vitet 2018 - 2019, shumat e detyrimeve të pa paguara janë më të mëdha se burimet financiare të papërdorura, gjë që tregon se janë kryer shpenzime të pa mbuluara me fonde, konkretisht:

-Për vitin 2018, shuma e detyrimeve të papaguara (llog. 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"), paraqiten në shumën 185,767 mijë lekë, kurse fonde të trashëguara për vitin pasardhës (llog. 520 "Disponilitete në thesar"), paraqitet në shumën 179,436 mijë lekë.

Nuk pasqyrohet si detyrim kreditor në një rast për shumën **15,447 mijë lekë** (fatura tatimore nr. 182, datë 03.06.2018 të subjektit "S...J").

-Për vitin 2019, shuma e detyrimeve të papaguara (llog. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"), paraqitet në shumën 114,509 mijë lekë, kurse fonde të trashëguara për vitin pasardhës (llog. 520 "Disponilitete në thesar"), paraqitet në shumën 97,657 mijë lekë.

Nga analiza e detyrimeve kreditore të periudhës së vitit 2019, konstatohen vlera të mëdha detyrimesh të bartura nga vitet e kaluara në të cilën:

-9 raste me vlerën 22,388 mijë lekë, janë detyrime të krijuara nga viti 2018,

-25 raste me vlerën 3,581 mijë lekë, janë detyrime të krijuara nga viti 2015 dhe

-2 raste me vlerën 16,491 mijë lekë, janë detyrime sipas Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë nga viti 2015.

Kjo praktikë e menaxhimit të fondeve është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 101 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" Kreut III, pika 28 dhe 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën (C), faqe 46-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtorja e Financë dhe Menaxhim Buxhetit, të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave të ligjit, duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit, të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe të eliminohet praktikat që sjellin shtesë detyrimesh të prapambetura.

Brenda datës 31.12.2020

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Malësia e Madhe nuk ka marrë masat e nevojshme për miradministrimin e të gjitha aktiveve afatgjatë materiale dhe jo materiale, për llogaritë e aktiveve me vlerat neto sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të vitit 2019:

Llog. 210 "Toka, troje, terene" për 9,822,183 lekë.


Llog. 211 "Pyje kullota plantacione" për 15,388,760 lekë.

Llog. 212 "Ndërtime konstruksione" për 755,176,177 lekë.

Llog. 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" për 2,189,281,771 lekë.

Llog. 214 "Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune" për 26,974,187 lekë.

Nuk është kryer inventarizimi fizik në periudhat ushtrimore 2018 dhe 2019, si për aktivet ku me VKM nr. 366, datë 18.05.2016, nr. 458, datë 26.07.2018 dhe nr. 433, datë 8.6.2016, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Malësia e Madhe, ashtu edhe për aktivet e investuara nga Bashkia.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Nuk është bërë regjistrimi i të gjithë aktiveve në pronësi të Bashkisë, duke përjashtuar 15 objekte të regjistruar në Kadastrën Urbane, në pronësi të Bashkisë Malësia e Madhe. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" I ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 12 dhe Kap. VII, neni 23, pika 14 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pikat 26, 27 dhe 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën (C), faqe 46-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave.

Brenda datës 31.12.2020

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2019, u konstatuan disa pasaktësi në veprimet kontabël, duke sjellë për pasojë që:

-Në disa raste detyrimin e llogarive, pra mospërputhje të përmbajtjes me emërtimin e llogarisë.

-Disa llogari të pasivit që kanë kundërpartinë e vet në aktiv të pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar për vlerat e tyre duke krijuar pasiguri në veprimet e mbylljes së llogarive vjetore.

-Raste ku shumat e llogarive, nuk janë mbështetur me dokumentacion justifikues ligjor.

Konkretisht:

Në debi të llog. 210 "Toka, troje, terrene", është kontabilizuar vlera 479,989 lekë shpenzime për "Hartimin e planit të detajuar Vendor", duhet të sistemohet në debi të llog. 202 "Studime dhe kërkime".


Në debi të llog. 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", është kontabilizuar vlera 594,572 lekë, shpenzime për supervizim për rikonstrukcion të Shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari", duhet të sistemohet në debi të llog. 212 "Ndërtime konstruksione".

Në kredi të llog. 433 "Detyrime, shteti, fatkeqësi natyrore" është kontabilizuar vlera 2,460,677 lekë që përfaqëson detyrime të pa paguara për sigurimet shëndetësore të punonjësve, duhet të sistemohet në kredi të llog. 436 "Sigurimet shëndetësore".

Në llog. 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 15,687,975 lekë janë kontabilizuar detyrimet për pagat e pa paguara të punonjësve. Kjo vlerë nuk është e saktë, pasi referuar listë pagesës së muajit Dhjetor 2019, pagat e pa paguara janë në shumën 13,737,187 lekë dhe për diferencën 1,950,788 lekë, vlera e kësaj llogarie është e pa saktë dhe duhet të sistemohet.

Në llog. 432 "Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal" në pasiv të pasqyrave financiare për vlerën 49,682,860 lekë me kundër parti vlerat debitorë të llog. 423 "Debitorë për paga dhe shpërblime" për vlerën 6,611,726 leke dhe llog. 468 "Debitorë" për vlerën 43,565,134 lekë. Këto kontabilizimi nuk janë të sakta për faktin se shumat debitorë dhe kreditore, nuk kundrojnë për vlerë 494,000 lekë, gjithashtu emërtimi i këtyre llogarive, nuk përputhet me përmbajtjen e veprimit kontabël.

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vlerën 135,352,723 lekë, përfaqëson detyrime për tu paguar ndaj të tretëve. Kjo llogari ka si kundërparti veprimin kontabël në debi të llog. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", llogari e cila në pasqyrat financiare



KONTROLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

është për vlerën debitorë 114,509,322 lekë dhe është e analizuar për këtë vlerë sipas subjekteve, faturave dhe vlerave përkatëse.

Në këtë rast, diferenca për shumën 20,843,401 lekë (135,352,723- 114,509,322), është vlerë e pa justifikuar me dokumente. Për këtë diferencë gjendja kreditore e llog. 467 është më shumë se gjendja debitorë e llog. 486 përsa mungojnë dokumentet vërtetues, pra përfaqëson veprim kontabël, të pa mbështetur në dokumente justifikues.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" Kap. III, pikat 42, 62, Rubrika II dhe Aneksi mbi: "Veçoritë e evidencës të llogarive të klasës ... " (Më hollësisht trajtuar në pikën (C), faqe 46-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit, të marrë masat dhe të procedojë sipas akteve ligjore/nënligjore të ligjit për sistemimin e llogarive kontabël, përsa janë konstatuar veprimet të pa sakta sipas citimeve të më sipërme. Vlerat e llogarive kontabël, të jenë të përputhura me dokumente vërtetues ligjorë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se nga Drejtoria e të Ardhurave janë evidentuar **66** subjekte të biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Njësitë Administrative, Koplik, Qendër, Gruemirë, Kastrat, Shkrel dhe Kelmend, të pa regjistruar në QKB, duke bërë që këto subjekte të mos paguajnë detyrimet për taksat e tarifave vendore dhe krijuar mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe shkak për evazion fiskal.

Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor për detyrimin e këtyre subjekteve për regjistrim në QKB apo të ngarkohen me vlerën e detyrimit për taksat e tarifave vendore sipas VKB të miratuara, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre, veprim në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", në lidhje me zbatimin e nenit 41 dhe 121, pika 3, e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).


8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, të marrë masa për regjistrimin e 66 subjekteve të paregjistruar në QKB dhe aplikimin e detyrimeve fiskale për taksat e tarifave vendore nga momenti i evidentimit të tyre e vazhdim.

Brenda datës 30.09.2020

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të ndjekura nga Drejtoria e të Ardhurave, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor), u konstatua se në fund të periudhës 31.12.2019, gjendja e debitorëve për subjektet fizik/ juridik dhe abonentët familjare paraqitet në vlerën **11420 subjekte** për vlerën **113,743,328 lekë**, nga e cila:

a- 211 subjekte fizik/ juridik me vlerë 26,652,289 lekë për taksat pasurisë, tokës, ndërtesës, hapësirave publike dhe tarifave vendore.

b- 11209 abonentët familjarë me vlerë 87,091,039 lekë, për taksën e pasurisë dhe tarifave vendore, nga e cila: taksa tokë bujqësore në shumën 3,653,554 lekë, taksë ndërtesë në vlerën 16,763,185 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 64,505,450 lekë.



Kjo vlerë nuk është kontabilizuar saktë në llogarinë debitorë në llog. 468

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se vlera e debitorëve abonentëve familjarë është 76.5 % e vlerës së gjithë borxhit fiskal.

Në totalin e debitorëve të paraqitur, u konstatua se 118 subjekte janë debitorë aktiv ose 56 % e subjekteve me detyrime për vlerën 10,848,212 lekë ose rreth 50 % e vlerës totale të borxhit tatimor, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme dhe jo këmbëngulëse të Drejtorisë së të Ardhurave në arkëtimin e detyrimeve debitor.

Nuk u konstatua asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtitimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar"*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, me ndryshimet dhe nenit 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*.

Nga Bashkia Malësi e Madhe, nuk është përcaktuar mënyra efçente për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga abonentët familjar, si nëpërmjet shoqërisë *"Ujësjiellësi Kanalizime"* ShA, siç përcaktohet dhe në pikën (ii) e nenit 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, ku i jep të drejtën e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk është realizuar përfshirja e vlerës së taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit dhe do ti jepte më shumë mundësi për shërbime dhe investime ndaj komunitetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

9.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave, Bashkia Malësi e Madhe, bazuar në nenin 70 pika 3 *"E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor"*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat tatimore në R.SH"*, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në vlerën **113,743,328 lekë**, si më poshtë vijon:


a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore RSH"*.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në RSH"*.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat tatimore në RSH"*, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, **të bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 *"Mospagimi i taksave dhe tatimeve"*.

e- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe në bashkëpunim me 6 Njësitë Administrative, respektivisht: Kopluku, Rruemira, Kastrati, Kelmendi,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Qendër dhe Shkrel, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të përgatisë dhe të miratojë në Këshillit Bashkiake aktmarrëveshje me shoqërinë "Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe", si agjent tatimorë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për familjet që kanë kontratë me këtë ndërmarje, në zbatim të nenit 5, pika 1, shkronja "b" e ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Brenda datës 31.12.2020

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të lidhura për dhënien me qira nga fondi pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe, u konstatua se 12 kontrata nuk janë lidhur tek noteri, veprime në kundërshtim me paragrafin e "I" të nenit 83, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, duke i bërë këto kontrata të pavlefshme ligjërisht dhe përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor për pasojat që mund të sjell moszbatimi i kushteve të përcaktuara në këto kontrata (*Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe (Drejtoria Juridike), të marrë masat për përsëritjen (korrigjimin) e **12** kontratave për dhënien me qira të sipërfaqeve nga fondi pyjor/kullosor, etj. të cilat duhet të hartohen dhe regjistrohen në zyrën noteriale për të realizuar vlefshmërinë ligjore të tyre.

Më njëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të cilave të bëjë akt-rakordimet, veprime të cilat kanë çuar në mos evidentimin e saktë të të ardhurave nga agjentët tatimor, në kundërshtim me nenin 117, të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, "Për Procedurat Tatimore", ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 68-2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9920, dt. 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, "Për taksat kombëtare" (*Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura.

-Krijimin e bazës së të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në administrim të Sektorit të Njesisë së Auditit të Brendshëm (AB), për periudhën objekt auditimi (viti 2018 – 2019), u konstatua se:

-Stafi i Njesisë Auditit të Brendshëm përbëhet nga 3 tre punonjës, nga të cilët; 1 një drejtues dhe 2 dy auditues, vetëm njëri është i pacertifikuar, në kundërshtim me pikën 2 e nenit 11, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

- *Për vitin 2018*, ne zbatim të planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Bashkisë (*shkresa nr. 4188, datë 13.10.2017*), janë planifikuar dhe realizuar gjithsej 7 misione auditimi, nga të cilat 2 misione përputhshmërie, 1 (një) mision financiar dhe 4 misione të kombinuara.

Në përfundim të procesit të auditimit, janë rekomanduar gjithsej 55 masa organizative dhe asnjë masë shpërblim dëmi dhe disiplinore.

Nga 55 masa organizative janë zbatuar 45 masa dhe janë në proces 10 masa.

- *Për vitin 2019*, ne zbatim të planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Bashkisë (*shkresa nr. 6488, datë 10.10.2018*), janë planifikuar gjithsej 7 misione të gjitha të llojit të kombinuar.

Nga 7 misione të planifikuara janë realizuar 5 misione dhe 2 misione janë në proces auditimi gjatë vitit 2020.

Në përfundim të procesit të auditimit, janë rekomanduar gjithsej 27 masa organizative dhe asnjë masë shpërblim dëmi dhe administrative/ disiplinore.

Nga 27 masa organizative, nuk është zbatuar asnjë masë dhe janë në proces 27 masa. (Të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën Aneks A/2.1 - 10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Malësi e Madhe, nuk është bërë i mundur realizimi i kontroleve për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezulton të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe titullari i njesisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e realizuara;

- Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka kryer auditim në zonat me risk të lartë, si: prokurimet me vlerë të vogël dhe vlerë të lartë, lejet zhvillimore të lëshuara nga Sektori i PLZHT (*taksën e ndikimit në infrastrukturë*), shpenzimet operative (art. 602), për të gjitha llojet e blerjeve, administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë nuk janë zhvilluar auditime të thelluara, zbatimi i kontratave të punimeve dhe shërbimeve, menaxhimi i borxhit tatimore dhe rritja nga njëra periudhë në tjetrën, nuk është hartuar regjistri i riskut, etj;

- Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Malësi e Madhe, në rekomandimet e dhëna, konstatohet se janë dhënë vetëm masa organizative dhe asnjë masë shpërblim dëmi, si dhe nuk ka dalë përgjegjësia e personave përgjegjës për marrjen e masave disiplinore për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Dosjet e auditimit nuk janë të arshivuara në arshivë, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien ndesh me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Per auditimin e brendshëm ne sektorin publik"; Manuali i auditimit miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" Kap. VII, pika 7; VKM nr. 83, datë 03.02.2016" Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"; neni 11 i VKM nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik"; Standartet e Auditimit; -Rregulloren e brendshme te Bashkisë Malësi e Madhe Miratuar nga kryetari i bashkisë dhe Riregjistruar nr. 1739Prot , datë 04.07.2016 (Më hollësisht trajtuar në pikën (A/2), faqe 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Sektori i Njesisë së Auditit të Brendshëm (NJAB), të marrë masa që:

- Në përfundim të misionit të auditimit, të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim dhe në të gjitha rastet e shkeljeve të konstatuara të dali përgjegjësi individuale e personave përgjegjës dhe ti propozohet masë disiplinore/ administrative për menaxherin të institucionit.

- Të kryhet monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

- Të kryhet arkivimi në institucion dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

12.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, të marrë masa të menjëhershme që punonjësit pa certifikatë të AB, të pajisjen me certifikata të auditit të brendshëm, si dhe kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme.


12.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektive, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në programimin e buxheteve vjetore dhe afatmesëm për vitet 2018 dhe 2019, u konstatuan shkelje të kërkesave ligjore:

- Mos miratimi në Këshillin Bashkiak Bashkia e Madhe, të programeve buxheteve afatmesëm (PBA) për periudhat 2018-2020, 2019-2021, veprime në kundërshtim me nenin 33, 34 dhe 37 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

- Mos programimi në buxhetet vjetore si zë më vete, për shlyerjen e detyrimeve të mbartura nga viti paraardhës, veprime në kundërshtim me pikën 101, të UMF Nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, konkretisht për vitin 2018 në vlerën 185,765 mijë lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 114,509 mijë lekë.



- Mos analizimi dhe miratimi në Këshillin Bashkia e Madhe, treguesit e realizmit të buxheteve të periudhave 2018 dhe 2019, brenda datës 30 Qershor (të vitit pasardhës), veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

- Mos kryerja e pagesave të detyrimeve kreditore të krijuara në vitin ushtrimor si dhe ato të trashëguara nga viteve paraardhëse, pavarësisht faktit që në fund të periudhave ushtrimore ka gjendje financiare të pa përdorura, konkretisht për vitin 2018 në vlerën 179,436 mijë lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 97,657 mijë lekë, si dhe mos programimi i të ardhurave jo reale në raport me shpenzimet që planifikohen, veprime në kundërshtim me kërkesat e pikës 101, të UMF Nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën (B), faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Menaxhimi Buxhetit, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për:

- Zbatimin e procedurave ligjore në programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesëm, duke ngritur në kohën e duhur, grupet e punës sipas projekteve të financimit, si dhe të monitorohet zbatimi i kalendarit të programimit të buxhetit sipas afateve ligjore.

- Programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

- Miratimin në Këshillin Bashkiak të raporteve të monitorimit të treguesve të buxhetit, si organi vetëm vendimmarrës, si dhe të gjitha fondet që akordohen kësaj bashkie nga burimet e veta, buxheti i shtetit apo donator të ndryshëm në fillim dhe gjatë vitit ushtrimorë, për të siguruar një transparencë të mirpërdormit të këtyre fondeve me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet në të mirë të komunitetit.

- Programimin dhe monitorimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura duke miratuar një kalendar mbi bazën e mundësive financiare dhe riskut nga penalitete të mundshme.

Me miratimin e buxheteve vjetore


14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi kryerjen e pagesave, konstatohet se shpenzimet (transaksionet), janë bazuar në dokumentacionin e nevojshme ligjor dhe evidentuar në llogaritë përkatëse sipas përmbajtjes ekonomike, por që një pjesë e tyre nuk janë regjistruar si detyrime në pasqyrat financiare të viteve respektive, konkretisht:

Për periudhën objekt auditimi, janë testuar gjithsej 11 urdhër pagesa në vlerën 116,459,463 lekë, nga e cila në vitin 2018 6 urdhër pagesa në shumën 52,087,280 lekë dhe për vitin 2019 11 urdhër pagesa në shumën 64,372,183 lekë, ku është konstatuar se:

- Në pasqyrat financiare të vitit 2018, nuk janë **deklaruar si detyrime** fatura tatimore për një rast në shumën 15,447,300 lekë nga subjekti "S...J" (nr. 182 datë 03.06.2018);

- Në pasqyrat financiare të vitit 2019, nuk janë **deklaruar si detyrime** 5 fatura me vlerë 9,530 mijë lekë.

- Në **72 raste** me vlerë **102,369 mijë lekë**, likujdim i faturave është kryer jashtë afatit 30 ditor nga momenti i dorëzimit të tyre në Bashkinë Malësi e Madhe, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën *Aneksi B/1 bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 7, datë 22.05.2020.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Në 19 raste, faturat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, ku nga vlera prej 152,645 mijë lekë është likuiduar nga bashkia vlera prej 120,725 mijë lekë, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën *Aneksi B/2 bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 7, datë 22.05.2020*. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Kap. II, pikat 5, 8, 30; pika 3 e nenit 52- *Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014 dhe nenin 55 të ligjit nr. 68/2017, datë 24.7.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Kap. II, pikat 5, 8, 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (C/1), faqe 60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit dhe Buxhetit të marrë masa që në zbatim të kërkesave ligjore në programimin e buxheteve, kryerjen e pagesave të detyrimeve kreditore në kohë dhe vlerën e tyre të plotë, si dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet për pasqyrimin e saktë të situatës kreditore që Bashkia Malësi e Madhe ka ndaje të tretëve.


Në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 4 procedurave me vlerë kontrate 389,465 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, si dhe nuk është mbajtur procesverbal për argumentimin e tyre për çdo rast, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" me ndryshime dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*" (*Më hollësisht trajtuar në pikën (D), faqe 69-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (*sipas llojit të procedurës*), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me një OE, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve përcjellë nga KLSH-ja me shkresën nr. 1106/8, datë 28.03.2016, u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

- Nuk është respektuar afati prej 20 ditë dhe 6 muaj për kthimin e përgjigjes nga subjekti, mbi zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30 -Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.

Gjatë auditimit rezultoi se, megjithëse bashkia është munduar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja}, konstatohet se për disa nga masat është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në RSH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit "Për kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë, konkretisht:

A. Masa Organizative:

Nga **14** masa organizative të rekomanduara me vlerë 55,687,966 lekë, janë zbatuar **7** masa, janë në proces **2** masa dhe nuk janë zbatuar **5** masa me vlerë 55,687,966 lekë.

B. Masa për shpërblim dëmi:

Nga **19** masa shpërblim dëmi të rekomanduara me vlerë **18,441,036 lekë**, janë zbatuar plotësisht **2** masa me vlerë **162,000 lekë**, janë në proces **5** masa me vlerë 8,569,521 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 7,846,282 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 723,239 lekë dhe nuk janë zbatuar **12** masa me vlerë **9,871,916 lekë**, të dhëna paraqitur në pasqyrën **Aneks E/2**, bashkëlidhur Projektraport Auditimit.


D/1. Për Inspektoratin Vendor Mbrojtjes Territorit (IVMT)

Bashkia Malësi e Madhe nuk ka marrë asnjë masë administrative në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, për shkelje të neneve 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 15, datë 01.03.2013, pikat 2, 5 dhe 6 si dhe VKM nr. 514, datë 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika 9, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor, **për 3 (tre) mbikëqyrësit** e punimeve, si më poshtë:

1. N. M. në cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **852,943 lekë** (pa TVSH).

2. R. GJ. në cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **1,480,125 lekë** (pa TVSH).

3. G. L. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës për katër investime (trajtuar më hollësisht në raportin përfundimtar) me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **2,333,068 lekë** (pa TVSH).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

D/II. Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

KLSH me shkresën nr. 688/9 prot, datë 13.09.2018 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **7** persona në shumën **2,477,856 lekë**.

Nga APP sipas Vendimit të APP nr. 119, datë 19.12.2018 janë aplikuar gjopa në masën **2,477,856 lekë**, nga e cila zbatuar për **6** persona me vlerë **2,177,856 lekë**, në proces **1** (një) person me vlerë 300,000 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 223,000 lekë dh mbetet për arkëtim vlera 77,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit" dhe shkresën nr. nr. 1106/8, datë 28.03.2019 "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Malësi e Madhe" (Më hollësisht trajtuar në pikën (E), faqe 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1106/8, datë 28.03.2019 "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Malësi e Madhe", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për **7** masa organizative me vlerë **55,687 mijë lekë**, konkretisht për pikat;

b-Për **17** masa shpërblim dëmi në vlerën **10,594 mijë lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Për **1** masa administrative me vlerë **77 mijë lekë**.

d- Aplikimin e penalteteve ndaj **3 mbikëqyrësve** të punimeve.


Brenda datës 30.09.2020

17. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Malësi e Madhe për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2017 - 31.12.2019, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

BI. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Malësi e Madhe), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"


kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **14,540,646 lekë për 21 raste, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 4362 prot datë 26.10.2017, me objekt "Rruga Fshati Marshej - Rruga Koplík Dedaj", Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 19,670,546 lekë pa TVSH, fituar nga BOE "K...N" & "A...A", rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **380,548 lekë pa TVSH**, diferenca këto të konstatuara në volume dhe çmime në zërat e punës "Gërmim dheu me esk. 0.5 m³, kanale > 2 m", "Gërmim seksion i detyruar për KUB", "Transport dheu deri 1 km", "Struktura monolite betoni C 25/30" dhe "Shtresë stabilizanti për bankina t=15cm + t=10 cm", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4365, datë 26.10.2017, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2364 prot, datë 18.08.2017 dhe kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2879 prot., datë 28.05.2018 kontratën e sipërmarrjes së punimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën (D/1.4), faqe 101-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Menaxhim Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **380,548 lekë** pa tvsh nga BOE fitues "K...N" & "A...A", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4362 prot datë 26.10.2017 me "Rruga Fshati Marshej - Rruga Koplík Dedaj", Bashkia Malësi e Madhe, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.09.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 414 prot datë 11.01.2018, me objekt "Rruga Ura e Zhajes - Zagore", Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 36,665,930 lekë pa TVSH, fituar nga OE "S...J", rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 257,000 lekë pa tvsh, diferenca këto të konstatuara në volume dhe çmime në zërat e punës "FV hekur betoni periodik d=6-10mm" dhe "FV hekur betoni periodik d>10mm", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve, veprime në kundërshtim ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 414 prot datë 11.01.2018, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 280, datë 11.01.2018 dhe kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

nr. 5900 prot., datë 14.09.2018 (Më hollësisht trajtuar në pikën (D/1.4), faqe 101-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Menaxhim Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **257,000 lekë** pa tvsh nga OE fitues "S...J", në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 414 prot datë 11.01.2018, me objekt "Rruga Ura e Zhajës - Zagore", vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.09.2020

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, u konstatua se;

- Nga **15** subjekte që tregtojnë karburant në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe, u konstatua se **5** subjekte tyre nuk janë pajisur me Autorizim/Liçensë dhe konkretisht ndaj subjekteve, "O...A", "L...L", "R...J", "K...R", "G...G", duke i shkaktuar dëm buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe në vlerën **5,000,000 lekë**.

- Nga **8** subjekte që janë pajisur me Autorizim/Liçensë për tregtimin me pakicë të hidrokarbureve, u konstatua se **5** subjekte tyre nuk kanë likuiduar detyrimin e plotë për pajisjen me këtë dokument, duke i shkaktuar dëm buxhetit të bashkisë në vlerë **500,000 lekë**, konkretisht; "A...L", "J...L", "D...L", "R...P", "B...L" për vlerën 100, 000 lekë/secili.

- Nga 7 subjektet që ishin pajisur me Liçensë/ Autorizim përpara hyrjes në fuqi të VKM nr. 970, datë 02.12.2015, u konstatua se **4** subjekte nuk kanë rinovuar Liçencën/ Autorizimin për periudhën në vazhdim edhe pse vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin tregtar të tregtimit me pakicë të karburanteve etj, konkretisht: "J...L" përfunduar Liçensë në datë 12.03.2019, "D...L" përfunduar Liçensë në datë 01.10.2018, "R...P" përfunduar liçensa në datë 11.02.2019 dhe "B...L" përfunduar liçensa në datë 13.07.2019.

Nga mos pajisja e këtyre subjekteve me Liçensën/ Autorizimin përkatës kanë sjell mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë në vlerën **4,000,000 lekë**, (4x 1,000,000). Veprime dhe mos veprime që bien në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, dhe pika 15.1, të cilët kanë sjell të ardhurash të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe, në vlerën **9,500,000 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **9,500,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve, si mëposhtëm:

- Shoqëria "O...A", për vlerën **1,000,000 lekë**
- Shoqëria "L...L", për vlerën **1,000,000 lekë**
- Shoqëria "R...J", për vlerën **1,000,000 lekë**



- Shoqëria "K...R" , për vlerën **1,000,000 lekë**
- Shoqëria "G...G" , për vlerën **1,000,000 lekë**
- Shoqëria "D...L" , për vlerën **1,100,000 lekë**
- Shoqëria "R...P" , për vlerën **1,100,000 lekë**
- Shoqëria "B...L" , për vlerën **1,100,000 lekë**
- Shoqëria "J...L" , për vlerën **1,100,000 lekë**
- Shoqëria "A...L" , për vlerën **100,000 lekë**

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, të marrin masa për detyrimin e subjekteve që tregtojnë karburant me pakicë dhe që aktualisht rezultojnë të pa pajisur me Autorizim /Licensë, të pajisen me autorizim, kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, i ndryshuar.

Brenda datës 30.09.2020

4. Gjetje nga auditimi: Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e periudhës (Janar-Mars 2018; Tetor-Dhjetor 2018 dhe Janar- Mars 2019; Tetor-Dhjetor 2019), u konstatua se për 4 punonjës pagesat nuk janë kryer në zbatim të Vendimin të KM nr.142, datë 12.03.2014 ndryshuar me VKM nr.305, datë 5.4.2017 dhe VKM nr. 765, datë 26.12.2018, për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e Administratës Shtetërore dhe institucioneve të pavarura", tek Kategoria IV Nënpunësi Civil të kategorive ekzekutive: Emërtimi i Pozicionit është vetëm Specialist i nivelit (a) dhe (b), pra lejohet vetëm emërtesa specialist dhe jo përgjegjës pasi përgjegjësit futen tek klasa e III kategoritë III-a/1 si dhe e III-b dhe arsimit duhet të jetë master shkencor e profesional; kjo e argumentuar në fund të çdo klase ku përcaktohen kërkesat e posaçme. Në VKM nr. 177, datë 8.3.2017, tek lidhja 4, klasa IV, kategoria IV-a, emërtimi i pozicionit të punës, është vetëm specialist; shtesa e pagës për pozicion është 23,000 – 38,000 lekë. Në vendimin respektive të Këshillit Bashkiak për periudhën e viteve 2018 – 2019 – 2020 mbi strukturën e pagave, në disa pozicione pune janë emëruar punonjës jo me arsimin e duhur, duke i klasifikuar në kategorinë III/a-1, ndërkohë që janë me arsim Bachelor jo master shkencor dhe duhej të vendoset kategoria e IV-a, veprime të cilat kanë çuar në kryerjen e pagesave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore për **vlerën 563,952 lekë**, konkretisht pasqyra:

f- Punonjës **S...P** me pozicion "Sekretar i Këshillit", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/dhe funksioni në vlerën 44,074 lekë/muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/muaj ose më shumë për pagën neto 102,330 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

g- Punonjës **E. S.** me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 11.09.2019 – 30.03.2020 është paguar neto për grupit/dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/muaj ose më shumë për pagën neto 31,836 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

h- Punonjës **E. M.** me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/muaj ose më shumë për pagën neto 143,262 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

i- Punonjës **GJ. P.** me pozicion "Përgjegjës Kulture", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/muaj, por



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

duhej paguar vlerën 40,284 lekë/muaj ose më shumë për pagën neto 143,262 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

Punonjës P. Ç. me pozicion "Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 është paguar neto për grupit/dhe funksioni në vlerën 45,590 lekë/muaj, por duhej paguar vlerën 40,284 lekë/muaj ose më shumë për pagën neto 143,262 lekë për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020 (Më hollësisht trajtuar në pikën (C/1.), faqe 60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë dhe Menaxhim Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njësore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin për arkëtimin e pagave të paguar padrejtësisht në vlerën **563,952 lekë**, konkretisht:

- **vlera 102,330 lekë**, ndaj punonjës S...P me pozicion "Sekretar i Këshillit", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

- **vlera 31,836 lekë**, ndaj punonjës E. S. me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 11.09.2019 – 30.03.2020.

- **vlera 143,262 lekë**, ndaj punonjës E. M. me pozicion "Përgjegjës Turizmi", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

- **vlera 143,262 lekë**, ndaj punonjës GJ. P. me pozicion "Përgjegjës Kulture", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020.

- **vlera 143,262 lekë**, ndaj punonjës P. Ç. me pozicion "Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve", për periudhën 01.01.2018 – 30.3.2020

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njësore, të marrë masa për plotësimin e vendeve të punës me kontratë, por që janë pozicione më statute të Nënpunësit civil, duke ndjekur procedurat ligjore të konkurrimit.

Të përgatisë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura veçanta deri në shkurt 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetore të Shërbimit Civil".

Brenda datës 31.12.2020

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 6449 prot datë 09.10.2018, me objekt "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" dhe i kopshtit Koplík", Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 63,273,970 lekë pa TVSH, fituar nga BOE "M...I" & "N...A", rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **350,982 lekë pa TVSH**, diferenca këto të konstatuara në volume dhe çmime në zërat e punës "Transport materiale ndërtimi, dheu deri 10 km", "Hidroizolim me emulsion bituminoz dhe një shtresë k katrama", "Plintuse grez importi h=10cm", "Bojë hidroplastike importi (brenda)" dhe "Suvatim fasade + bojë hidroplastike importi", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6449 prot datë 09.10.2018, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6448, datë 09.10.2018 dhe kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2555



prot., datë 10.05.2019. (Më hollësisht trajtuar në pikën (D/1.4), faqe 101-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Menaxhim Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Malësi e Madhe, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "M...I" & "N...A", në zbatim të kushteve të kontratës që të zbatohen në objekt, punimet e ndërtimit që i përkasin shumës prej **350,982 lekë pa TVSH**, dhe të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Malësi e Madhe dhe Mbikëqyrësi i punimeve. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike brenda afatit të përfundimit të punimeve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Brenda datës 30.09.2020

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditim i dokumentacionit mbi veprimtarinë e Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), konstatohet se për periudhën objekt auditim nuk është marrë asnjë masë për ndërtimet pa leje. Dhe në auditimet e mëparshme të kryera nga KLSH në këtë sektor është konstatuar se nga IMTV janë aplikuar penaltet për ndërtimet pa leje me vlerë 2,200,000 lekë, por si në periudhën e auditimit ashtu dhe gjatë zbatimit të rekomandimeve nga kjo strukturë nuk është ndjekur asnjë rrugë ligjore arkëtimi i tyre.

Gjithashtu këto gjopa, nuk janë kontabilizuar në librat e llogarive dhe kontabilite si detyrime, pasi nga IVMT^{ja} nuk janë përcjellë për veprime të mëtejshme në Sektorin e Financës.

Për personat e dënuar me gjobë nuk është aplikuar kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj në masën **1,320,000 lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.02.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore; nenet 15, 24 dhe ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996,"Kodi i Procedurës Civile në RSH " i ndryshuar, nenin 151, Rivendosja në afat, nenin 152 dhe neni 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.12.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim" dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtje administrative" përkatësisht nenet 9-"Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative" dhe neni 22 (Më hollësisht trajtuar në pikën (E), faqe 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Financës, Bashkia Malësi e Madhe:

a. Të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat të **4** vendime gjobe në vlerën **2,200,000 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH",

b. Të marrin masa për kontabilizimin e vendimeve të gjobave të IMTV dhe kthimin në tituj ekzekutiv të **4 vendimet e dënimit** me gjobë të vendosura nga IMTV, në vlerën **2,200,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundëroajtjen



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

administrative në titull ekzekutiv , të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative në, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën **1,320,000 lekë**, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar", si dhe të ndiqet të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **3,520, 000 lekë**, sipas pasqyrës.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. Vend	Data	Vlera e gjobës	Kamata
1.	S. M.	3	27.11.2012	500,000	300,000
2.	A. S.	1	23.04.2013	1,000,000	600,000
3.	R. T.	4	26.02.2015	500,000	300,000
4.	A. K.	3	31.10.2014	200,000	120,000
TOTALI				2,200,000	1,320,000


Brenda datës 31.12.2020

B/II. MASA PËR ELEMENIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË MALËSI E MADHE.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë"; nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **27,345,879 lekë** ndaj **203 raste**, si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksat e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen, veprime të cilat kanë çuar në mospagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **189** persona me vlerë **8,128,740 lekë**, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2019, si e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe (Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (ALUIZNI-t), nga **189** persona me vlerë **8,128,740 lekë**, si një e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Të njoftohet ASHK Shkodër, për bllokimin e pasurive të gjithë personave të cilat paraqiten për tu pajisur me çertifikatën e pronësisë, pa mundësuar pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Brenda datës 31.1.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kushteve të kontratave të lidhura me subjektet qiramarrëse, nuk është zbatuar penaliteti i parashikuar në kontratë për kamatë vonesën në rastet kur qiramarrësi nuk likuidon në kohë detyrimin, nga 0.01% në ditë, por jo më shumë se 10% e vlerës së detyrimit përkatës. Konkretisht me kompaninë "V...A" SHA për vlerën 110,504 lekë, dhe subjektin "S...I" për vlerën 32,757 lekë. Veprim i cili ka sjell të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën **143,261 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin për arkëtimin e vlerës **143,261 lekë**, përkatësisht;
- vlera **110,504 lekë**, nga shoqëria "V...A Sha";
- vlera **32,757 lekë**, nga shoqëria "S...I",

Të zbatoj në vazhdimësi të gjitha kushtet dhe penalitetet e vendosura në kontratat respektive të dhënies me qira të aseteve pronë e bashkisë.

Brenda datës 30.09.2020

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kushteve të kontratave lidhur midis bashkisë Malësi e Madhe (ish Komuna Shkrel) me subjektin "M...R" **1,2,3**, me nr. kontrate 626, 627, 628, datë 26.02.2013, për dhënien me qira të sipërfaqes prej 15 ha për një kohë për 30 vite, rezulton se nuk është zbatuar neni 13.2, për zgjidhjen e një anshme të kontratës, pasi nuk kanë derdhur të plotë në arkën e bashkisë detyrimin e qirasë vjetore siç është parashikuar në nenin 5, pika 5.1 të kontratës së lidhur, nga momenti i lindjes së detyrimit dhe deri në 31.12.2019 vlerën prej **13,144,296 lekë**, si e ardhura e munguara në buxhetin e Bashkisë, prej të cilave: vlera 11,949,360 lekë detyrim qiraje dhe vlera 1,194,936 lekë kamatë vonesë (Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **13,144,296 lekë**, nga subjekti debitor "M...R" **1,2,3**, duke përdorur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore dhe në rast mos pagesë të kërkohet prishja e njëanshme e kontratës nga ana e bashkisë

Brenda datës 30.09.2020

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH në Bashkinë Malësi e Madhe është konstatuar dhe njëherazi rekomanduar në lidhje me administrimin e aseteve, ku për **11 objekte** me sipërfaqe funksionale ndërtimi **1646 m²** të miratuar me VKM si pronë e kësaj bashkie, nuk është bërë asnjë punë për evidentimin e tyre në terren mbi gjendjen aktuale dhe regjistrimin si prone e kësaj bashkia, pasi ato aktualisht janë në përdorim nga persona privat (zënë forcërisht) dhe bashkia nuk arkëton asnjë të ardhure në favor të saj, ku nga mos menaxhimi i tyre për lirim ose lidhjen e kontratave të qirasë së objekteve me personat që i kanë zaptuar ato, Bashkisë malësi e Madhe i mungojnë të në vlerën **5,925,600 lekë**.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

Referuar VKM nr. 458, datë 26.7.2018 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme shtetërore, që përdoren për kryerjen e veprimtarive sportive", Bashkisë Malësi e Madhe i është kaluar në pronësi prona për zhvillimin e aktiviteteve sportive (fusha sporti), prona të cilat janë uzurpuar nga të tretë, por nga ana e saj bashkia është detyruar të marrë me qira prona të tjera për zhvillimin e aktiviteteve sportive, ku për periudhën objekt auditimi janë paguar qira fushë sporti në shumën 628,100 lekë.

Gjithashtu nga Bashkia Malësi e Madhe është shpenzuar vlera prej 2,737,013 lekë (për vitin 2018 në vlerën 1,006,000 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 1,731,013 lekë), për objekte me qira për në nevojat e bashkisë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien ndesh me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar, Kapitulli III, pika 1/a,b; nenin 54/dh dhe 55/3 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe nenet 40 dhe 46 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" (Më hollësisht trajtuar në pikën (E), faqe 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financ/Buxhet, Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për lirimin e pronave publike që shfrytëzohen padrejtësisht nga persona privat pa pagesë, por në interes të Bashkisë për mos kryerjen e pagesave të qirave për objekte të cilat vetë bashkia është pronare.

Në rast të kundërshtimit nga personat të cilat i kanë zaptuar ato, të mundësohet lidhja e kontratave të qiradhënies, duke përlllogaritur detyrimet që rrjedhin nga shfrytëzimi i pronave publike që nga hyrja në fuqi e VKM nr. 269, datë 12.03.2008 dhe VKM nr. 93, datë 07.02.2012 "Për miratimin e listës së inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Malësi e Madhe (ish Bashkia Koplík), të Qarkut Shkodër", për mungesën e të ardhurave të krijuar në vlerën 5,925,600 lekë nga mos lidhja e kontratave për dhënie me qira të këtyre objekteve.

Brenda datës 31.12.2020

B/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të ndjekura nga Drejtoria e të Ardhurave, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor), u konstatua se në fund të periudhës 31.12.2019, gjendja e debitorëve për subjektet fizik/ juridik dhe abonentët familjare paraqitet në vlerën **11420 subjekte për vlerën 113,743,328 lekë**, nga e cila:

c- 211 subjekte fizik/ juridik me vlerë 26,652,289 lekë për taksat pasurisë, tokës, ndërtesës, hapësirave publike dhe tarifave vendore.

d- 11209 abonentët familjarë me vlerë 87,091,039 lekë, për taksën e pasurisë dhe tarifave vendore, nga e cila: taksa tokë bujqësore në shumën 3,653,554 lekë, taksë ndërtese në vlerën 16,763,185 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 64,505,450 lekë.



Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se vlera e debitorëve abonentëve familjarë është 76.5 % e vlerës së gjithë borxhit fiskal.

Në totalin e debitorëve të paraqitur, u konstatua se 118 subjekte janë debitorë aktiv ose 56 % e subjekteve me detyrime për vlerën 10,848,212 lekë ose rreth 50 % e vlerës totale të borxhit tatimor, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme dhe jo këmbëngulëse të Drejtorisë së të Ardhurave në arkëtimin e detyrimeve debitor.

Nuk u konstatua asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtitimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar"*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, me ndryshimet dhe nenit 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"*.

Nga Bashkia Malësi e Madhe, nuk është përcaktuar mënyra efçente për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga abonentët familjar, si nëpërmjet shoqërisë *"Ujësjellësi Kanalizime" ShA*, siç përcaktohet dhe në pikën (ii) e nenit 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, ku i jep të drejtën e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk është realizuar përfshirja e vlerës së taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit dhe do ti jepte më shumë mundësi për shërbime dhe investime ndaj komunitetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën (B/1.4), faqe 28-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave, Bashkia Malësi e Madhe, bazuar në nenin 70 pika 3 *"E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor"*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat tatimore në R.SH"*, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në vlerën **113,743,328 lekë**, si më poshtë vijon:


a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore RSH"*.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në RSH"*.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat tatimore në RSH"*, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, **të bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 *"Mospagimi i taksave dhe tatimeve"*.

e- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe në bashkëpunim me 6 Njësitë Administrative, *respektivisht: Kopluku, Rruemira, Kastrati, Kelmendi, Qendër dhe Shkrel*, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të përgatisë dhe të miratojë në Këshillit Bashkiake aktmarrëveshje me shoqërinë "Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe", si agjent tatimorë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për familjet që kanë kontratë me këtë ndërmarrje, në zbatim të nenit 5, pika 1, shkronja "b" e ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Brenda datës 31.12.2020

B/IV. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË PALIGJSHMËRINË E PËRDORIMIT TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, u konstatua se nga **49** procedura me vlerë kontrate 801,388 mijë lekë pa TVSH, grupi i auditimit të KLSH ka vlerësuar për auditim **30** procedura me vlerë kontrate 760,798 mijë lekë pa TVSH ose 95 % e vlerës së kontratave të lidhura, *nga e cila:* për vitin 2018 për 17 raste me vlerë kontrate 184,210 mijë lekë dhe për vitin 2019 për 13 raste me vlerë kontrate 576,588 mijë lekë.

Në përfundim të procesit të auditimit dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti Bashkia Malësi e Madh paraqitur me shkresën nr. 671/46, datë 08.06.2020 (prot KLSH nr. 259/4, datë 10.06.2020), nga procedurat e audituara janë konstatuar me shkelle të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në **4** procedura prokurimi me vlerë kontrate 116,122 mijë lekë pa TVSH ose 14% e vlerës së kontratave të audituar, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK).

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, procedurat duhej anuluar për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike në vlerën **118,638,753 lekë pa TVSH**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2 e nenit 2 "Parimet e përzgjedhjes", nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave," për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, konkretisht rastet:

1. Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i shkollës 9-Vjeçare "Abdl bajraktari"*", fituar nga BOE "S...I & S...N" me kontratë nr. 6449, datë 9.10.2018 për vlerën 64,700,422 lekë.

2. Tenderi me objekt "*Skeme ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, Loti 2*", fituar nga BOE "S...I & S...N" me kontratë nr. 3684, datë 16.7.2019 për vlerën 35,872,731 lekë.

3. Tenderi me objekt "*Sistemim Asfaltim Rruga Rrustemaj-Stacionit (Lagje e Re Koplík)*", fituar nga BOE "L...J" & S...I" me kontratë nr. 3321, datë 20.6.2019 për vlerën 8,562,992 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në subjektin "Bashkinë Malësi e Madhe"

4. Tenderi me objekt "*Ndërtim Ujësjiellësi Balshaj*", fituar nga subjekte "L...J" & "A...N" me kontratë nr. 4150, datë 20.8.2019 për vlerën 10,026,559 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën (D), faqe 69-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të marrë masa për trajtimin e stafëve dhe të eliminojë praktikën e konstatuar në shkelje akteve ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike për vlerën **118,638,753 lekë pa TVSH**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe na vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në testet e kryera nga analiza e riskut mbi pagesat e kryera në artikullin 602, u konstatua se Bashkia e Malësi e Madhe ka financuar në formë Sponsorizime ekipin e futbollit, i cili ka status "Shoqatë", duke e financuar për dieta, trajtim ushqimorë, shërbimin e transporti, gjithsej në shumën **12,004,500 lekë**, nga të cilat në vitin 2018 në shumën 4,566,000 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 7,438,500 lekë.

Këto financime nuk janë miratuar në Këshillin Bashkia, artikulli së cilës bashkia i referuar "*Zhvillime Sportive*", nuk është artikull i detajuar për këtë qëllim, pasi ajo ka lidhje me aktivitetet e ndryshme kulturore dhe sportive që zhvillon vetë bashkia, veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 1, 3, 4 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizime"; të neneve 13, 19, 20, 21 dhe 39 të ligjit nr. 79/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin" dhe **nenit 54 të ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"** (*Më hollësisht trajtuar në pikën (C/1), faqe 60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë/Buxhet dhe Drejtorinë Juridike, të analizojnë rastin dhe të marrin masa për ndërprerjen e sponsorizimit të Klubit të Futbollit, pasi praktika bie ndesh me kërkesat ligjore të sipërcituara.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT